Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0034329/24
Data 22.07.2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

# *T H Ë R R E T*

**Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj**, e cila do të mbahet me datë **30.07.2024**, (ditë e marte), me fillim prej orën **10:00**, në Sallën e Kuvendit

**Mbledhja do të ketë këtë:**
**REND DITE**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i tri (3) procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2024, me Nr.04-052/01-0032374/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara te të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, me Nr.04-400/01-0032372/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
7. Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr. 07-030/03-0032405/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DKA-së, **z.Kastriot Duraku**);
8. Informatë për aktivitetet e punës nga Drejtoria e Inspekcionit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr. 13-052/01-0034181/24, të datës 22.07.2024, (Raporton Drejtori i DI-së, **z.Valon Haliti**);
9. Raporti i Kompanisë KRU "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023, me Nr.01-052/01-0034126/24, të datës 19.07.2024, (Raporton Aksionari i ndërmarrjes, **z.Ruzhdi Koca**);
10. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E SKENDERAJ SKUPŠTINA OPŠTINA MUNICIPALITY OF SKENDERAJ REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA

**KRYESUESJA E KUVENDIT**
znj. Adelina Spahiu

Kuvendi i Komunës/SkupštinaOpštine/MunicipalityofAssembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës **07.06.2024**, ora **14:00.**

**Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0016897/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale, me Nr.02-020/01-0023062/24, të datës 15.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
5. Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016899/24, të datës 03.04.2024, për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për familjet (të ngushta) të Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02-020/01-0023060/24, të datës, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016898/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi për ndarjen e banesave për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02-020/01-0023061/24, të datës 15.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
7. Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 1 (një), deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor që gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me Nr.02-463/01-0023751/24, të datës 21.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
8. Propozim-vendim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor qe gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me Nr.02-020/01-0023754/24, të datës 21.05.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
9. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, me Nr.02-463/01-0023907/24, të datës 22.05.2024, (Raporton drejtoresha e DGJKP-së, **znj.Blerta Dobra-Geci**);
10. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik juridik Ismet I. Mustafa B.I, me Nr. 02-463/01-0023908/24, të datës 22.05.2024, (Raporton drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
11. Propozim-vendim për rishqyrtimin dhe miratimin e dokumentit Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2028 për Komunën e Skenderajt, të harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së, me Nr.12-313/01-0023818/24, të datës 21.05.2024, (Raporton Drejtoresha e DZHENIT-së, **znj. Besarta Meha-Ademi**);

12. Propozim-vendim për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim 2024-2026, në Komunën e Skenderajt, me Nr.08-060/01-0023492/24, të datës 20.05.2024, (Raporton drejtoresha e DSHMS-së, **znj.Rrezarta Hasani-Ibrahimi**);

**Pika shtesë:**

13. Propozimi-vendimi, për shpalljen **"Qytetar Nderi"** të Komunës së Skenderajt **z. Bardhyl Mahmuti,** më Nr.02-170/02-0026395/24, të datës 25.01.2022, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
14. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme

**Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:** I nderuar kryetar i komunës z. Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, Kjo seancë është thirrur për datën 30.05.2024, në ora 10:00, po është shtyre për datën 07.06.2024, për ora 14:00, për arsye të agjendës së ekzekutivit. Shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 29 anëtar, mungon me arsye Arjeta Rama, ndërsa i bashkëngjitet mbledhjes Sala Jashari.
Para se të fillojmë me miratimin e rendit ditës, e kam një kërkesë, autorizim nga Sala Jashari që ta lexoj një deklaratë të saj:
"Unë, Sala Jashari anëtare e Kuvendit komunal të Skenderajt e zgjedhur në zgjedhjet e 17 tetorit 2021, nga votat e qytetarëve të komunës së Skenderajt, nga sot e tutje do të vazhdoj të jepe kontributin time duke ju bashkuar grupit parlamentar të PDK-së dhe do të vazhdoj të jem zëri i qytetarëve të komunës së Skenderajt për të gjitha çështjet në interes publik".
Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, fjalën ja kalojë:
**Hysni Mehani-VV:** Fjala përshëndetëse, siç edhe jemi marr vesh, unë besoj të parimi kur merrmi vesh, sepse sot është dashur me ardhur me informatë, në raportim drejtori i bujqësisë, drejtori i dallavereve e i hajnisë Behxhet Maliqi, dhe po propozoj pikë shtesë për rend dite me raportua Behxhet Maliqi, dhe me krijua një komision hetimor, ose nëse doni një komitet konform udhëzimit administrativ e cila e mbikëqyrë punën e kësaj drejtorie, kur ka tash dëshmi për hajni, mi thanë hajn nuk është fyerje, është konstatim i të vërtetës. Tash unë po e bëjë arsyshmerin e propozimit, së pari në thirrje që e ka bë ky zotëria për grande dhe subvencione askund nuk i referohet bazës ligjore, sepse çdo thirrje duhet me e pas bazën ligjore, edhe rregullorja për subvencione i ka kategoritë e veta, kur të banë një thirrje e ti jepesh qytetarit pare e ti merresh pare duhet me bë konform bazës ligjore. Këto logjika së këto janë ndihma, e me qenë së janë ndihma, e hajt se nuk ka gajle, kjo është me e keqe po dashka me i vjedh edhe ndihmat, së nuk po mjaftojnë edhe këto tjerat, po mi vjedh edhe ndihmat. Këtu e kam listën e përfituesve për makina mbjellës të misrit, ku tash është e qartë që disa prej tyre ju ka marr makinat, për shkak së është vërtetua që ka shkelje të jashtëzakonshme. Unë e kam rregulloren për subvencione që në asnjë rrethanë nuk është zbatua dhe ka dy muaj që po e bëjë një tentim me kuptua një proces qysh ka zhvillua, tu kërkua qasje në dokumente zyrtare. Dje më është thënë me kanë thirrur prej Asgjësisë për informim dhe privatësi, çka është tu ndodh së hala nuk e kemi të qartë, së komuna po thotë po ju duhen me shume kohe, unë po kërkoj qasje në dokumente zyrtare që dy muaj për me hetua çka po ndodh me një proces së në Skenderaj këtë bujqësi e kemi edhe kjo është kontaminua e është shkatërrua tërësisht prej këtij njeriu. Unë gjatë qasjes në dokumente zyrtare për me pa punën qysh i ka vlerësua komisioni komunal këtë procesin e dhënies të këtyre subvencioneve të makinave mbjellëse të misrit, komisioni ma ka dhënë një letër zhgarravin pa vule pa numër protokolli pa asnjë dëshmi që thotë së është dokument zyrtar, edhe në fund për krejt personave përfitues janë poentua me kimikë dhe vlerësimi nuk është bë në kohen reale, po pas kërkesës time, për qasje në dokumente zyrtare. Dhe kur kam shkua në zyrën e drejtorisë së bujqësisë anëtaret e komisionit kanë thënë as që i kemi marr

parasysh kriteret që ka qenë kriter me i pas të mbjellura me misër 2ha, pra as që i kanë hapur dokumentet e njerëzve, së qysh kanë me ja dhënë këto grande në bujqësi. Edhe në anën tjetër këtu kemi të bëjmë me një shkelje të Udhëzimit administrativ Nr.15/2016, ku thotë: së një fermer duhet me pas një nif, nuk mundet me i pas një fermë dy tre nifa, këtu shkojnë deri në 5 nifa, nga e njëjta familje veç e ndërron. Nifi për fermën është letërnjoftim, të njëjtit njerëz përfitojnë nga dy tri herë, edhe a e dini çka banë Behxhet Maliqi në thirrje, thotë; kërkohet nif nëse ka, po nëse së ka nuk prish punë së ja dhajna apët, çfarë kriteri është ky nëse e ka, mandej vet në kriter ka thënë që aplikuesi duhet me pas të mbjellura për vitin 2023 këtë kulturë dhe planifikohet të mbjellët edhe për vitin 2024. Unë kam kërkuar në AZHB, për 21 emrat përfitues për makina mbjellëse, për 21 emra përfitues, 10 prej tyre komisioni ja ka shënuar ka 2 ha, 10 përfitues kanë me zero ari misër të mbjellur dhe ka përfituar makinë mbjellëse të misërti, pra edhe e ka qitë kriter vet edhe e ka shkelur, çka dua me thënë ne jemi kuvend komunal, ne jemi asamblist jemi përfaqësues të qytetarëve, bujqësinë e ka Skenderaj nuk mundem me ja lenë këtë përgjegjësi me shkatërrua, ose mundeni me ja lenë së e keni shumicën, amo duhet me i thënë me emër një njeri që është i shkarkuar prej pune prej detyre për keqpërdorim dhe korrupsion dhe nuk po duam me lanë Skenderajn me u bë strehë e njerëzve të shkarkuar për korrupsion dhe me shkatërrua edhe bujqësinë e Skenderajt.

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Fjala përshëndetës, Ne grupi i asamblistëve te IDEAL-it e mbështesim propozimin për piken shesë të rendit të ditës të propozuar nga z. Hysni Mehani. Arsyeja që ne e mbështesim iniciativën e Hysni Mehanit jam të shumta pasi që ky drejtor nuk është i përgjegjshëm për punën dhe përgjegjësin të cilën e ka karshi obligimeve ligjore për raportim para kuvendi komunal në Skenderaj. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural -Edhe gjate planifikimit te buxhetit ka qenë shume e qarët se ky drejtor nuk është i përgjegjshëm karshi kërkesa dhe premtimeve të dhëna gjate fushatës 2021. Duke pare buxhetin qe keni planifikuar për këto tri vite qeverisje me te vërtet ka qenë për të ardhur keq, duke pare keq menaxhimin dhe keq përdorimin e grandeve dhe subvencioneve qe keni dhënë për këto tri vite jo për fermerët por vetëm militanteve partiak para kurrfarë aktiviteti bujqësore. Buxheti i parapare për këto tri vite qeverisje për subvencione dhe shpenzime kapitale ka qene mbi 600,000 € qe nënkupton papërgjegjësi dhe keq menaxhim me grande nga ky drejtor. Ju drejtori nuk keni sjell raportin zyrtar për mbështetjen qe ky kuvend ka dhënë për ndarja e mjeteve financiare 5,000€ për fermerin Armend Thaçi dhe fermerin Milaim Xani, Dasheci. Unë personalisht i kam përkrah këto propozime për mbështetje financiare tek fermerët si Armend Thaçi dhe Milaim Xani. Nga ju kërkoj raportin zyrtar për mënyrën e shfrytëzimit te këtyre mjeteve se a kanë shkuar ne destinacionin e duhur apo janë keq menaxhuar nga ana juaj apo nga ana e fermerëve te lartcekur. Nga ky kuvend kërkoj që te formohet një komision për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e këtyre mjeteve dhe grandeve te shpërndara nga Drejtoria për bujqësi. Po ashtu kërkoj edhe një komisionin nga kuvendi për verifikimin e grandeve te pashpërndara për vitin 2022, 2023 dhe 2024 pasi qe ka dyshime se po përkrahën jashtëligjshëm shumica e fermerëve. Ne kemi dëshmi dhe fakte se po jepni grande nga dy tri here te njëjtëve fermerë dhe po i eliminon fermerët meritor qe kane prioritet bujtësinë, e njeri nder ta është edhe kolegu ynë asamblist, qe e keni refuzuar kinës nuk ka ujit te mjaftueshëm, ku dihet se komuna para tri viteve e ka mbështet ne hapjen e pusit për qëllime bujqësorë. Po ashtu kërkoj që ti publikoni listat e vlerësimit te fermerëve nga komisioni për arsyeje e eliminimit nga mbështetja me grande për këto tri vite me radhe?. Edhe ne seancën e datës 30.01.2023 për planin e drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Skenderaj kam qene kritik shume i arsyeshme duke ditur kapacitetin dhe aftësinë menaxhuese të këtij drejtori te pa përgjegjshëm dhe jo profesional për sektorin e bujtësisë. Ne vitin 2023 keni pasur kërkesa edhe nga vete fermerët për subvencionim për litër të qumështit, të cilin

premtim të dhen në zyrën e kryetari ka rezultuar me mashtrim dhe pa përgjegjshmëria e juaj karshi kërkesave dhe përimtimeve te dhëna fermerëve për mbështetje. Ju si drejtor nuk jeni duke i trajtuar si duhet kërkesat e tyre, andaj kërkoj edhe një here qe te mbështeten fermerët meritor e jo te ju jepen premtime boshe. Edhe ne seancën e datës 28.09.2023 kam paraqitur shqetësime dhe problemet e fermerëve te komunës se Skenderajt referoju procesverbalit te kësaj seance e shihet serioziteti i juaj. Çka do ju thoni fermerëve ne lidhje me kërkesat e tyre për mos mbështetje në subvencionim e prodhimeve dhe imputove te tyre bujqësorë?. Unë dhe gjate seancës se datës 28.09.2023 kam ofruar mbështetjen po ju nuk keni qenë bashkëpunues unë e kam dhen se ju nuk po keni ide se si te adresoni kërkesat e tyre, unë edhe vitin e kaluar ju kam ofruar mbështetje për ide dhe këshilla, edhe këtë vite shpreh gatishmërinë te jep kontributin tim me këshilla si asamblist se çka është me prioritet sektori i bujqësisë ne komune e Skenderajt. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ne seancën e datës 28.12.2023? Ne baze te planit te kësaj drejtorie për vitin 2024 nuk keni parapare projekte dhe ide te reja për mbështetjen e fermerëve te komunës se Skenderaj. Unë edhe gjate seancave te kaluara kam kërkuar mbështetje konkrete për fermerët e vyer të komunës sonë e jo për militant te PDK-se dhe te ashtuquajture fermës in ekzisten qe nuk merren me bujqësi e te cilët përkrahen vazhdimisht me grande. Andaj kërkoj nga ju koleg që ta votoni së është një sene i mirë se unë
jam për me i dhënë prioritet ati fermeri që punon.

**Mentor Mehmeti-PDK:** Fjala përshëndetëse, sa për me relaksua pak situatën desha me falënderua skulptorin Sadri Behramaj, për punimin e shtatores së Leutrim Ahmetit që e ka prua një pjesë të historisë, si dhe përkrahjen e kryetarit, që do të vendoset këtu në Skenderaj. Për këtë çka u thanë grupi parlamentar i PDK-së nuk e dinë, nuk kemi komente, hajn është veç kur vërteton gjykata, dhe këtu në kuvend ju kisha lutë mos me quajtur njeri tjetrin hajn pa dokumentacion.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:

**Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi:** Fjala përshëndetëse, Hysni nuk të pata borxh gjë mem ofendua, të kërkoj zyrtarisht e publikisht me tregua çka kam vjedh, nuk jam shkarkuar për keqpërdorime as për hajni, jam shkarkuar së kam menduar, mendoj dhe vazhdoj me mendua ndryshe prej Albin Kurtit, për arsye së këtij njeri liria e këtij vendi nuk i ka kushtuar sene i ka ardhur fal, e të tjerëve këtij vendi i ka kushtuar shume. Sa i përket asaj mos e manipulo opinionin publikë së zyrtaret t'kanë treguar qartë, së kanë pas persona që i kanë vetë, përfituesit e subvencioneve që janë në emër të babës- vëllait që jetojnë bashkë nuk munden me aplikua mos u mundo me dezinformua opinionin publik. Të përgëzoj që tre anëtar të LVV, në fshatin Rezallë ja keni dhënë ka një subvencion ka 100 mijë €, kjo është e vetmja arritje që e ke bë ti për ketë vend, së është shume mirë së edhe ata janë fermerë që punojnë token. Po nuk është në as një rrethanë atë çka po e thua ti, për shpifje për hajni zatetem në gjykatë, unë as familja ime nuk e ka në planë me ofendua dikën, për arsye për me ardhur në këtë vend na ka kushtua shume, unë as nuk të thash hajn, as nuk të ofendoj, së nuk është në natyrën time. Ndërsa për çështjet tjera merri si personal së kur ti thua dikuj hajn, me tregua së çka kam vjedh, unë as familja ime as 1€ të ndërmarrjeve publike sa në institucione publike nuk e këna marr përveç pagave, e as subvencione, përveç një grandi që vajza ime e ka fitua prej qeveris të Kosovës vitin e kaluar me thirrje publike. Naser e kuptoj shqetësimin tënd, sot në dëgjime buxhetore disa fermerëve ju thash, që për neve është e jashtëligjshme me i subvencionua dy herë të njëjtat çështje, kemi qenë në kontakt me komunën e Mitrovicës një diçka të tillë. Kemi me vazhdua kështu dhe jemi me qua përpara programin ideal të PDK-së e jo programin e Idealit, kur të kish mundësi me ardhur në pushtet qoj përpara programet tua, të falënderoj për mbështetje, dhe ne e kemi një program që i kemi marr votat e qytetarëve dhe atë program kemi më bë.

**Kryesuesja:** Me kaq mbyllet debati shkojmë në votim për futjen në rend dite propozimin e Hysni Mehanit, konstatojmë me (12) vota për, (17) kundër dhe (0) abstenim, propozimi i Hysni Mehanit nuk futet në rend dite, për me Raportua Drejtori i Bujqësisë, dhe me krijua një komision hetimor, e cila e mbikëqyrë punën e kësaj drejtorie, Fjalën ja kaloj:
**Naser Bajraktari-IDEAL:** Masi nuk doni me votua një diçka që ka qenë në të mirë të juaj, ne nga sot kërkojmë nënshkrimet e anëtarëve për me thirre një seancë të jashtëzakonshme për me raportua drejtori i bujqësisë.
**Hysni Mehani-LVV:** Po i thamë drejtorit që më vjedh nuk nënkupton ti veç me vjedh, po vjedhje është edhe me ja vjedh dikujt mundësin, e ti fermerëve të vërtetë ja ke vjedh mundësin, ja ke hekë token që e kanë pas në dokumentacion, e ke poentua shumë me pak, kjo është vjedhje e mundësisë, po unë jam i bindur së ti vjedh edhe kështu, po unë jam ka foli për ketë lloje të vjedhjes, së kur e banë ketë vjedhje e banë edhe atë vjedhje. Ti duhesh me u përgjigj, po nëse nuk ki diçka me m'shefe pse po na maltretonë, hajde të bëjmë komisionin hajde të hetojmë, dhe nëse ka me dal qysh po thua këtu ka metë kërkua falje. Kur po thoni që s'kam dokumentacion, unë që ku i kam dokumentacionin, që AZHB-ja për 10 persona i kanë zero ari misër, e ti ja ke shënua 20 pikë se i kanë ka 2 ha, e kjo është vjedhje drejtor së ke mashtrua. Edhe udhëzimi administrativ që e ka nënshkrua Memli Krasniqi thotë; që një ferme duhet me pas një nif, nëse një ferme i ka me shume se dy nifa duhet me u diskualifikua mos me përfitua hiq, sepse nifat tjerë krijohen vetëm për me vjedh, sepse ti i krijon krejt këto sepse e din fort mirë ketë, e nuk mundesh me mohua, sepse nuk je tu punua barabartë për krejt qytetaret, po je tu ja vjedh mundësin dikujt tjetër, e me favorizua dikën tjerët.
**Kryesuesja;** Dikush tjetër nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (4) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet Rendi i Ditës, ju njoftojmë së Sala Jashari është bashkangjitur mbledhjes, ja kaloj fjalën, sepse po e kërkon.
**Sala Jashari-PDK;** Fjala përshëndetëse, nga të gjithë eksperiencat e mija kam mësua diçka, ndryshime të mëdha nuk bëhen vetëm, po vetëm më gjithë të tjerët, andaj sot unë bashkohem grupit parlamentar të PDK-së, në mënyrë që ti arrimë qëllimet tona në të mirë të te gjithë qytetarëve. Mendoj që rizgjedhja është e nevojshme duke e lidhur ngushtë me dëshirën e madhe që kam për të dhënë kontributin tim në të mirë të te gjithëve pa marr parasysh bindjeve, kështu që ju mirëpresim të gjithëve për bashkëpunime.
Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,
Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka konstatoj me (25) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.
**Kryesuesja;** Faleminderit Sala, vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës,
-Propozim-vendim për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0016897/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale, me Nr.02-020/01-0023062/24, të datës 15.05.2024, (Raporton);
**Kryetari i Komunës Fadil Nura**; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni propozim-vendim për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale, nga seanca e kaluar që ministria ka kërkua plotësimin e këtij komisioni, sepse në seancën e kaluar ka pas një jo vullnet për me qenë pjesë e këtij komisioni sidomos nga partitë e subjektet tjera opozitare, dhe propozoj që ta plotësoni ketë komision.
**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:
**Abdulla Gashi-IDEAL**: Kryetar propozim-vendim për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale, prapë një vendim i kthyer mbrapsht si rezultat i punës jo profesionale nga ana juaj dhe të stafit tuaj, dhe disa here kemi

kërkuar të përfshihen gjitha partitë neper komisione pa marr parasysh subjekteve politike dhe nuk është e vërtet që nuk ka pas interesim, shikoje procesverbalin e mbledhjes të kaluar, nuk janë të përfshira as në komisionin për dhënien e banesave për familje të dëshmorëve. E përgëzoj MAPL-në, e cila ka fillua të reflektoj që i ka kthyer këto propozime të kundërligjshme, dhe kërkoj që të jeni sa me të sinqertë në propozim vendime, dhe të përfshihen nëpër komisione gjitha partitë politike, e jo vetëm partia PDK.

**Hysni Mehani-LVV:** Mos thoni tani po përdor fjalë të renda, së kur të rren, rren, mundem me thanë po gënjeni po prapë është njëjtë, shiko procesverbalin e mbledhjes të kaluar, dhe në arsyetim keni thënë; subjektet tjera politike për zgjedhjen e këshillave lokale duke i dhënë mundësi së cilit subjekt politik në këtë komision po të njëjtit nuk kanë shprehur interesim. Unë jo që kam shprehur interesim, po kam bë ankesë në MAPL, për mos përfshirjen në këto komisione subjektet tjera opozitare, dhe në procesverbal të mbledhjes kam fole për këtë çështje, ku kam thënë: Propozimi i anëtarit të PDK-së, është në kundërshtim me piken një (1) të propozim-vendimit, ku thotë; katër (4) anëtarë të kuvendit nga subjektet e ndryshme politike, e ftojë kolegun me i tërheq propozimet. Për anëtare të komisionit propozoj Floriana Halili-VV, pra po jeni në gjendje me thanë të pavërtetën për diçka që prezent janë 50 vetë, ka video incizim ka procesverbal, mos vetë për neve, e keni hup çdo kriter moral e njerëzor.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj:

**Kryetari i Komunës Fadil Nura:** Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale është nën autonomin e këtij kuvendi dhe ju ftojë partitë tjera opozitare ti bëjnë propozimet për plotësimin e këtij komisioni.

**Kryesuesja**: Shkojmë me propozime, fjalën ja kaloj:

**Floriana Haliti-LVV**: Për anëtar të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, propozoj Hysni Mehani-LVV.

**Afrim Kabashi-NSD**; Për anëtar të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, propozoj veten.

**Kryesuesja**: Shkojmë në votim që këta anëtar të jenë pjesë të komisionit të plotësuar edhe me dy anëtar nga opozita, si në vijim;

1. **Ilmi Kabashi** - anëtarë nga ekzekutivi,
2. **Liridona Koca** - anëtare nga legjislativi, PDK,
3. **Fikret Rexhepi** - anëtar nga legjislativi, PDK,
4. **Besiana Thaçi** - anëtare nga legjislativi, PDK,
5. **Abdulla Gashi** - anëtar nga legjislativi, IDEAL,
6. **Hysni Mehani** - anëtar nga legjislativi, LVV,
7. **Afrim Kabashi** - anëtar nga legjislativi, NSD,
8. **Milazim Mustafa** - anëtar nga shoqëria civile, Të jenë anëtar të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale konstatojmë me (20) vota për, (8) kundër dhe (0) abstenim, formohet komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale, plotësohet komisioni me anëtaret si me lart dhe miratohet Propozim-vendim për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-020/01-0016897/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për zgjedhjen e këshillave lokale.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016899/24, të datës 03.04.2024, për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për familjet (të ngushta) të Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02-020/01-0023060/24, (Raporton);

**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Para jush e keni një propozim vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi, për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për familjet (të ngushta) të

dëshmorëve të UÇK-së, për faktin së kemi kërkesë që të futet Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe Udhëzimet administrative që derivojnë nga ky ligj. E kemi diskutua edhe në seancën e kaluar së kategoritë e familjeve të dëshmorëve në këtë rast nuk mundem me i trajtua me këtë ligj, sepse ky ligj i përcakton aspektin social dhe kategoritë tjera sociale. Dhe qëllimi i përbashkët ka qenë se këto banesa këtyre familjeve me ju dhënë si dhurata, në respekt të gjakut të dëshmorëve, dhe propozoj të shfuqizohet ky vendim, dhe pika në vazhdim është për formimin e komisionit dhe të aplikojmë ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës, që e kishin aplikua disa komuna tjera.
**Kryesuesja**: E hap debatin, fjalën ja kaloj;
**Osman Smajli-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, kryetar me sa e di ke qenë një mandat deputet i kuvendit, dhe e dimë që familjet e dëshmorëve nuk e kanë një ligj të veçantë, përse në të kohë nuk keni bë kërkesë për me pas një ligj kjo kategori, e jo me i lënë në këtë fat, ketë kategori?
**Hysni Mehani-LVV:** Është shume e rëndësishme me na sqarua qysh ka me ec tutje ky proces, së nuk është se i kam të qarta të gjitha ligjet dhe tash me ligjin e ri në fuqi është e pamundur krijim i një kategorie të veçantë, ku vendoset vetëm një kategori e veçantë, a banë me na sqarua qysh ecet tutje, pra a e keni të qartë përse është kthyer çka kërkohet?
**Abdulla Gashi-IDEAL:** z. Nura kisha pas dëshirë me hollësisht me na tregua përse është kthyer ky vendim negativ nga MAPL-ja, dhe gjatë seancës së kaluar kam kërkuar që mos të ngutem me ketë vendim?
**Musa Fazliu-IDEAL:** Fjala përshëndetës, me qenë së jam anëtar i këtij komisioni, kam pas thirrje prej shumë familjarëve të familjeve të dëshmoreve, dhe brenga e tyre është së qysh do të bëhet shpërndarja e këtyre banesave, dhe përgjigja ime ka qenë së ende nuk kemi marr përgjigje nga MAPL-ja për vendimin. Tu kisha lut kryetar mos të ngutem së kjo kategori është shume e ndjeshme, dhe 25 vite masë lufte kishe familje dëshmoreve që nuk kishin strehim dhe kjo është marrja me e madhe e PDK-së që kur kam qenë edhe unë anëtar në këtë parti, dhe të mos ngutem më këtë vendim.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Faleminderit të gjithëve për kontributin, kritikat, sugjerimet, po i marr si të mirëqena, unë kam qenë deputet i kuvendit nga opozita, dhe një kërkesë për një ligje të tillë duhet me marr miratimin e shumicës, dhe duhet minimumin e njohurive për një pyetje të tillë, dhe tash kemi me aplikua Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, që e kanë aplikua disa komuna tjera, këtë ligj.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Hysni Mehani-LVV:** Ma shume në aspektin procedural çështje teknike kjo fjalia Gllavica duhet të tërhiqet prej propozimit mos me ekzistua sepse po tingëllon jo mirë sepse është fjale serbe, sepse nesër jepen këto banesa, familjeve të dëshmorëve ndoshta kjo fjali dikën ka me pengua, për mendimin tim.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Besiana Thaçi-PDK:** Fjala përshëndetës, tu e pas parasysh së Hysni Mehani është përfaqësues i LVV, në këtë kuvend, me thanë drejtën u befasova që e paska pengua një fjali serbisht, tu e pas parasysh së shefja e grupit parlamentar Mimoza Kusari i shprehet serbisht, shqip, e këtu po e pengon një fjali serbisht, është absurde.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Ato emra ne gjuhen serbe ekzistojnë fatkeqësisht në sistemin kadastral, dhe ne nuk mundemi me i ndryshua, sepse ato emra e verifikojnë pronën në certifikatë që nxjerrët nga sistemi.

**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (2) kundër dhe (5) abstenim miratohet Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016899/24, të datës 03.04.2024, për formimin e komisionit për ndarjen e banesave për familjet (të ngushta) të Dëshmorëve të UÇK-së.
Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016898/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi për ndarjen e banesave për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, me Nr.02-020/01-0023061/24, të datës 15.05.2024, (Raporton);
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura;** Para vetes e keni Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi për ndarjen e banesave për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së, i njëjti është si propozimi paraprak vetëm ky është për komision të ankesave, ju ftojë me përkrah.
**Kryesuesja:** E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (15) vota për, (2) kundër dhe (2) abstenim, miratohet Propozim-vendim për shfuqizimin në tersi të vendimi Nr.01-020/01-0016898/24, i datës 03.04.2024, për themelimin e komisionit të kuvendit komunal për shqyrtimin e ankesave përkitazi për ndarjen e banesave për familjet e Dëshmorëve të UÇK-së.
Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 1 (një), deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor që gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me Nr.02-463/01-0023751/24, të datës 21.05.2024, (Raporton:
**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Para vetes e keni Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 1 (një), deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor që gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, për familjet e ngushta të dëshmorëve, materialin e keni para veti, jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja:** E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (6) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin paraprak të vendimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 1 (një), deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor që gjendet në parcelën P-72015063-00671-0
Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor qe gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me Nr.02-020/01-0023754/24, të datës 21.05.2024, (Raporton;
**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Ky propozim vendim ka të bëjë me formimin e komisionit që ka me u marr me procedurën dhe zbatimin e kritereve deri në fazën kur vjen vendimi në kuvend, komisioni propozoj të jetë aj që ka qenë, përjashtimisht një anëtar nga kuvendit të zëvendësohet me një anëtar nga ekzekutivi, sepse ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës e përcakton kështu 2 anëtar nga ekzekutivi, 2 legjislativi dhe një anëtar shoqëria civile, ose Miradija ose Besiana të deklarohen që të tërhiqen, që të zëvendësohen me Armend Musliun, që është shërbyes civil në DSHMS-së.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;

**Hysni Mehani-LVV:** Tash është procedurë e re, dhe duhet me formua një komision krejt të ri, të natyrës të re, çka po thotë Nura, këtë mundet me thanë në parti, jo këtu, sepse këtu është një procedurë krejt tjetër dhe duhet një komision i ri.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Hysni komisioni është i njëjtë, i natyrës së njëjtë, me kompetenca të njëjta vetëm një anëtar ndryshon behën dy anëtar nga legjislativi.
**Kryesuesja:** Kërkojë njëra nga anëtaret e kuvendit të deklarohen së cila të tërhiqet nga komisioni, që të zëvendësohen nga anëtari i ekzekutivit Armend Musliu, fjalën ja kaloj;
**Besiana Thaçi-PDK:** Atëherë unë tërhiqem nga ky komision në mënyre shume të vullnetshme.
**Kryesuesja:** Atëherë shkojmë në votim Konstatojmë me (16) vota për, (5) kundër dhe (3) abstenim, miratohet zëvendësimi i anëtares Besiana Thaçi me anëtarin nga ekzekutivi Armend Musliu, dhe Propozim-vendim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor qe gjendet në parcelën P-72015063-00671-0, me këtë përbërje të komisionit:

1. **Albinot Mehmeti** – anëtar nga ekzekutivi,
2. **Armend Musliu** - anëtar nga ekzekutivi,
3. **Miradije Buliqi** - anëtare nga legjislativi, PDK,
4. **Musa Fazliu** - anëtar nga legjislativi, IDEAL,
5. **Brahim Misimi** - anëtar nga shoqëria civile (ShFD e UÇK-së).

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, me Nr.02-463/01-0023907/24, të datës 22.05.2024, (Raporton kryetari i komunës n' mungesë drejtoreshës);
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Para vetes e keni Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, ky këmbim ka të bëjë në fshatin Marinë, ju ka marrë prona për rrugë, personi ka bë kërkesë për këmbim.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Hysni Mehani-LVV:** A këna të bëjë me propozim vendim për këmbim të pronës me person fizik, a me rishqyrtim të vendimit sepse vendimi është në kundërshtim me paragrafin 5 të nenit 25 të ligjit Nr.06/L-092, a jena tu e bë rishqyrtimin e vendimit a jena tu e bë një propozim prej fillimit a e keni të qartë së çka po propozoni.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Kemi procedurë të re të këmbimit, për arsye së rastet e tilla kur ka kërkesë për këmbim nga personi, propozimi duhet të iniciohet nga kryetari dhe për atë duhet procedurë e re, sipas rekomandimeve të MAPL-së.
**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (9) kundër dhe (2) abstenim miratohet Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti,
Vazhdojmë me piken 10 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik juridik Ismet I. Mustafa B.I, me Nr. 02-463/01-0023908/24, të datës 22.05.2024, (Raporton kryetari i komunës n' mungesë drejtoreshës);
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Edhe këtu kemi një Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik juridik Ismet

I. Mustafa B.I, për realizimin e rrugës 17 shkurti, e kemi përfundua këmbimin një pjesë të madhe ka mbet edhe kjo pjesë, materialin e keni përpara, jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Osman Smajli-IDEAL:** Kryetar prej kur ja keni nis me bë vlerësimin e pronave, së në çdo seancë së pari e kemi bë këmbimin tani e keni bë vlerësimin?
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Ke drejt plotësisht se para një muaj nga MAPL-ja po kërkohet vlerësimi i pronave pa e bërë këmbimin, e me herët nuk ka qenë kështu.
**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (9) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik juridik Ismet I. Mustafa B.I.
Vazhdojmë me piken 11 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për rishqyrtimin dhe miratimin e dokumentit Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2028 për Komunën e Skenderajt, të harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së, me Nr.12-313/01-0023818/24, të datës 21.05.2024, (Raporton;
**Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi**; Fjala përshëndetëse, para jush e keni Propozim-vendim për rishqyrtimin dhe miratimin e dokumentit Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2028 për Komunën e Skenderajt, të harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së, që përfshinë përshtatjen në UA, të MAPL-së si dhe në kuadër të objektivave të propozuara nga dy objektivat strategjike, materialin e keni para veti me ndryshime, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Hysni Mehani-LVV:** I kam dhënë mendimet për këtë strategji, dhe mendoj që është strategjia me kotë, që është gjynah që i ka marr 8 mijë €, ajo kompani, po unë me sa e di sipas ligjit për LVL, a je sigurua që kjo kompetencë mundet me ju delegua dikuje tjetër, a e ke bazën ligjore të sigurt, sepse është një kompetencë që kuvendi komunal nuk e delegon.
**Floriana Halili-LVV**- Fjala përshëndetëse, drejtoresh tek strategjia e zhvillimit tek kultura e sporti, të fokusi kryesor e keni cek edhe promovimi i trashëgimisë kulturore, dhe e kemi pa fokus kryesor e keni pas rrënimin e trashëgimisë kulturore siç ndodhi të shtëpia e kulturës në Runik, deri sa qeveria edhe ja ndaloj atë, a është ky fokusi juaj?
**Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi**; Me ndryshimet që janë bërë, besoj që ky është një prej strategjitë me të mira, i kamë përcjellë me vëmendje gjitha strategjitë që janë miratuar nga komunat tjera, dhe besoj që strategjia jonë është dukshëm me e mirë, me i krahasua me strategjitë tjera.
**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (7) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendim për rishqyrtimin dhe miratimin e dokumentit Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-28 për Komunën e Skenderajt, të harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së.
Vazhdojmë me piken 12 të rendit të ditës:
-Propozim-vendim për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim 2024-2026, në Komunën e Skenderajt, me Nr.08-060/01-0023492/24, të datës 20.05.2024, (Raporton;
**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi**; Fjala përshëndetëse, para jush e keni -Propozim-vendim për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim 2024-2026, në Komunën e Skenderajt, ky dokument ka për qellim të ndihmohen familjet që kanë nevojë për banim social që nuk kanë mundësi vetanake për ta sigurua strehimin, janë të përfshira bonuset e banimit, ndërtimin e shtëpive, renovimin e shtëpive individuale përmes buxhetit të komunës dhe donatorëve të ndryshëm, familjet që janë në kategori sociale, nenave vetushqyese, të riatdhesuarve dhe kategorive të dalura nga lufta.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Hysni Mehani-LVV:** E kam një kërkesë, leje punën e banimit, po a ka mundësi personave me nevoja të veçanta me ja sigurua një nxemjë edhe një person që me mbajt derën hapur, sepse ky është kriter minimal për këta persona, tani me fole për banim social, se e kam përshtypjen këtë po e bëni vetëm me marr një tik, për performanc.
**Abdulla Gashi-IDEAL:** Drejtoresh a e ke ndërmend me i largua ato familje që i kanë kushtet e mira që kanë shtëpie banës.
**Mentor Mehmeti-PDK:** Hysni kërkesa e jote është shume legjitime po aj objekt e ka nxemjen që ju ka ofrua prej komunës që dy muaj, që komuna e ka marr si grand dhe e falënderoj drejtoreshën që ka qenë shume e afër më ketë kategori.
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;
**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi**; Handikos ka qenë përfitues i një projekti prej bankës botërorë pikërisht për nxemje vlera ka qenë 9 mijë € dhe DSHMS, ka ndihmua vitin e kaluar prej subvencioneve me vlerë 12,500.00€, për blerjen e pajisjeve fizioterapike dhe nevojave tjera, edhe ketë vite kemi në plan me i ndihmua sipas kërkesave tyre. Sa i përket banesave sociale në shtator skadon kontrata dy vjeçare dhe ka me u bë vlerësim i banorëve.
**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (7) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Programit komunal trevjeçar për banim 2024-2026, në Komunën e Skenderajt.
Para së të fillojmë me pikën 13, në bazë të rregullores të kuvendit kryetari i komunës ka drejtë të bëjë propozime për pikë shtesë aty për aty, për shkak së propozimi ka ardhur aty për aty, fjalën ja kaloj;
**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Për shaka të urgjencës të planifikimit të 18 qershorit, i propozoj këtij kuvendit Propozimi-vendimi, për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Bardhyl Mahmuti, një veprimtar i çështjes kombëtar në mënyrë që me 18 qershore ta shpallim qytetar nderi tija japim një epitet tillë.
**Kryesuesja:** Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, futet si pikë shtesë Propozimi-vendimi, për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Bardhyl Mahmuti, fjalën ja kaloj kryetarit për sqarime shtesë.
**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Titulli "Qytetar Nderi" për z. Bardhyl Mahmuti, jepet në shenjë respekti dhe mirënjohje për veprimtari patriotike në shërbim të vendit, për sakrificën si i burgosur politik për kontributin e dhënë në luftën çlirimtare, kontributin e tij si udhëheqës i Grupit Diplomatik të UÇK-së, si dhe për meritat në ndërgjegjësimin e opinionit ndërkombëtar për krimet e gjenocidit të kryera nga shteti serb ndajë shqiptarëve gjatë luftës 1998-1999. Me miratimin e këtij vendimi, Titulli "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt, do ti ndahet në seancën solemne, që do të mbahet me 18 Qershor, me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Skenderajt
**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, Konstatojmë me (22) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, miratohet, Propozimi-vendimi, për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Bardhyl Mahmuti,
Vazhdojmë me piken 14 të rendit të ditës:
-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj:
**Afrim Kabashi-IDEAL**: 1. Për Kryetarin Fadil Nura: Kryetar deri ku ka arrite projekti në realizimin e fabrikës së industrisë së drurit dhe prodhimeve te betonit në Fshatin Polac, i miratuar ne dhënien ne shfrytëzim afatgjate deri 99 vite nga kuvendi komunal ne seancën e datës 29.04.2022. Po ashtu kryetar a keni mundësi të na njoftoni deri ku ka arritur të konkretizohet "Projekti Solar në fshatin Leçine" ku kuvendi komunal ka dhënë pëlqimin në këtë projekt? 2. Për

Drejtorin për Urbanizëm Ylber Morina: Drejtor a mund qe me mundësit buxhetore për këtë vite te intervenoni ne rrugën "Martiret e Polacit" prapa xhamisë e cila është e dëmtuar jashtëzakonisht shume, dhe kërkohet ne intervenim nga banoret e asaj lagje!
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Kryetarit i Komunës, Fadil Nura:** Afrim kontratën e kemi të nënshkruar me operatorin ekonomik e kemi afatet nëse nuk ju përmbahet kontratës ja shkëputem e shfuqizojmë vendimin dhe toka ju kthehet komunës. Për parkun solar kjo kompetencë ka kalua në nivel qendror në ministrin e bujqësisë, nuk e di çka ka ndodh, dhe nuk është me kompetencë komunale.
**Drejtori i DUMA-së, Ylber Morina:** Afrim rrugën prapa xhamisë e kemi identifikuar ajo rrugë është a asfaltuar po ka nevojë për mirëmbajtje, e kemi një kompani të kontraktuar për mirëmbajtje të shohim kemi me përfundua.
**Naser Bajraktari-IDEAL:** Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit: Për Tribunat e stadiumit a pritet me fillua ne këtë vit se veç javë kini rrënua lokalet dhe s'është kah punohet hiq u banë 5 muaji kurse ata njerëz tu prit për lokale?
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DUMA-së, Ylber Morina:** Jemi në ngjarje punët nuk janë duke u zhvilluar të stadiumi, para një jave operatorit ja këna dërgua një shkresë, dhe ja këna dhënë një afat ligjor për me ja fillua punën, po ekspertet e drejtorisë së urbanizmit dhe operatori ekonomik e kanë konstatua një gjetje aty, së ka ujëra nëntokësorë dhe për atë punimet nuk po munden me u zhvilluar, po shume shpejt masi të largohet ujë kanë me fillua punimet, paret janë, nëse nuk punohet ja shkëputem kontratën.
**Abdulla Gashi-IDEAL:** Pyetje për Drejtorin e urbanizmit: 1.Drejtor, a ke mundësi me tregu diçka për ujësjellësin qe iu mundëson ujë te pijshëm fshatit Kryshec dhe Marine, kur pritet me fillua ky projekt, pasi qe është bere matja prej lokacionit Rezalle deri ne Kryshec, si dhe në buxhet e keni parapare për vitin 2024 këtë ujësjellës? 2. Drejtor, a ke mundësi me na sqarua diçka për rrugën e Kozhices, a pritet me e qua këtë rruge deri në Qyqavice apo u ndërpre, e nëse nuk është ndërpre pse nuk po vazhdoni me e qua rrugën deri në Qyqavice. 3. Drejtor, a ke mundësi me na sqarua diçka sa i përket kanalizimeve ne fshatin Mikushnice, në disa lagje siç janë lagja "Shabani", lagja "Ferizi", lagja "Islami", lagja "Zenuni", pse nuk janë të kryera kanalizimet edhe a keni parapare për këtë vit qe këto kanalizime te përfundojnë? Ju lutem na sqaroni
**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DUMA-së, Ylber Morina:** Një projekte për ujësjellës është duke u zhvillua, projekti në Burojë, Polac, dhe në Burojë kanë me përfundua kyqjet individuale dhe ky projekt do të vazhdoj edhe në Kryshec, Polac, Marinë, po edhe kyqjet individuale. Projekti i rrugës për Qiqavic e kemi një pengës me Agjensionin e Pyjeve, kemi bë kërkesë, ende nuk na kane kthyer përgjigje jemi tu prit, po se shpejti ka me fillua. Kanalizimi në Mikushnic është një projekt prej pandeminë, po për shkak të mungesës së buxhetit janë ndërpre punimet dhe nuk kanë filluar më për shkak të rritjes së çmimeve, dhe kompania ka paraqitë kërkesë për shkëputjen e kontratës, dhe nuk ka një planifikim në buxhet për atë projekt.
**Kryesuesja;** Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi | Kryesuesja e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E SKENDERAJT KUVENDI KOMUNËS · REPUBLIKA KOSOVA SKUPŠTINA SKENDERAJ SKUPŠTINA OPŠTINA · REPUBLIC OF KOSOVO MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ

Nr.
No. 01-060/01-0034329/24
Data
Data 22.07.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme, i mbajtur me datë **12.06.2024**, në ora **13:00,** në sallën e kuvendit.

**Në këtë mbledhje ka pas për diskutim këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Subvencionet në bujqësi për fermerët e komunës së Skenderajt nga drejtoria e bujqësisë, (Raporton drejtori DBPZHR-së, **z. Behxhet Maliqi**).
4. Raport nga Drejtoria e Arsimit, për skandalin në Gjimnazin "Hamëz Jashari" në Skenderaj nga drejtoresha e kësaj shkolle, (Raporton drejtori i DKA-së, **z. Kastriot Duraku**);

**Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:** Të nderuar anëtar të kuvendit, Kjo seancë është thirrur me kërkese të anëtareve të kuvendit. Shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 12 anëtar, në bazë të rregullores, mbajtja e mbledhjeve të kuvendit mbahet nga gjysma e anëtareve të kuvendit, e me qenë se nuk ka kuorum, mbledhja nuk mbahet për arsye të kuorumit, këtë mbledhje e paraqes të mbyllur, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E SKENDERAJT · KUVENDI I KOMUNËS · REPUBLIKA KOSOVA · SKUPŠTINA OPŠTINA SKENDERAJ · REPUBLIC OF KOSOVO · MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0034329/24
Data 22.07.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

**Kuvendi i Komunës**/SkupštinaOpštine/MunicipalityofAssembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës **28.06.2024,** ora **10:00.**

**Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in, me Nr.04-052/01-0027698/24, i datës 13.06.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
4. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, me Nr.02-110/01-0027864/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtoresha e DSHMS-së, **znj. Rrezarta Hasani-Ibrahimi**);
5. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në Komunën e Skenderajt, me Nr.02.110/01-0027865/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z. Alban Shala**);
6. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në Komunën e Skenderajt, me Nr.02.110/01-0027862/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z. Alban Shala**);
7. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027, në Komunën e Skenderajt, me Nr. 02-110/01-0027863/24, i datës 14.06.2024, (Raporton drejtoresha e DZHENIT-së, **znj. Besarta Meha-Ademi**);
8. Raport i Ndërmarrjes Komunale NPL, "Eko Natyra" SH.A. Skenderaj, për vitin 2023, me Nr.001-023/24-007, dt. 27.02.2024, (Raporton Aksionari i Ndërmarrjes **z.Behxhet Maliqi**);

   **Pikat shtesë:**
9. Propozimi-vendimi, Për shpalljen **"Qytetar Nderi"** të Komunës së Skenderajt **z. Benito Mares,** Nr.02-170/02-0029548/24, të datës 27.06.2024, (Raporton Kryetari i Komunës, **z. Fadil Nura**);
10. Propozim-vendimi për rishpalljen e pronës, Pronë me Interes Publik, me Nr.02-463/01-0029523/24, te dt.27.06.2024, (Raporton drejtoresha e DGJKP-ës, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
11. Raporti i ndërmarrjes së mbeturinave KRM "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023, më Nr.01-052/01-0029321/24, të datës 26.06.2024, (Raporton, Aksionari i ndërmarrjes **z.Ruzhdi Koca**);
12. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

**Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:** I nderuar kryetar i komunës z. Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 28 anëtar, mungon me arsye Armir Sejdiu, Osman Smajli dhe Ragip Durmishi.
Para se të fillojmë me miratimin e rendit ditës, i kemi tri pika shtesë për ketë mbledhje

1. Propozimi-vendimi, Për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares, Nr.02-170/02-0029548/24, të datës 27.06.2024,
2. Propozim-vendimi për rishpalljen e pronës, Pronë me Interes Publik, me Nr.02-463/01-0029523/24, te dt.27.06.2024,
3. Raporti i ndërmarrjes së mbeturinave KRM "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023, më Nr.01-052/01-0029321/24, të datës 26.06.2024.
Shkojmë në votim për së cilën pikë, për futjen në rend dite:
-Konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, Propozimi-vendimi, Për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares, Nr.02-170/02-0029548/24, të datës 27.06.2024, futet si pikë shtesë, në rend dite.
-Konstatojmë me (17) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, Propozim-vendimi për rishpalljen e pronës, Pronë me Interes Publik, me Nr.02-463/01-0029523/24, te dt.27.06.2024, futet si pikë shtesë, në rend dite.
-Konstatojmë me (17) vota për, (8) kundër dhe (0) abstenim, Raporti i ndërmarrjes së mbeturinave KRM "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023, më Nr.01-052/01-0029321/24, të datës 26.06.2024, futet si pikë shtesë, në rend dite.
Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, fjalën ja kalojë:
**Musa Fazliu-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, nuk jam kundër pikës Për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares, po për dy pikat tjera që kish pas mundësi me i mbajt dy seanca në muaj së edhe ashtu po ka pika shume tash edhe pikat shtesë, po ashtu edhe me fillua mbledhja me kohe.
**Hysni Mehani-VV:** Fjala përshëndetëse, vazhdoj me qenë prapa kërkesës që me raportua drejtori i bujqësisë, po me qenë së ju e keni pranuar që ka keqpërdorime mundeni edhe mos me raportua. Pika që ka të bëjë me Unitetin për besë nuk është dashur me protokollua sepse nuk ka nënshkrim, sepse nuk dihet kush e ka adresua këtë raport, dhe nuk e di përse është bërë për ngutë, edhe jemi me tri pika shtesë, jemi jashtë çdo rregullore.
**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj:
**Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura:** Fjala përshëndetëse, këtë çështje që e ngriti opozita që është argumentuese e përkrahi e përkrahi gjithmonë, dhe këtë raport të Unitetit edhe unë kisha propozua me kalua në seancën tjetër, po e shohë nuk ka nënshkrim dhe është protokollua pa nënshkrim, dhe nuk guxojmë kësi raporti me procedua, dhe e mbështeti kërkesën e z. Mehani dhe nëse ju pajtoni e kishim lan për seancën tjetër.
**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj:
**Naser Bajraktari-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, edhe unë jam që ketë raport të Unitetit me kalua për seancën tjetër, për shkak së kompania e Unitetit është kompani regjionale, është një raport shume i cektë, ose nuk është asgjë, sepse kompania është me shume telashe me shume probleme, dhe është mirë me ardhur një përgjegjës me raportua këtu, sepse e ka obligim ligjor me raportua për çdo vite për punën.
**Afrim Kabashi-NSD:** Fjala përshëndetëse, edhe unë pajtona që ketë raport të Unitetit me kalua për seancën tjetër, për arsye së ka shume mangësi.
**Kryesuesja:** Atëherë me propozimin e kryetarit dhe të anëtareve Konstatojmë me (28) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Raporti i ndërmarrjes së mbeturinave KRM "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023, largohet nga rend i ditës, dhe shtyhet për një seancë tjetër.
**Kryesuesja;** Vazhdojmë me miratimin e rendit ditës, konstatojmë me (17) vota për, (6) kundër dhe (2) abstenim, Miratohet Rendi i Ditës.
Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in,Nr.04-052/01-0027698/24, dt.13.06.2024, (Raporton);
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Kornizën Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, një dokument që është hartuar nga ekzekutivi i komunës i udhëhequr nga kryetari i komunës, është një nder fazat preliminare drejtë hartimit të buxhetit final diku ka fundi i gushtit, baza e këtij dokumenti është në qarkoren e buxhetit 2025/01. Burimet e financimit të komunës janë të bazuara në ligjin për financa të pushtetit lokal duke u ndarë sipas kritereve; Grandi i përgjithshëm, për arsim, për shëndetësi, shërbimet rezidenciale, dhe të hyrat vetanake. Nëse i analizojmë burimet financiare për tri vite atëherë shohim së grandi i përgjithshëm është me i lartë prej 8.02%, grandi për arsim 3.97%, ndërsa me i ultë është grandi për shëndetësi për 0.94%, shërbimet rezidenciale janë te njëjta, ndërsa të hyrat vetanake janë 31.57%, nëse e analizojmë në total buxheti i komunës për vitin 2025 pritet të jetë 19,881,471.00€, në faqen 17 e keni tabelën e projekteve kapitale për ti vite. Krahas këtij dokumento kryetari i komunës ka mbajtur dëgjime buxhetore për ketë kornizë, 4 dëgjime buxhetore, në të cilën janë paraqitë kërkesat e qytetarëve nga të gjitha shtresat e ndryshme, dhe jemi mundua me i paraqit ato kërkesa sidomos në investime kapitale, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj, kryetarit mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in;
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Korniza Afatmesme e Buxhetit 2025-2027, është një dokument i cili e ruan brenda saj paranë buxhetore dhe ndarjen në kuptimin të vijave të trasha, ne i kemi mbajtur 4 dëgjime buxhetore me grupet e caktuara të interesit, përfshin edhe grupet e mëgjenjerizuare dhe e kemi përmbush një detyrim ligjorë sa i përket marrjes së të dhënave dhe kërkesave dhe nevojave e atyre grupeve të interesit. Kjo është vetëm kornizë, buxhetin për tri vite e ardhshëm e keni në shtatorë, ju ftojë të gjithëve të jepni kontribute në mënyrë që bashkërisht të plotësojmë.
**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:
**Kushtrim Dragaj-PDK:** Fjala përshëndetëse, pasi që drejtori i urbanizmit nuk qenka këtu kisha pas dëshire një përgjigje rreth projektit, Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së objekti U-së, është planifikuar buxhet për vitin 2026, shuma 233,553.22€, dhe për vitin 2027, shuma 400,00.00€, kurse ne veç e kemi formua komisionin për shpërndarjen e banesave. Kurse të projekti Ç, dhe K, këto janë projekte të reja, po të shkronja U, që është vazhdim kisha dashtë një përgjigje, a është gabim teknik apo çfarë? Edhe të drejtoria e shëndetësisë, projekti Renovimi i QKMF-së (urgjencës), për vitin 2026, shuma 619,316.53, dhe 2027- shuma 619,316.53, a janë parapa krejt investimet në kuadër të drejtorisë apo është gabim teknik?
**Besart Rrecaj-PDK:** Fjala përshëndetëse, i kam tri pyetje, për projektet kapitale 2025-27, të projekti; Ndërtimi i zonave rekreativë ne qytete, ne qytat besoj është gabim teknik shuma 40,000.00€ për vitin 2025, ndërsa shuma 150,000.00€ për vitin 2027, a mundesh me na tregua për çka bëhet fjalë? Të projekti, Vendosja e një billbordi shuma 20,000.00€ po me doket pak shume e lartë për mendimin tim? Dhe projekti Unaza e brendshme 3 krahu ka Llausha, për vitin 2025 shuma 324,047.50€, përse u ndërpre për vitin 2026 dhe për vitin 2027 shuma 100,000.00€? Dhe e kam një kërkese për fshatin Llaushë e kam parashtrua edhe vitin e kaluar, për një trotuar të shtohet në ketë listë të projekteve për rrugën Ramiz Haziri, Llaushë, dhe besoj që kjo kërkesë të merret parasysh.
**Hysni Mehani-LVV:** Kjo veç kornizë nuk është, korniza i parasheh vijat e trasha qysh planifikohet buxheti, nëse hina të drejtorit, isha interesua me pa drejtorin e njohur të dallavereve, nuk e jep as një specifik së çka ka me bë, e ka një faqe raport. Drejtor i kam disa çështje të projektet kapitale si; Dron me pajisje përcjellës, shuma 6,000.00€, për çka na duhet ky dron dhe në shërbim

të kujt shkon? E pash që është e planifikuar punëtore shtesë për çerdhe, e di që ministria e arsimit ka deklaruar së ka buxhet të mjaftueshëm për çerdhe po duhet me ardhur kërkesa prej komune, me u nda parcela, e di që është Polaci i planifikuar dhe nuk e pash të investimet kapitale, e di që i ka shkua kërkesa për Rezallë. Sa çerdhe janë parapa ose do të funksionalizohen në te ardhmen, apo vetëm këto dyja që i keni gjete e nuk po mundeni me tjera? Dhe qysh planifikohet rregullimi i transportit publik, sepse nuk ka një kod buxhetor, që fillon me subvencionua edhe transportin publik së besoj që gjitha qytetet e kanë prioritet p.sh si Prishtina?

**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Të projekti i objektit të dëshmorëve jemi orientua me bë çmos me fillua edhe objektin e dytë, sigurisht këtë projekt planifikojmë me filluam me reduktua në formë kaskadave me i shkurtua dhe do të kërkojmë nga qeveria dhe donatoret tjerë që me fillua vitin e ardhshëm objektin e dytë. Të projekti ndërtimi i zonave rekreative kemi disa ide në Runik p.sh me bë një lagje, të lagjja rekreative që ka ekspert që na kanë prezantua, sepse Runiku është pjesë e thesarit arkeologjik dhe kjo është e parapamë vitin 2026-27, po nuk është stërkitë mund ndryshohet dhe mos e merrni gjithçka të përfunduar në KAB. Të projekti i trotuarit kjo është kërkese e mirëseardhur, ti shohim mundësit buxhetore. Të kualifikimi, duhet me qenë shume ekspert me thanë veç kornizë nuk është, pa as një ditë përvoje punë në fushën e financave në institucione publike. Në fillim të mandatit kemi dërguar kërkesa për çerdhe për çdo BL, ku e kemi pa të nevojshme, me dokumente të pronësisë dhe ende nuk kemi përgjigje nga ministria dhe në kuadër të kësaj e kemi parapa rritje të stafit. Transporti publik në Skenderaj nuk krahasohet me Prishtinën sepse Prishtina e ka një ligj të veçantë së ka kompetencë dy fish sa komuna jon, dhe Prishtina transportin publik e ka të rregulluar me ndërmarrje publike, dhe ne nuk mundem me i subvencionua firmat private të qarkullimit rrugorë. Droni është kërkesë e zyrës për informim, që do të jetë aset i komunës dhe do të jetë në funksion të prezantimeve të çdo eventi që bëhet për faqe të komunës.

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** KAB-i, është një dokument drejt hartimit të buxhetit final, dhe do të kaloj edhe dy faza tjera deri sa të kaloj për aprovim në shtator. Në faqen 17 e kam strukturuar buxhetin dhe mundeni me pa saktë si do të jetë buxheti në përqindje po edhe në kufirin ekzistues të marr nga qarkorja buxhetore 2025/01, në kufirin përfundimtar 19,881,471€, dhe nuk besoj që do të ketë ndryshime sa i përket kufirit përfundimtar, po do të ketë ndryshime neper kategori ekonomike. Për projekte kapitale së cili drejtor i drejtorive e ka pas kërkesën e vetë rreth projekteve kapitale, dhe KAB-i e definon rreth 90% të pjesës së shpenzimeve kapitale e të gjitha kategorive. KAB-i është një dokument që ka me u dorëzua në ministri dhe ka me u analizua. Sa i përket çerdheve ne e marrim grandin specifik për arsim dhe ky grand vjen prej numrit të nxënësve, dhe kemi zvogëlim të numrit të nxënëseve i kemi 343 nxënës me pak, po grandin e kemi rritë 3.97%, në grandin për arsim nuk janë parapa mjete shtesë me përjashtim prej 56,518.00€, na kanë qitë për projekte kapitale për arsim për vitet në vijim, ne i kemi shtua edhe 100,000.00€ që drejtoria e arsimit ti ketë për projekt.

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi:** Sa i përket pyetjes së Kushtrimit ke plotësisht drejt, qenka një gabim teknik gjatë përpilimit të KAB-it, të renovimi ti QKMF-ve planifikohen veç 15,000.00€ për vitin 2025, ndërsa për vitet tjera është gabim teknik. Edhe të furnizimi me pajisje mjekësorë për vitin 2025 shuma 25,534.00€, për vitin 2026 shuma 25,000.00€ dhe për vitin 2027 shuma 50,000.00€.

**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:

**Liridona Koci-PDK:** Fjala përshëndetëse, pyetje për drejtorin e urbanizmit, a mundesh ma detajishte me na tregua kur do të fillojë riparimi-asfaltimi i rrugëve në Polac se tash dy vite janë të trasuar dhe nuk po vazhdojnë, po ashtu edhe për kanalizim, ku dihet së ka pas disa probleme

pikërisht të lagjja Veliu, po tash ato probleme janë të zgjidhura, dhe ekzistojnë edhe disa lagje tjera që kanë probleme me kanalizim po nuk janë të riparuara dhe në çdo kornizë ka qenë vetëm vazhdimësi, kur do të fillojnë këto drejtor? I kam disa pyetje për drejtorin e arsimit po me qenë së nuk është këtu po i tërhiqi, po vazhdoj vetëm me një pyetje për kryetarin A ekziston ndonjë mundësi që komuna të marr përsipër transportin për nxënësit neper fshatra deri në shkollë, për arsye mos boshatisjes së fshatrave?

**Besart Rrecaj-PDK:** Sa i përket buxhetin për vitin e ardhshëm 19,881,471.00€, a është marr parasysh që kur dalin rezultatet e popullsisë, dhe numri i banorëve ndoshta bie, bien edhe buxheti që vjen prej nivelit qendror, a është marr parasysh ky faktor?

**Hysni Mehani-LVV:** Subvencionimin e transportit mundeni me bë edhe të kompanitë private, ku e merr për sipër një pjesë të pagesës. Kur keni ardhur në pushtet i keni gjete dy çerdhe tu u ndërtua, një të shkolla Anton Çeta që e keni ndalua punimet, nëse është fajtore ministria për ndaljen e punimeve, që nuk është e vërtet, çka po ndodh me çerdhen të shkolla Shaban Jashari kush po e pengon atë, kush ja rrënoj oborrin asaj çerdhe? Unë e di që për çerdhen në Polac është miratuar dhe është në proces, po përse nuk po fillon duhesh me na tregu, po pa tendenca?

**Ilir Ejupi-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, pyetje për DU, të projektet për BL, të Çirezit, Polacit, është projekti i rrugës Dashec-Polac, dhe projekti i rezervarit në Brus, a keni parapa mjete për këto dy projekte,

**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Liridona pagesën për transportin për nxënës jemi tu e bë, po ekziston një UA, që e përcakton distancën prej 5km që e kemi obligim, që kapacitetet buxhetore i kemi të limituar, dhe nuk mundem një fshat po, e një fshat jo, dhe me pas mundësi skish pas problem, dhe nuk është ky problemi i boshatisjeve të fshatrave janë disa probleme tjera. Të kanalizimi e kemi nënshkruar një kontratë dhe shume shpejt kemi me fillua, edhe degëzimet e rrugëve i kemi fillua në Klinë dhe pastaj kemi me fillua në Polac. Çerdhja të shkolla Anton Çeta, ka qenë projekt i dështuar, kur jemi ardhur për atë projekt kanë shkua në suficit 50mijë €, sepse organi mbikëqyrës dhe kontraktuesi nuk kanë mundur me nënshkrua sepse ka qenë një projekt i keq, nuk e kam akuzuar askënd, po ketë ma kanë thënë ekspertet. Çerdhja të shkolla Shaban Jashari, është financuar nga fondet e BE-së përmes ministrisë, i kemi rregullua ato lëshime, kemi bë kërkesë për rritjen e stafit, dhe projektin e ka vonua vet BE-ja, dhe me 1 shtator kemi planifikuar me fillua. Sa i përket kërkesave për çerdhe i kemi dërgua në ministri për çerdhe për Polac, Çirez, Likoc, Runik me krejt dokumentacionet përcjellëse, dhe të Polaci, na ka kthye së një pjesë e oborrit të shkollës ish në pronësi të agjensionit të pylltarisë dhe pa pëlqim të ministrisë nuk ta japin të drejtën e ndërtimit në atë pronë. Projekti i rrugës Dashec-Polac, mundësin e parë qe e kemi do të fillojmë, po aj projekt kushton shumë. Sa i përket rezervarit në Brus aj projekt është hekë nga qeveria dhe aj projekt e zgjedh problemin me ujë të gjithë qytetarëve të komunës ton.

**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:

**Floriana Halili-LVV:** Drejtor e pash së një projekt Trotuar dhe ndriçim në BL, Runik, a mundesh konkretisht në cilat vende në Runik, sepse në qendër në Runik nuk ka pas nevojë me i ndërrua kockat, e ja keni dhënë bashpartiakut të juaj, dhe nuk është normale, a ka pas procedurë qysh kanë funksionuar këto? Dhe a është në planifikuar të buxhetit rregullimi i rruga Ejup Halili, në Kosterrc?

**Abdulla Gashi-IDEAL:** Pyetje për DU, sa i përket projekteve kapitale, në seancat e kaluara kam kërkuar që të futen në plan fshati Mikushnic, fshatin Marinë, fshatin Polac për rrjetë të kanalizimit?

**Afrim Kabashi-NSD:** Unë kam pas shume me diskutua, po masi që shumica e kolegëve i parashtruan ato kërkesa unë e kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë, A keni parapa diçka për trajtimin e qenve endacak, të cilët janë shume aktiv si në fshatra po ashtu edhe në qytet?

**Arjeta Rama-PDK**: Fjala përshëndetëse, pyetje për DSHMS-së, drejtoresh si ti ndihmojmë nenat lehona a behet fjalë për një shume të caktuar që e keni përmend me herët apo është një lloje ndihme tjetër? Për DUMA-së, drejtor rruga Magjistrale Skenderaj-Mitrovicë, konkretisht të rrethi të Klina e Poshtme mungon ndriçimi publik, e di që është kompetencë e ministrisë, po a jeni interesuar për me rregullua atë ndriçim, për arsye së qytetaret po ankohen?
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Sa i përket dronit ka qenë kërkesë e zyrës së kryetarit, për aktivitetet e komunës. Sa i përket numrit të popullsisë kriter numër një për ndarjen e buxhetit për nivelin lokal është 89% ndahet për numër të popullsisë dhe për vitin tjetër e kemi përfituar buxhetin, prej numrit të vjetër të vitit 2011, dhe në qarkoren buxhetore na kanë thënë nëse ka ndryshime të numrit të popullsisë, buxheti deri në shtator mundet të pësoj ndryshime, po edhe nëse pëson ndryshime unë sipas analizës që dalin, po shpresoj që grandi i përgjithshëm nuk ka me pas ndryshime, nuk ka me pas zvogëlim sepse mënyra proporcionalë prape ndahen me 89% me përjashtim të komunave që kanë rritje të popullsisë.
**Drejtori i DUMA-së, Ylber Morina**: Liridona ne e kemi kontratën për zhvillimin e projekteve që janë diku 6 fshatra në kuadër të atyre është edhe fshati Polac diku 1500 metra asfalt, , kanë me fillua pas përfundimit në Klinë. Floriana është një projekt në zhvillim të sipër në bashkëpunim me ministrin edhe komunën në bashkëfinancim, dhe e përfshin edhe atë pjesë. Në fshatin Polac është nënshkrua një kontratë dhe ka mu realizua në kuadër të ati projekti ato probleme të kanalizimit. Në fshatin Marinë dhe Mikushnic nuk ka projekt për kanalizim. Edhe për trotuar në Runik është bë një ndryshim është një problem me ministrin e kulturës dhe po duhet me bë revidimin e projektit të subqendres dhe në kuadër të saj ka me pas ndryshime ne trotuar, po janë në kuadër të subqendres. Arjeta e kemi një projekt për ndriçim veç ka filluar në qytetin e Skenderajt dhe do të filloj në ter fshatrat e komunës së Skenderajt ku ka nevojë, po besoj që edhe ajo pjesë ka me përfundua.
**Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi**: Afrim trajtimi i qeneve endacak është bë me strategjinë e fundit që e ka bë qeveria dhe në kuadër të kësaj strategjie gjitha kompetencat, ja ka kaluar komunave, për shkak së kur ka me pagua i kalon kompetencat, kur s'ka me marr i jep. Problemin me të madh e kemi me sjelljen e qenve endacak, dhe nuk po arrimë me i identifikua personat që po i sjellin në komunën tonë, dhe është e dyshimtë së ka prurje edhe prej jashtë Kosovës. Brenda mundësive tona ne i kemi trajtua në kuadër të mallrave dhe shërbimeve, e kemi një marrëveshje me një organizatë zviceranë e cila parasheh trajtimin, sterilizimin, pastrimin e qenve endacak, mirëpo për mendimin tim kjo nuk mjafton me bë uljen e qenve endacak, për shkak së me të madhe janë tu ardhur qen, dhe nuk po mundem me ditë saktë kush po i sjell.
**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi:** Arjeta, komuna e Skenderajt do të vazhdoj subvencionimin me mjete financiare për gjitha lehonat vlera do të jetë 200€, kjo do të vazhdoj edhe në vitin 2025.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Naser Bajraktari-IDEAL:** Drejtor po me vjen mirë që po doni me rregullua degëzimin e kanalizimit në BL-Klinës së Epërme, po që një vite një bager është në ara, e punët s'po kryhen, e kem dashtë me ja qitë do naftë e me hekë prej rruge.
**Sala Jashari-PDK**: Fjala përshëndetëse, për të përmësuar mjedisin shkollor dhe shëndetin e nxënësve sugjeroj që në KAB, në arsim të përfshihet investim për përmisimin e higjienës neper shkolla, konkretisht propozoj alokimin e fondeve për pajisje me material higjenik si; sapun, letra higjienikë dhe dezinfektues, kontrolle i cilësisë i higjienës, kryerja e inspektimeve të rregullta, për monitoruara cilësinë e higjienës dhe për identifikuar dhe adresuara problemet e mundshme, gjithashtu edukimi mbi higjienën, organizimi i programeve edukative për nxënës dhe rëndësia e

higjienës personalë dhe ruajtja e pastërtisë në ambiente shkollore, investimi në këto fusha do të përmisoj jo vetëm shëndetin fizik të nxënëseve po mjedisin e përgjithshëm të te mësuare duke krijuar kushte me të mira për zhvillimin e tyre edukativo dhe personale. Me qenë së drejtori i arsimit nuk qenka këtu, po e shfrytëzoj rastin të jetë një lloje propozimi për raportin e fundit.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Naser keq ish kanë mos me qenë bageri hiq, e aty nuk kemi gjete as bager, kemi gjete veç ujëra të zeza, dhe me sa e di në Klinë të epërme i kemi bë disa punë të mira, po ka ende nevojë, po problemi është të kapacitetet buxhetore. Sala të higjiena në shkolla e ke bë një sugjerim jashtëzakonisht të mirë, dhe programi higjienik në shkolla, dhe jemi tu përpjekë me i furnizua me higjienë shkollat, po pajtona nuk është gjendja e kënaqshme me higjenë.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Naser Bajraktari-IDEAL**: Kryetar që tri vite e keni marr pushtetin, tregona veç një punë qe e keni bë në Klinë të Epërme? E keni bë një Poligon Sportiv, të cilët nuk i lejohet fëmijëve me lozë në atë poligon, nëse nuk beson që ku e ke Miradijen, pyete, nipat e saj a i lejohen me hy në atë fushë? E keni bë një projekte për zgjerimin e lumit kur jeni ardhur të shpija e Enverit e keni ndërpre dhe keni dalë të rruga për Kuqicë, së nuk mundeni aty me zgjerua lumin së i keni jaranet e juve.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Në Klinë të epërm e kemi bë trajtimin e lumit prej Kuqice deri në Llaushë, kemi pas probleme pronësore dhe nuk mundemi me i zgjedhë pa shpronësim, subqendren në Klinë kemi me fillua, ndriçimin publik kemi me fillua, kanalizimin.
**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2025-2027, dhe Raporti i Kryetarit të Komunës mbi ecurinë e dëgjimeve buxhetore për KAB-in,
Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës,
-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, me Nr.02-110/01-0027864/24, i datës 14.06.2024, (Raporton);
**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi**; Fjala përshëndetëse, më kërkesë të ministrisë së shëndetësisë gjitha institutet të kujdesit parësore shëndetësor të cilët nuk e kanë të aprovuar formën unike të statutit të QKMF-së do ta aprovojnë edhe një herë sa ma shpejtë, andaj me vendim të kryetarit është formuar grupi punues, dhe në mënyrë profesionale ka punuar, e kemi mbajte diskutimin publik, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj
**Ali Lutfiu-PDK:** Fjala përshëndetëse, desha me u ndërlidh të neni 14 pika 2.1, të përzgjedhja e drejtorit ku thotë; të jetë specialist nga mjekësia familjare ose në rast mungese mjek specialist nga lemija të tjera. Kjo pikë faktikisht na kushtëzon zgjedhjen e një menaxheri të mirë duke i dhënë përparësi specialistit nga mjekësia familjare dhe qëllimi im është që të jetë menaxher i mirë, që ka mundësi me ndërhy këtu të kjo pikë?
**Hysni Mehani-LVV**: Nuk e di a jemi n 'tokë të bukës a s'jemi, po me sa e di emri i Ali Lutfiut është në komision për përpilimin e statusit të QKMF-së, d.m.th. një anëtar i komisionit që ka pas me bë draftin po tregon së nuk ka qenë pjesë e saj, po ti duhesh me qenë pjesë e kësaj, me ide me propozime, po nëse nuk janë marr parasysh këto, ish kanë dashtë me i thanë m 'falni nuk janë marr parasysh propozimet e mija për ketë draft. Drejtoresh e kam një pyetje, ne e kemi miratuar një draft të QKMF-së që i kemi rregulluar disa interesa të caktuar brenda QKMF-së atëherë, po çka rregullon tash ky draft statut i QKMF, tash, në raport me statutin e vjetër?
**Ilir Ejupi-IDEAL:** Edhe unë pak a shume e kam të njëjtën çështje qysh e pat Alija, mirëpo kërkoj saktësisht së për cilat arsye ministria e ka kthye statutin që është miratuar me herët në këtë kuvend,

dhe a e parashihni mundësin që ministria ka me ja kthye të kundërligjshëm për shkak të nenit që e parashtroj Alija nenit 14 pika 2.1, që mundet me ra në kundërshtim me UA, nr. 04/2020, dhe me statutin unik që e ka bërë ministria e shëndetësisë.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Po e shohë që ka paqartësi, nuk është ku statut që është kthye, po e kemi bë ndryshimin me statutin unik që na ka obliguar ministria e shëndetësisë me bë një statute unik për krejt komunat e Kosovës. Po edhe nëse është anëtar i komisionit nuk do me thanë, mos me bë pyetje me lyp sqarime, sepse të qenurit anëtar i komisionit nuk je organ vendimmarrës, anëtaret e përgatitin vetëm në kuptimin formal. Edhe unë jam që menaxhmenti i QKMF-së me kanë jo vetëm specialist i mjekësisë familjare po edhe i fushave tjera të mjekësisë.
**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi**; Ne masi e kemi përpiluar draftin je kemi dërguar ministrisë për konfirmim, ministria na ka dërgua se gjithçka është ne rregull, dhe ne pastaj e kemi sjell për votim në kuvend.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Ali Lutfiu-PDK:** Fatkeqësisht nuk kam pajtua dhe nuk pajtohem apët, se nuk ka rendësi së çfarë mjeku është, vetëm me kanë menaxher i mirë, në udhëheqje të QKMF-së.
**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (6) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj.
Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës,
-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në Komunën e Skenderajt, me Nr.02.110/01-0027865/24, i datës 14.06.2024, (Raporton
**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Fjala përshëndetëse, në këtë pikë kemi të bëjë me Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në Komunën e Skenderajt, me vendim të kryetarit është formua grupi punues, për hartimin e këtij plani, është mbajtur diskutimi publik me datën 20.05.2024, materialin e keni pas me kohe kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj;
**Mentor Mehmeti-PDK:** Drejtor e kemi diskutua edhe në KPF, rreth transportit publik, ku as një transport publik nuk ka qasje për personat me aftësi të kufizuar, unë e kam shikuar pak ligjin për qasje të barabartë, dhe a kishe mundur diqysh me a kushtëzua një kompanie, që të kemi një taksi për personat me aftësi të kufizuar, të përgëzoj për planin, dhe besoj që keni me pas mirëkuptim për këtë punë.
**Hysni Mehani-LVV:** Të objektivi i rritjes së sigurisë në trafik është ndërtimi i tregut të gjelbër në qytet, drejtor a po me tregon qysh e rritë sigurinë në trafik, ndërtimi i tregut të gjelbër në qytete? Të infrastruktura e transportit, transporti i njerëzve dhe i mallrave në territorin e komunës së Skenderajt bëhet përmes transportit rrugorë dhe hekurudhorë, drejtor ku i kemi këto hekurudha që i transportojmë njerëz e mallrat? Me ju pas qasë me ma seriozitet veç dy orë, seriozisht ky draft ish dal me ma mirë, përveç mos me pas gabime, së ne teren nuk ka me ndryshua asgjë.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Sa i përket çështjes tende Mentor, kemi me u ulë me bisedua dhe kemi me u mundua me zgjedh atë çështje, sa i përket transportit për persona me aftësi të kufizuar. Sa i përket gabimeve teknike, grupit punues i ka ik aj lëshim, dhe kemi me i rregullua.
**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planin Lokal për Transportin Rrugor 2024-2028, në Komunën e Skenderajt.
Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në Komunën e Skenderajt, me Nr.02.110/01-0027862/24, i datës 14.06.2024, (Raporton);
**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Fjala përshëndetëse, në këtë pikë kemi të bëjë Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në Komunën e Skenderajt, është mbajtur diskutimi publik, materialin e keni pas me kohe kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.
**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj;
**Abdulla Gashi-IDEAL:** Drejtor a e keni parapa së ku do ti parkoni ato vetura, perse nuk e keni parapa ndërtimin e parkingut në mënyrë që qytetaret të kenë ku ti parkojnë veturat, a e keni parapa fluksin e madh që behet gjatë verës nga mërgimtarët së ku do ti parkojnë veturat, dhe i vetmi parking që duhet me u krenua komuna është parkingu nga qeverisja e kaluar e Bekim Jasharit. Sa i përket gjobave për një veturë që konfiskohet nga merimanga, sa do të jetë gjoba për një veturë?
**Musa Fazliu-IDEAL:** Kompania si do ta fitoj këtë tender, dhe si do të jetë çmimi, ku do të jetë vendi, që grumbullohen këto vetura, dhe a do të jetë në pronë të komunës?
**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor, a do të jetë e zbatueshme para a pasi të vinë mërgimtarët, kjo rregullore? Edhe a kish pas mundësi me marrë në zbatim kompania Eko Natyra këtë çështje, që vetëm e kishim forcua kompaninë?
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Qyteti i Skenderajt është mjaftë mirë i organizuar sa i përket çështjes së parkingut. Kjo rregullore u bë me kërkesë të policisë së Kosovës, dhe në rregullore janë kushtet e ushtrimi të veprimtarisë për zhvendosjen e automjeteve në nenin 4, dhe në formë ankandi ka me shkua procedura e përzgjedhjes së kompanisë. Kjo rregullore hyn në fuqi pas sezonit të diasporës, e arsyeshme dhe me venë me ja ofrua këtë shërbim kompanisë Eko Natyra po duhet me shikua e me bisedua për ketë çështje.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Hysni Mehani-LVV:** Drejtor unë e kam lexuar rregulloren dhe besoj që është e aplikueshme, ti po thua hynë në fuqi pasi të shkon diaspora, po neni 23 thotë; kjo rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi komunal, ose ndryshone ketë, ose sipas saj rregullorja sot hynë në fuqi, si të miratohet, dhe ju lutem mos bëni kësi gabime, së nuk po mundem pa reagua.
**Kryesuesja**: Fjalën ja kaloj:
**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** E vërtetë që hynë në fuqi pas miratimit në kuvend ne fillojmë me zbatua, po afati për procedurat në prokurim nuk e di sa na marrin kohe, dhe rregullorja ka me shkua edhe në ministri deri të kthehet ligjshmëria.
**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Draft-Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrat e Bllokimit dhe Zhvendosjes së Automjeteve me Automerimangë në Komunën e Skenderajt.
Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës;
-Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027, në Komunën e Skenderajt, me Nr. 02-110/01-0027863/24, i datës 14.06.2024, (Raporton);
**Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Planit të veprimit për punësimin e peronave me aftësi të kufizuar në komunën e Skenderajt 2024-2027, ky planë është punuar nga Handikos dhe u mbështet nga disa drejtori komunale dhe një numër të organizatave të shoqërisë civile, është financuar nga UNDP, dhe komuna e Skenderajt, materialin e keni pas me kohe, jam këtu për çdo përgjigje.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj
**Afrim Kabashi-NSD:** E kam një propozim që ky plan me u zbatua, mos me mbet vetëm një dokument i miratuar, po me i përkrah këta persona.
**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, fjalën ja kaloj:
**Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi;** Bazuar në një plan që tash i ka skaduar afati, në vitin e parë që e kemi marr mandatin i kemi mbështet me grande 7 persona me aftësi të kufizuar të cilët edhe kanë hapur biznese të tyre, si dhe 3 janë punësuar në kompani të ndryshme.
**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (7) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit të Veprimit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar 2024-2027, në Komunën e Skenderajt.
Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës
-Raport i Ndërmarrjes Komunale NPL, "Eko Natyra" SH.A. Skenderaj, për vitin 2023, me Nr.001-023/24-007, dt. 27.02.2024, (Raporton);
**Aksionari i Ndërmarrjes Behxhet Maliqi**; Fjala përshëndetëse, unë dua ti falënderoj punëtorët e Eko natyrës për një punë të jashtëzakonshme që janë tu e bë, gjithashtu e falënderoj edhe bordin e drejtorëve për përkushtimin në zbatimin e planit të biznesit, po edhe menaxhmentin. Kompania Eko natyra fokusohet në pastrimin e objekteve brenda dhe mirëmbajtjen e ambientit publik jashtë, si sheshin Adem Jashari, oborrin e kulturës, oborrin e QKMF-së, oborrin e komunës, parqet dhe hapësirat tjera publike, materialin e keni pas me kohe para veti, kush ka pyetje jam këtu.
**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:
**Naser Bajraktari-IDEAL:** Aksionari i Eko-Natyrës apët ka fillua mire pas tri vite, po është dashur me i sjellë edhe dy raporte tjera tash me ardhur raporti i tret, po si do qoftë ma mirë vonë së kurrë. Drejtor unë kam dëshmi që ende qëndrojnë anëtaret e bordit që nuk i keni ndërrua nga ARBK-ja, ju në vitin 2023 i keni pas anëtaret e bordit jashtëligjshëm që nuk kanë pas të drejtë, dhe në vitin 2023 ti i ke ndërrua emrat e anëtarëve të bordit të cilët nuk kanë qenë në vitin 2023, po janë në vitin 2024, që ju keni shpallë konkurse me datë 14.11.2023 dhe punën e kanë filluar në janar, dhe këta dy anëtar nuk kanë qenë në vitin 2023 në bord. Ti e ke sjell një raport shume të shkurtë, për gjithë ata punëtorë që punojnë, po menaxhimin e kanë të dobët. -Përse nuk e keni bërë plotësim ndryshimin e statutit të ndërmarrjes dhe në sistemin ARBK- që tri vite? -Cilat janë vendimet e marra për këto tri vite nga ju si aksionar? -A keni bërë auditim të ndërmarrjes për çdo vite, dhe cili është vlerësimi i auditorit, nëse keni bë, se ju e kishit vlerësua shumë mirë me 95% të punëve të kryera? -Cilat janë kontratat me komunën dhe cila drejtori i paguan shërbimet? –Sa janë të hyrat mujore nga kontratat dhe të hyrat nga parkingu publik? -Cilat janë pagesat e bordit të shefit dhe të gjithë punëtoreve, përse nuk e keni sjell një listë për këto pagesa? Dhe kërkoj nga ky kuvend një auditim të kësaj ndërmarrje për tri vite, të shohim së ku është e ku gjendet kjo ndërmarrje për tri vite. Edhe unë në disa seanca kam thënë së ma mirë është me u nda prej Uniteti, dhe kurrë nuk kishim than perse jemi nda, sepse Vushtrria kompaninë e vet e ka formua ne atë vite kur e kemi formua ne edhe është nda dhe shumë mirë po i shkojnë punët. Dhe nuk po e shohë që e ke punua një raporte të sinqertë dhe kretibil që duhet të dokumentohet.
**Hysni Mehani-LVV:** Përveç atyre që i tha Naseri që kanë të bëjë me mangësitë në raportim, po me bënë përshtypje ky që koka kryeshef thotë që i referohet punës tina ai plan i biznesit për vitin 2023, besoj që plani i biznesit edhe kompania çfarë është kjo dallojnë, sepse plani i biznesit është një raport fitimi, kompania Eko-natyra është kompani që ofron shërbime e nuk e ka në thelb fitimin. Po ne e kemi një kryeshef që i ka bë njo tri paragrafë-fjali që nuk e dinë çka donë e çka thotë, po përtej raportit ajo çka është shqetësuese e që ne si këshilltar komunal ish kanë dashtë me ngritë është kjo çka po e citoj; Kemi punuar në kushte minimale të punës, pa kushte teknike të

sigurisë dhe ndriçimit si dhe pa ngrohje në sezonin e dimrit. Kjo do duhej me qenë aj alarmi për ne si këshilltar komunal, sepse këtu kemi të bëjë me shkeljen e të drejtat e njeriut së krijimi i kushteve të punës është obligim ligjor dhe ne jemi institucion që e kemi votua Eko-natyrën në këtë kuvend, kjo do duhej me qenë çështja kryesore përtej atyre raportimeve.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Aksionari i Ndërmarrjes Behxhet Maliqi**; Mos ndërrimi i anëtarëve të bordit ka ndodh për shkak të disa natyrave të aspektit burokratikë nuk ka ndodhur deri me sot, dhe ndërmarrja është tu u përball në aspektin ligjor me agjensioni e regjistrimin e bizneseve për mos këtë ndërrim, dhe besoj që është në të drejtën e ndërmarrjes vendimi, dhe u mbete në kompetencën e tyre me bë këtë ndryshim, sepse ne i kemi bë ndryshimet. Plotësim ndryshimi i statusit të ndërmarrjes nuk mendoj që është e nevojshme me ndryshua në bazë të ligjit. Kontratat janë të lidhura me komunën, kryesisht me DSHP, po edhe me drejtorit tjera, po DSHP, i mbulon të gjitha çështjet. Raporti vjetor është një përmbledhje e përgjithshme e punëve të kompanisë. Mbetet në kompetencë të bordit të drejtorëve që ti auditoj pasqyrat financiare për vitin 2024 dhe ka qenë kërkesë e vazhdueshme e aksionarëve dhe i rekomandoj që ti auditoj pasqyrat financiare. Sa i përket çështjeve tjera biznes plani është një dokument strategjik i cili parashihet në ligjin për ndërmarrje publike i cili duhet të hartohet dhe kompania publike janë të obliguar të veprojnë në zbatim të këtij plani të biznesit. Sa i përket kushteve minimale për punë, është e vërtetë që ndërmarrja gjatë vitit 2021-2022 ka qenë në fillim të themelimit dhe ka pas probleme, sot ndërmarrja e ka objektin dhe kushtet e punës për gjithë punëtoret, janë jashtëzakonisht të rregulluara. Një falënderim të veçantë dua me bë për anëtaret e bordit që i ka kaluar mandati këto ditë, dhe dua të shprehi respektin me të madh për një punë profesionale që e kanë bë gjatë këtyre tri viteve.

**Kryesuesja**: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (0) abstenim përkrahet Raport i Ndërmarrjes Komunale NPL, "Eko Natyra" SH.A. Skenderaj, për vitin 2023.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës

-Propozimi-vendimi, Për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares, Nr.02-170/02-0029548/24, të datës 27.06.2024, (Raporton);

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura;** Propozimi-vendimi për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares. Titulli "Qytetar Nderi" për z. Benito Mares, jepet në shenjë respekti dhe mirënjohje për meritat në ideimin dhe financimin e ndërtimit të Kompleksit të Dëshmorëve të UÇK-së në Marinë të Skenderajt, mbështetjen e vazhdueshme për Komunën e Skenderajt si dhe meritat në promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së. Titulli "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares, do ti ndahet në seancën solemne, që do të mbahet në seancën e radhës të Kuvendit.

**Kryesuesja;** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (25) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozimi-vendimi, Për shpalljen "Qytetar Nderi" të Komunës së Skenderajt z. Benito Mares.

Vazhdojmë me piken 10 të rendit të ditës

-Propozim-vendimi për rishpalljen e pronës, Pronë me Interes Publik, me Nr.02-463/01-0029523/24, te dt.27.06.2024, (Raporton);

**Drejtoresha e DGJKP-ës, Blerta Dobra-Geci;** Fjala përshëndetëse, propozim-vendimi, për rishpalljen e pronës, Pronë me Interes Publik. Sipas këtij propozim vendimi, rishpalljen e pronës, Pronë me Interes Publik, si në vijim; Prona e paluajtshme që udhëhiqet në emër të "OPB Produkt" ngastra Nr.219-1, me sipërfaqe të përgjithshëm prej 00.88.48 ha, tokë ndërtimore vend i quajtur BUCINA-KOD SHKOLE, Zona Kadastrale Çirez, Komuna e Skenderaj, e evidentuar me certifikatën e pronësisë. Rishpallja e pronës, Pronë me Interes Publik, bëhet për arritjen e qëllimit

të ligjshëm Publik realizimin e projektit me interes të përgjithshëm publik "Ndërtimi i subqendres në Çirez" në fshatin Çirez komuna e Skenderajt. Rishpallja bëhet për shkak të gabimeve teknike në numër të parcelave në vendimin e kuvendit Nr. 01-463/01-0042564/20. Kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja;** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (3) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendimi për rishpalljen e pronës. Pronë me Interes Publik.

Vazhdojmë me piken 12 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, Abdulla Gashi, i ka marr përgjigjet përmes emali nga drejtori i arsimit, ndërsa Liridona Koci i ka marr përgjigjet gjatë mbledhjes së seancës, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE SKENDERAJ
Nr.
No. 04-052/01-0032374/24
Data.
Data. 10.07.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

# RAPORTI FINANCIAR

# GJASHTËMUJOR

# Janar – Qershor 2024

Korrik 2024

# Permbajtja:

Raporti Financiar Gjashtëmujor Janar-Qershor 2024 ........ 3
1. Kërkesat për raportim ........ 3
2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE ........ 3
3. Raporti i Ekzekutimit te Buxhetit 2024 TABELA Nr. 1 ........ 4
4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-QERSHOR 2024 ........ 5
5. SHPENZIMET BUXHETORE ........ 7
Tabela nr. 4 Projektet kapitale të realizuara Janar-qershor 2024 ........ 9

## Raporti Financiar Gjashtëmujor Janar-Qershor 2024

### 1. Kërkesat për raportim

Raporti Financiar gjashtëmujor Komunal për periudhën Janar – Qershor 2024, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 45.4 dhe 46.2 të Ligjit Nr.03/L-048"Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë" dhe statutit Komunal.
Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Periudha e raportimit karakterizohet me faktin se:

- Është përfunduar dhe aprovuar Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 dhe e kemi dorëzuar në afatin ligjor në Ministrin e Financave, Punës dhe Transferove,
- Janë mbajte 4 dëgjime buxhetore me te gjitha shtresat shoqërore në lidhje me prioritetet e Qeverisë Lokale për periudhën 2025-2027 dhe
- Është finalizuar bartja e një pjese te THV-ve komunale të pashpenzuara nga viti 2023 për shpenzim në fitin aktual 2024 por kësaj here nuk janë përfshi edhe te hyrat tjera te realizuara por të paplanifikuara (me një vendim tjetër ne te ardhmen).

### 2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme".

Buxheti i aprovuar për vitin 2024 është **18,582,310.00 €** plus te hyrat e bartura pjesërisht ne shumë prej **179,566.17 €** shpërndarë ne pesë kategori ekonomike :

| | |
|---|---|
| Pagat dhe Mëditjet | 10,529,849.00 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,388,253.96 |
| Shërbimet Komunale | 309,126.71 |
| Subvencionet | 1,026,952.97 |
| Investimet Kapitale | 4,507,693.53 |
| **Gjithsej** | **18,761,876.17** |

TABELA NR 1 RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : JANAR- QERSHOR 2024

| FONDET BURIMORE | Buxheti fillestar | Buxheti Aktual | Shpenzimet (pagesat) 2024 | Shpenzimet (pagesat) 2023 | % e realizimit 3/2 |
|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| **GRANTI I PERGJITHSHËM** | **17,283,039.00** | **17,283,039.00** | **10,231,433.05** | **7,339,453.97** | **59.20** |
| Pagat dhe Shtesat | 10,529,849.00 | 10,529,849.00 | 6,608,795.74 | 4,773,870.99 | 62.76 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,329,428.18 | 2,329,428.18 | 1,273,134.36 | 1,097,440.48 | 54.65 |
| Shërbimet Komunale | 289,322.82 | 289,322.82 | 147,578.44 | 146,652.88 | 51.01 |
| Subvencionet | 932,000.00 | 932,000.00 | 556,140.60 | 479,257.60 | 59.67 |
| Investimet Kapitale | 3,202,439.00 | 3,202,439.00 | 1,645,783.91 | 842,232.02 | 51.39 |
| Rezerva | | | | | |
| **TË HYRAT VETANAKE Aktuale** | **1,299,271.00** | **1,299,271.00** | **441,388.74** | **302,324.02** | **33.97** |
| Pagat dhe Shtesat | | | | | |
| Mallrat dhe Shërbimet | 57,000.00 | 57,000.00 | 18,549.14 | 3,148.07 | 32.54 |
| Shërbimet Komunale | | | | | - |
| Subvencionet | 70,000.00 | 70,000.00 | 60,700.00 | 14,682.00 | - |
| Investimet Kapitale | 1,172,271.00 | 1,172,271.00 | 362,139.60 | 284,493.95 | 30.89 |
| Rezerva | | | | | - |
| **TË HYRAT E BARTURA** | - | **179,566.17** | **142,775.64** | **211,967.61** | - |
| Pagat dhe Shtesat | | | | | - |
| Mallrat dhe Shërbimet | | 1,825.78 | | | - |
| Shërbimet Komunale | | 19,803.89 | | 16,295.06 | - |
| Subvencionet | | 24,952.97 | 15,780.00 | | - |
| Investimet Kapitale | | 132,983.53 | 126,995.64 | 195,672.55 | - |
| **DONACIONET** | - | - | - | **408,015.92** | |
| Pagat dhe Shtesat | | | | - | - |
| Mallrat dhe Shërbimet | | | - | - | - |
| Shërbimet Komunale | | | | - | - |
| Subvencionet | | | | 408,015.92 | |
| Investimet Kapitale | | | | | |
| **HUAMARRJA E JASHTME** | - | - | - | - | |
| Pagat dhe Mëditjet | | | | | |
| Mallrat dhe Shërbimet | | | | | |
| Shërbimet Komunale | | | | | |
| Subvencionet | | | | | |
| Investimet Kapitale | | | | | |
| **GJITHSEJ K.EKONOMIKE** | **18,582,310.00** | **18,761,876.17** | **10,815,597.43** | **8,261,761.52** | **57.65** |
| Pagat dhe Shtesat | 10,529,849.00 | 10,529,849.00 | 6,608,795.74 | 4,773,870.99 | 62.76 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,386,428.18 | 2,388,253.96 | 1,291,683.50 | 1,100,588.55 | 54.08 |
| Shërbimet Komunale | 289,322.82 | 309,126.71 | 147,578.44 | 162,947.94 | 47.74 |
| Subvencionet | 1,002,000.00 | 1,026,952.97 | 632,620.60 | 901,955.52 | 61.60 |
| Investimet Kapitale | 4,374,710.00 | 4,507,693.53 | 2,134,919.15 | 1,322,398.52 | 47.36 |

- **Përqindja e kategorive ekonomike në pjesëmarrjen e buxhetit aktual Komunal :**

Nga të dhënat e buxhetit aktual të planifikuar del se kategoria Paga dhe shtesa merr pjesë me 56.12 % të buxhetit te përgjithshëm , mallrat dhe shërbimet 12.73 %, komunalit 1.65 %, subvencionet 5.47 % dhe kategoria e projekteve kapitale merr pjesë me 24.03 % .

Sipas tabelës mund te shihet se shpenzimet e përgjithshme për periudhën Janar-Qershor 2024 janë 10,815,597.43 ose 57.65 % të buxhetit aktual.

Grafikisht:




**Përqindja e fondeve burimore në pjesëmarrjen e buxhetit Komunal te aprovuar:**

- Grandi qeveritarë në vlerë 17,283,039.00 € merr pjesë me 92.12 % të Buxhetit Komunal,
- Të hyrat vetanake Komunale dhe te bartura në vlerë 1,478,837.17 € marrin pjesë me 7.88 %,

## 4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-QERSHOR 2024

Përveç Grandeve të pranuara nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka arkëtuar edhe të hyra vetanake si pjesë financuese e buxhetit Komunal. Ekzistojnë disa lloje kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimin në pronë, gjobat e trafikut, taksa administrative për leje ndërtimi, shërbimet e kadastrave, taksa për regjistrimin e automjeteve etj. te cilat përbejnë një përqindje me te madhe për buxhetin e përgjithshëm komunal ne krahasim me taksat tjera e qe arkëtohen ne pajtim me rregulloret komunale.

Të hyrat Janar-Qershor 2024 të arkëtuara kanë arritur në shumen prej 684,642.93 € që përbejnë 52.69 % të planifikimit vjetor, kurse ne krahasim me periudhën e njëjte të vitit 2023 janë me te ulëta për 45.56.% , edhe pse për ketë periudhë ende nuk i kemi pranuar të hyrat indirekte ( gjobat për tm2) nga MFP dhe Transferove.

Ne detaje tabela vijim:

TABELA NR. 2

| Nr. | Përshkrimi | Kodi | Planifikimi | Realizimi | | % e planit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2024 | 2024 | 2023 | 5/4 |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| I | Administrata dhe personeli | 16323 | 56,550.00 | 23,464.04 | 27,707.85 | 41.49 |
| 1 | Çërtifikatë lindjeje | 50013 | 2,700.00 | 1,494.92 | 1,632.00 | 55.37 |
| 2 | Çërtifikatë kurorëzimi | 50014 | 7,600.00 | 1,852.00 | 1,663.00 | 24.37 |
| 3 | Çërtifikatë vdekjeje | 50015 | 2,800.00 | 678.00 | 1,183.00 | 24.21 |
| 4 | Çërtifiaktë – vërtetime të tjera ofiqarike | 50016 | 40,450.00 | 18,493.00 | 21,553.00 | 45.72 |
| 5 | Taksa administrative | 50019 | 3,000.00 | 380.00 | 422.30 | 12.67 |
| 6 | Sigurimi i automjeteve | 50109 | | 48.60 | 1,254.55 | |
| 7 | Shitja e pasurisë kumunale | 50413 | | 517.52 | - | |
| II | Inspektimi | 16645 | 5,800.00 | 6,505.00 | 4,120.00 | 112.16 |
| 1 | Gjobat nga inspektorët komunal | 50104 | 3,000.00 | 5,975.00 | 3,500.00 | 199.17 |
| 2 | Gjobat mandatore - hudhja e | 50114 | 800.00 | - | - | - |
| 3 | Taksa për pranim teknik të lokaleve | 50205 | 2,000.00 | 530.00 | 620.00 | 26.50 |
| III | *Buxhet e Financë* | *17523* | 466,945.00 | 151,407.91 | 267,841.53 | 32.43 |
| 1 | *Tatimi në pronë* | *40110* | 377,870.00 | 101,759.91 | 223,931.66 | 26.93 |
| 2 | *Taksa për regjistrimin e automjeteve* | *50001* | 87,500.00 | 47,916.00 | 41,915.00 | 54.76 |
| 3 | *Taksa për regjistrimin e trashigimisë* | *50019* | 30.00 | - | - | - |
| 4 | *Taksat për vërtetime dhe çërtifikata* | *50011* | 1,545.00 | 931.00 | 1,098.00 | 60.26 |
| 5 | *Taks Administrative* | *50019* | | 801.00 | 896.87 | |
| IV | Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi | 48023 | 28,000.00 | 7,275.00 | 11,550.00 | 25.98 |
| 5 | Taksa komunale në biznes | 50201 | 28,000.00 | 7,275.00 | 11,550.00 | 25.98 |
| 2 | Gjobat e biznesëve nga inspektorët | 50104 | | - | - | |
| IV | *Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile* | *18023* | - | 2,970.00 | 285.00 | |
| 1 | Taksa per leje parkingu | 50008 | | 2,670.00 | 285.00 | |
| 5 | Shfrytezim I prones pblike | 50405 | - | 300.00 | - | |
| V | *Bujqësi dhe zhvillim rural* | *47023* | 32,380.00 | 9,173.05 | 6,438.38 | 28.33 |
| 1 | Nderrimi i destinimit te tokes | 50012 | 180.00 | - | - | |
| 2 | Taksa tjera administrative per bujqesi | 50016 | 1,200.00 | 173.00 | 244.00 | 14.42 |
| 4 | Participimet në bujqësi | 50409 | 31,000.00 | 9,000.05 | 6,194.38 | 29.03 |
| VII | *Gjeodezia, Kadastri dhe Prona* | *65315* | 111,500.00 | 96,516.83 | 144,927.59 | 86.56 |
| 1 | Trashigimia – bartja, regjistrimi i pronës | 50011 | 45,000.00 | 18,161.00 | 34,314.00 | 40.36 |
| 3 | Taksë për fletë-poseduese dhe kopje | 50032 | 12,000.00 | 7,111.00 | 6,017.00 | 59.26 |
| 4 | Taksa administrative | 50019 | | 2,455.00 | 2,321.00 | |
| 5 | Renta - shfrytezimi i prones publike | 50405 | 12,500.00 | 8,686.40 | 8,830.85 | 69.49 |
| 6 | Qiraja nga objektet publike | 50408 | 20,000.00 | 9,739.60 | 9,871.41 | 48.70 |
| 7 | Aktivitetet në terren për matje | 50504 | 22,000.00 | 18,158.00 | 12,455.00 | 82.54 |
| 8 | Tax.ndrrim destinimit tokes | 50012 | | 32,205.83 | 71,118.33 | |
| VIII | *Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit* | *66620* | 364,868.00 | 287,421.10 | 415,480.38 | 78.77 |
| 1 | Lejet ndërtimore | 50009 | 203,868.00 | 193,025.38 | 277,833.97 | 94.68 |
| 2 | Taksat administrative | 50019 | | 1,120.00 | 1,230.00 | |
| 3 | Të hyrat nga koncesioni | 50417 | 121,000.00 | 52,891.60 | 118,884.60 | 43.71 |
| 4 | Takse komunale per leje mjedisi | 50045 | 20,000.00 | 29,147.96 | 17,303.04 | 145.74 |
| 0 | Legalizimi i Objekteve Ndertimore | 50026 | 20,000.00 | 11,236.16 | 228.77 | 56.18 |
| IX | *Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale* | *73032* | 16,000.00 | 9,019.00 | 7,942.00 | 56.37 |
| 1 | Taksa administrative DSHMS | 50019 | 16,000.00 | 9,019.00 | 7,942.00 | 56.37 |
| 3 | Pagesa e qeras | 50408 | | - | - | |
| a | *Shtëpia e shëndetit OKMF* | *74400* | 22,400.00 | 15,134.00 | 13,981.50 | 80.50 |
| 1 | Participimi - arka | 50409 | 15,300.00 | 13,139.00 | 11,596.50 | 85.88 |
| 2 | Çërtifikatë mjeku | 50024 | 3,500.00 | 1,995.00 | 2,385.00 | 57.00 |
| XI | *Kultura, Rinia e Sporti* | *85023* | 2,680.00 | - | 40.00 | - |
| 1 | *Qiraja nga objektet publike* | *50408* | 1,450.00 | - | - | - |
| 2 | *Participimi nga KRS (biblioteka)* | *50409* | 1,230.00 | - | 40.00 | - |
| XII | *Arsimi – qerdhja e fëmijëve* | *92650* | 57,000.00 | 28,552.00 | 28,400.00 | 50.09 |
| 3 | *Participimi për kujdesin e fëmijëve* | *50409* | 55,000.00 | 28,552.00 | 28,400.00 | 51.91 |
| 4 | Participimi për kujdesin e fëmijëve-Bajë | 50409 | 2,000.00 | - | - | - |
| | GJITHSEJ TE HYRAT | | 1,164,123.00 | 637,437.93 | 928,714.23 | 54.76 |
| | *Te Hyrat tjera - Gjobat nga Trafiku, Gjykata, e tjera* | | 135,148.00 | 47,205.00 | 67,836.00 | 34.93 |
| 1 | Të hyrar nga gjobat në trafik | 50101 | 110,000.00 | 35,815.00 | 56,441.00 | 32.56 |
| 2 | Të hyrar nga gjobat e gjykatave | 50102 | 25,000.00 | 11,390.00 | 11,350.00 | 45.56 |
| 3 | Të hyrat nga Agjensioni pyjor e tjera | 50107 | 148.00 | - | 45.00 | - |
| | ***GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE*** | | **1,299,271.00** | **684,642.93** | **996,550.23** | **52.69** |

*PASQYRA e të hyrave vetanake sipas drejtorive, planifikuar dhe realizuar në periudhën: Janar - Qershor 2024* (table title)

# 5. SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet e komunës janë realizuar përmes pesë kategorive ekonomike të parapara me Ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2024 dhe atë për :

a. Paga dhe mëditje
b. Mallra dhe shërbime
c. Komunali
d. Subvencione dhe
e. Kapitale

Në tabelën vijuese kemi paraqitur te dhënat për lëvizjen e të gjitha këtyre kategorive të shpenzimeve për periudhën raportuese Janar-Qershor 2024 duke krahasuar shpenzimet e kësaj periudhe me shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit 2022 dhe vitin 2023.

Sipas tabelës mund te shihet se:

- Masa e përgjithshëm e paguar për paga ka shënuar rritje ne krahasim me periudhën e kaluar kohore te vitit dmth janë shpenzuar 62.76 % e fondit aktual. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimet e përgjithshëm komunale për periudhën Janar-Qershor 2024 është 61.10 %. Ne shpenzimin e me tepërt te kësaj kategorie kanë ndikuar vendimet gjygjësore te mësimdhënësve qe kane rrjedh nga kontrata kolektive.
- Mallrat dhe shërbimet kanë pasur shpenzim prej 54.08 % e fondit aktual kurse pjesëmarrja e tyre ne shpenzimet e përgjithshme është 11.94 %
- Shërbimet Komunale pasur shpenzim prej 47.74 %, kurse ne shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 1.36 %
- Subvencionet kanë pasur shpenzim prej 61.60 % e fondit aktual, janë subvencionuar kryesisht programet për bujqësi, pagesa të këtij viti për Bashkësinë Islame, pagesa për fëmijët e porsalindur, në shpenzimet e përgjithshme subvencionet marrin pjesë me 5.85 %
- Kapitalet kanë pasur shpenzim prej 47.36 % e fondit aktual , ndërsa ne shpenzimet e përgjithshme komunale marrin pjesë më 19.74 %

Ne përgjithësi shpenzimet e gjithmbarshme komunale janar-qershor 2024 janë për 30.91 % ma te mëdha së ato ne vitin 2023.

Në shpenzimin e buxhetit për periudhën raportuese ka përfitua edhe gjinia femërorë nëpër te gjitha kategoritë. Për më tepër të dhënat në tabelën nr.3:

**Tabela nr. 3 Analitikë e shpenzimit te buxhetit**

TABELA NR. 3 Llojet e shpenzimeve sipas kategorive dhe nenkodeve

| Nr. R | LLOJI I SHPENZIMEVE | Kodi ekonomik | Shpenzimi sipas viteve : 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga Neto | 11111 | 3,383,477.09 | 4,039,307.42 | 4,032,135.74 |
| 2 | Antaresimi-Oda e Infermierve të Kosovës | 11125 | 3,677.85 | 3,718.83 | 4,895.04 |
| 3 | Kontributi pensional nga punëtori | 11131 | 188,418.33 | 226,691.00 | 245,000.77 |
| 4 | Pagesa per sindikatë | 11151 | 16,391.11 | 8,915.24 | 9,681.44 |
| 5 | Përvoja e punës | 11211 | | | 199,611.29 |
| 6 | Kontributi pensional nga punëdhënsi | 11311 | 188,418.33 | 226,691.00 | 245,000.77 |
| 7 | Shtesat e veqanta për të zgjedhurit | 11411 | | | 17,777.17 |
| 8 | Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës | 11431 | | | 100,786.59 |
| 9 | Tatimi në paga | 11500 | 196,047.94 | 257,416.44 | 291,366.52 |
| 10 | Shtesat tranzitore | 11611 | | | 6,920.58 |
| 11 | Pagesa për vendime Gjygjësore - të formës se prerë | 11900 | 79,934.08 | 11,218.66 | 1,455,619.83 |
| | **GJITHSEJ PAGAT** | | **4,056,364.73** | **4,773,958.59** | **6,608,795.74** |
| 1 | Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendi | 13140 | | 6,653.00 | 855.00 |
| 2 | Para xhepi /Meditje për udhëtim jashtë vendit | 13141 | | 564.80 | 182.00 |
| 3 | Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendi | 13142 | | 2,308.90 | 2,333.32 |
| 4 | Shpenzimet tjera për udhtimët zyrtare jashtë vendi | 13143 | | 313.00 | 3,888.90 |
| 5 | Shpenzimet të internetit | 13310 | 1,410.91 | 3,749.14 | 4,440.00 |
| 6 | Telefonia mobile | 13320 | 8,431.87 | 9,480.67 | 9,865.44 |
| 7 | Shpenzime postare | 13330 | 7,508.15 | 239.70 | 4,815.31 |
| 8 | Shërbimet e arsimit/trajnimit | 13410 | | | 8,500.00 |
| 9 | Sherbime të ndryshme intelektuale dhe keshilldhense | 13440 | 2,383.75 | 2,750.00 | 10,862.09 |
| 10 | Shërbimet e veqanta -Konsulentë dhe Kontraktorë individual | 13445 | | | 3,929.46 |
| 11 | Sherbimet shtypjes /Printim | 13450 | 6,429.15 | 30,687.74 | 25,866.75 |
| 12 | Sherbime kontraktuese tjera | 13460 | 238,471.65 | 398,326.98 | 215,826.10 |
| 13 | Sherbime teknike | 13470 | 5,035.08 | 18,337.95 | 5,965.06 |
| 14 | Softuerët- Licencat dhe mirëmbajtja e tyre | 13471 | | | 4,800.00 |
| 15 | Sigurimi fizik I objekteve publike | 13475 | | | 64,850.24 |
| 16 | Shpenzimet për anëtarsim | 13480 | 7,000.00 | | 10,528.70 |
| 17 | Mobilje më pak se 1000 euro | 13501 | 352.50 | 3,738.36 | 20,523.38 |
| 18 | Kompjutera me pak se 1000 | 13503 | 14,698.15 | 73,673.80 | 990.00 |
| 19 | Hardwer për teknologji informative <1000 | 13504 | | 957.20 | |
| 20 | Makinat fotokopiuese -multifunksionale | 13505 | | | 980.00 |
| 21 | Paisje tjera | 13509 | | 2,134.56 | 4,326.10 |
| 22 | Furnizime per zyre | 13610 | 19,016.90 | 35,957.58 | 21,366.10 |
| 23 | Dokumenta Blanko | 13611 | | 12,640.00 | 3,042.40 |
| 24 | Furnizim me ushqim dhe pije ( jo dreka zyrtare) | 13620 | 20,074.02 | 17,986.18 | 51,489.31 |
| 25 | Furnizime mjekësore | 13630 | 17,722.01 | 41,554.56 | 9,640.43 |
| 26 | Furnizim pastrimi | 13640 | 23,461.14 | 14,931.95 | 16,167.57 |
| 27 | Vajëra | 13710 | | 5,067.00 | |
| 28 | Naft per ngrohje qendrore | 13720 | 24,650.49 | 21,570.92 | 25,348.64 |
| 29 | Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje | 13760 | 60,035.00 | 77,478.00 | 126,630.00 |
| 30 | Derivate per xhenerator | 13770 | 777.80 | 1,677.18 | |
| 31 | Derivate per automjete, Gjeneratorë dhe makineri | 13780 | 40,423.08 | 46,261.80 | 41,338.59 |
| 32 | Rexhistrimi i automjeteve | 13950 | 2,875.00 | 2,929.00 | 2,402.00 |
| 33 | Sigurim i automjeteve | 13951 | 6,022.81 | 5,776.49 | 5,406.61 |
| 34 | Kontrollim teknik i automjeteve | 13954 | | | 350.00 |
| 35 | Mirmbajtja dhe riparim i automjeteve | 14010 | 8,836.90 | 22,117.22 | 16,625.20 |
| 36 | Mirmbajtja dhe riparim i ndërtesave | 14020 | 794.99 | | |
| 37 | Mirmbajtja e ndertesave administrative afariste | 14022 | 1,421.42 | 3,457.40 | 43,490.76 |
| 38 | Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore | 14023 | 28,605.83 | 13,163.84 | 187,932.97 |
| 39 | Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore | 14024 | 387.31 | 385.60 | 37,172.03 |
| 40 | Mirëmbajtja e rrugëve lokale | 14032 | 195,166.13 | 179,184.26 | 138,351.57 |
| 41 | Mirëmbajtja e teknologjisë informative | 14040 | 524.00 | 305.00 | |
| 42 | Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve | 14050 | 18,696.30 | 23,200.60 | 67,137.00 |
| 43 | Mirëmbajtja rutinore | 14060 | | | 61,695.25 |
| 44 | Qiraja për makineri | 14140 | | 1,237.50 | |
| 45 | Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit | 14310 | 16,268.90 | 18,910.37 | 19,150.00 |
| 46 | Vendimet gjyqësore | 14410 | | 880.30 | 12,619.22 |
| | MALLËRA & SHËRBIME | | 777,481.24 | 1,100,588.55 | 1,291,683.50 |

Vazhdim i tabelës nr. 3

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Energjija elektrike | 13210 | 77,145.92 | 117,295.86 | 99,658.09 |
| 2 | Shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit | 13220 | 23,769.22 | 26,098.56 | 19,229.16 |
| 3 | Mbeturinat | 13230 | 12,764.64 | 18,173.90 | 27,889.50 |
| 4 | Telefonia fikse | 13250 | 1,098.89 | 1,379.62 | 801.69 |
| | SHPENZIME TE KOMUNALIVE | | 114,778.67 | 162,947.94 | 147,578.44 |
| 1 | Subvencione për Entitete Jo Publike | 21200 | 140,743.46 | 130,900.00 | 273,386.60 |
| 2 | Transferet për përfitues individual tjerë | 22202 | 216,521.00 | 771,055.52 | 311,064.00 |
| 3 | Pagesa për sherbimet e varrimit | 22298 | | | 43,410.00 |
| 4 | Qiraja për raste sociale | 22299 | | | 4,760.00 |
| | SUBVENCIONE | | 357,264.46 | 901,955.52 | 632,620.60 |

## Tabela nr. 4 Projektet kapitale të realizuara Janar-qershor 2024

| | 643 SKENDERAJ | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 10. BUXHETI NGA GRANTET QEVERITARE | BUXHETI I PLANIFIKUAR | BUXHETI I SHPENZUAR | DIFERENCA | % E REALIZ. |
| Kodi buxhetor | Emertimi i projekteve | | | | |
| 54307 | Ndriçimi publik ne fshatra Abria e Poshme, Aqareva, Baja, Baksi, Buroja, Çirezi, Çitaku, Çubreli, Dasheci, Izbica, Klina e Epërme,Klina e Mesme, Klina e Poshtme, Klladërnica, Kopiliq | 131,925.55 | - | 131,925.55 | |
| 52568 | Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 -Prekaz | 35,000.00 | **35,000.00** | - | **100.00** |
| 51596 | Asfaltimi i rrugës Rakinicë-Qubrel | 36,354.00 | **36,350.36** | 3.64 | **99.99** |
| 54315 | Asfaltimi i rrugës Runik te Kisha | 11,215.00 | - | 11,215.00 | - |
| 54316 | Asfaltimi i rrugës Skenderaj-Vushtrri | 14,500.00 | - | 14,500.00 | - |
| 51209 | Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i lumenjve në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiqevc, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë. | 173,000.00 | **117,423.05** | 55,576.95 | |
| 54329 | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Izbicë-faza 2 | 47,074.45 | **47,074.00** | 0.45 | **100.00** |
| 54281 | Asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Kuqicë,Qubrel,Kasterc,Vitak,Klladernicë,Burojë,Vajnik,Abri,Tic,Klinë , Prekaz | 95,880.00 | - | 95,880.00 | - |
| 54005 | Asfaltimi,riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në BL Likoc,Turiqevc,Runik,Qirez | 145,000.00 | **145,000.00** | - | **100.00** |
| 43870 | Fondi i bashkëfinancimit (DFEZH-ja) | 240,000.00 | **58,184.79** | 181,815.21 | |
| 52596 | Blerja dhe mirëmbajtja e kamerave te hapësirave publike në: Rr."Ilaz Kodra", "28 Nëntori", "Ali Gashi", "Rr Osman Geci",parkun "Idriz Rreci" dhe parkun "Amerikan". | 15,000.00 | **1,017.00** | 13,983.00 | **6.78** |
| 54252 | Blerja e aparatit fotografik profesional | 6,000.00 | - | 6,000.00 | - |
| 52597 | Blerja e pajisjeve motorike për pastrimin e qytetit | 50,000.00 | - | 50,000.00 | - |
| 52609 | Digjitalizimi i shkollave Abedin Rexha Turiqevc, Dëshmoret e Qiqavicës Qirez, Shote Galica Runik,Fehmi Rama Likovc, Azem Bejta Prekaz, Malush Ahmeti Rezallë, Elena Gjika Makermal, Enver Haliti | 40,000.00 | - | 40,000.00 | - |
| 55170 | Furnizimi me kabinete dhe laboratore te Shkollave SHFMU "Shaban Jashari", SHFMU " Halit Geci", SHFMU " Skender Skenderi" dhe IAAP "Anton Çetta" | 75,000.00 | **74,976.50** | 23.50 | **99.97** |
| 52602 | Blerja e tabelave interaktive - digjitale në SHFMU Shaban Jashari, Ahmet Delia, Hamez Jashari dhe Anton Qetta | 15,000.00 | - | 15,000.00 | - |
| 50808 | Kanalizimi ne fashtra BL Turiqevc faza-III | 30,000.00 | - | 30,000.00 | - |
| 46418 | Kanalizimi ne BL Qirez | 95,000.00 | **77,021.65** | 17,978.35 | **81.08** |
| 50056 | Kanalizimi fekal Syrigane - Baje | 15,000.00 | **15,000.00** | - | **100.00** |
| 90313 | Kanalizmi fekal ne fshatin Kline e Ulet | 70,000.00 | **70,000.00** | - | **100.00** |
| 50813 | Kanalizimi ne BL-Likovc faza III(Abri dhe Murgë) | 85,000.00 | **22,559.78** | 62,440.22 | **26.54** |
| 44816 | Kanalizimi në BL-Likovc | 23,638.75 | - | 23,638.75 | - |
| 52605 | Ndërtimi i këndeve për lojëra në shkollat: Shaban Jashari Skenderaj, Ahmet Delija Skenderaj, Abedin Rexha Turiqevc, Dëshmoret e Qiqavicës Qirez, Shote Galica Runik, Fehmi Rama Likovc, Azem Bejta | 20,000.00 | **20,000.00** | - | **100.00** |
| 54311 | Asfaltimi i rrugës Kotorr-Qubrel | 16,624.00 | - | 16,624.00 | - |
| 52666 | Ndërtimi i shëtitores natyrale përgjatë shtratit të lumit Klina | 20,000.00 | - | 20,000.00 | - |
| 53905 | Ndërtimi i shtigjeve për ecje: Kuçicë, Çyçavicë, Radishevë dhe Tushilë | 80,000.00 | **2,500.42** | 77,499.58 | **3.13** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 52659 | Ndërtimi i shtigjeve të çiklizmit në zonat me potencial turistik në Bashkësine Lokale në Qirez | 30,000.00 | - | 30,000.00 | - |
| 54319 | Ndërtimi i urave ne fshatrat: Aqarevë,Llaushë ,Kuqicë,Ternafc,Tushilë,Kllodernicë | 15,000.00 | - | 15,000.00 | - |
| 54254 | Paisje elektronike për zerim të seancave të asamblesë | 6,000.00 | - | 6,000.00 | - |
| 52302 | Paisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, QMF-së dhe AMF-ve | 92,900.00 | 92,900.00 | - | 100.00 |
| 51210 | Ndëtimi i kanalizimit fekal në BL Klinë, Prekaz, Turiqevc, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë | 90,000.00 | - | 90,000.00 | - |
| 52572 | Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez | 80,000.00 | 40,000.00 | 40,000.00 | 50.00 |
| 52475 | Punimi i rrjetit të ujësjellësit në Burojë | 157,327.25 | 72,766.63 | 84,560.62 | |
| 51531 | Rehabilitim i kanalizimit nëpër fshatera e BL Klinë e Epërme, Runik, Turiqefc, Prekaz, Polac, Qirez, Likovc dhe Rezallë | 15,000.00 | 15,000.00 | - | 100.00 |
| 54240 | Renovimi dhe rehabilitimi i AMF-ve në Rezalle, Qubrel, Llaushe | 20,000.00 | - | 20,000.00 | - |
| 55168 | Renovimi i objekteve shkollore SHFMU "Shaban Jashari", SHFMU "Halit Geci", SHFMU "Skender Skenderi" dhe IAAP "Anton Çetta". | 120,000.00 | 119,998.50 | 1.50 | 100.00 |
| 48813 | Renovimi i objektit te SHPMPF | 15,000.00 | 3,200.00 | 11,800.00 | 21.33 |
| 54304 | Riparimi dhe zgjerimi i nënndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre | 30,000.00 | - | 30,000.00 | - |
| 54241 | Rregullimi i parkut ne Qendren për Punë Sociale | 5,000.00 | - | 5,000.00 | - |
| 52618 | Rregullimi i subqendrës -Likovc | 45,000.00 | - | 45,000.00 | - |
| 52620 | Rregullimi i subqendrës -Qirez | 45,000.00 | 44,995.50 | 4.50 | 99.99 |
| 52615 | Rregullimi i subqendrës -Runik | 40,000.00 | 20,059.50 | 19,940.50 | 50.15 |
| 53904 | Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve lokale: 28 Nentori, 18 Qershori, Fehmi dhe Xheva Lladrovci, Emin Lati, Ilaz Kodra, Gjergj Fishta, Sala e Hamit Jashari, 17 Shkurti, Gjon Buzuku,Fadi | 50,000.00 | 49,756.23 | 243.77 | 99.51 |
| 52658 | Shenjëzimi i pikës më të lartë dhe vendosja e një teleskopi vrojtues | 25,000.00 | 25,000.00 | - | 100.00 |
| 52646 | Tribunat ne stadiumin e qytetit | 90,000.00 | - | 90,000.00 | - |
| 51211 | Ndërtimi i trotuareve dhe ndriqimi publik në BL Likovc,Klinë e Epërme,Klinë e mesme, Polac,Runik,Turiqevc, Prekaz, Qirez, Runik | 25,000.00 | 25,000.00 | - | 100.00 |
| 53903 | Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha | 25,000.00 | 25,000.00 | - | 100.00 |
| 52641 | Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së | 590,000.00 | 390,000.00 | 200,000.00 | |
| 54317 | Vendosja e një billbordi ne pika turistike ne Prekaz | 5,000.00 | - | 5,000.00 | - |
| **Kodi buxhetor** | **21 BUXHETI NGA TE HYRAT VETANAKE** | **BUXHETI I PLANIFIKUAR** | **BUXHETI I SHPENZUAR** | **DIFERENCA** | **% E REALIZ.** |
| 52568 | Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 -Prekaz | 50,000.00 | | 50,000.00 | - |
| 54281 | Asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Kuqicë,Qubrel,Kasterc,Vitak,Klladernicë,Burojë,Vajnik,Abri,Tic,Klinë , Prekaz | 54,120.00 | - | 54,120.00 | - |
| 54005 | Asfaltimi,riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në BL Likoc,Turiqevc,Runik,Qirez | 140,000.00 | 140,000.00 | - | 100.00 |
| 52609 | Digjitalizimi i shkollave Abedin Rexha Turiqevc, Dëshmoret e Qiqavicës Qirez, Shote Galica Runik,Fehmi Rama Likovc, Azem Bejta Prekaz, Malush Ahmeti Rezallë, Elena Gjika Makermal, Enver Haliti | 23,151.00 | - | 23,151.00 | - |
| 52556 | Kanalizimi Aqarevë dhe Kopiliq i ulët | 20,000.00 | | 20,000.00 | |
| 52478 | Kanalizimi fekal Izbicë, Rakinicë dhe Leqinë | 20,000.00 | 20,000.00 | - | |
| 50056 | Kanalizimi fekal Syrigane - Baje | 80,000.00 | - | 80,000.00 | - |
| 44816 | Kanalizimi në BL-Likovc | 30,000.00 | 11,692.80 | 18,307.20 | 38.98 |
| 54319 | Ndërtimi i urave ne fshatrat; Aqarevë,Llaushë ,Kuqicë,Ternafc,Tushilë,Kllodernicë | 40,000.00 | - | 40,000.00 | - |
| 52302 | Paisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, QMF-së dhe AMF-ve | 35,000.00 | | 35,000.00 | - |
| 51210 | Ndëtimi i kanalizimit fekal në BL Klinë, Prekaz, Turiqevc, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë | 40,000.00 | - | 40,000.00 | - |
| 52572 | Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez | 120,000.00 | - | 120,000.00 | - |
| 55168 | Renovimi i objekteve shkollore SHFMU "Shaban Jashari", SHFMU "Halit Geci", SHFMU "Skender Skenderi" dhe IAAP "Anton Çetta". | 30,000.00 | 30,000.00 | - | 100.00 |
| 52618 | Rregullimi i subqendrës -Likovc | 140,000.00 | 71,775.80 | 68,224.20 | 51.27 |
| 52620 | Rregullimi i subqendrës -Qirez | 140,000.00 | 68,671.00 | 71,329.00 | 49.05 |
| 52615 | Rregullimi i subqendrës -Runik | 90,000.00 | 20,000.00 | 70,000.00 | 22.22 |
| 51211 | Ndërtimi i trotuareve dhe ndriqimi publik në BL Likovc,Klinë e Epërme,Klinë e mesme, Polac,Runik,Turiqevc, Prekaz, Qirez, Runik | 70,000.00 | | 70,000.00 | - |
| 53903 | Unaza e brendshme 3 krahu kah Llausha | 50,000.00 | - | 50,000.00 | - |
| **Kodi buxhetor** | **22 BUXHETI NGA TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA** | **BUXHETI I PLANIFIKUAR** | **BUXHETI I SHPENZUAR** | **DIFERENCA** | **% E REALIZ.** |
| 44822 | NDERTIMI I SHKOLLES FILLORE NË FSHATIN MAKERMAL | 1,296.25 | - | 1,296.25 | - |
| 51209 | ASFAL.RR.KLINE PREKAZ TURIQEVC QIREZ RUNIK LIKOC REZALL | 472.68 | - | 472.68 | - |
| 52478 | KANALIZIMI FEKAL IZBICË-RAKINICË-LEQINË | 30,000.00 | 25,830.64 | 4,169.36 | 86.10 |
| 52618 | RREGULLIMI I SUBQENDRËS - LIKOVC | 50,030.00 | 50,030.00 | - | 100.00 |
| 52620 | RREGULLIMI I SUBQENDRËS - QIREZ | 50,000.00 | 50,000.00 | - | 100.00 |
| 54005 | ASFALTIMI, RIPARIMI DHE KUBEZIMI I RRUGEVE NE BL LIKOC, TURIÇEC | 1,135.24 | 1,135.00 | 0.24 | 99.98 |
| | **Totali** | **4,507,693.53** | **2,134,919.15** | **2,366,786.49** | **47.36** |

## SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE – DREJTORIVE DHE ZYRAVE

| Nr. | LLOJI I SHPENZIMEVE | KODI EKONOMIK | PROGRAMET SHPENZUESE TE BUXHETIT 2024 Zyra e Kryetarit | Administrata | Inspekcioni | Prokurimi | Z e KK | Buxheti | SHP | ZLK |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendi | 13140 | 855.00 | | | | | | | |
| 2 | Para xhepi /Meditje për udhëtim jashtë vendit | 13141 | | 78.00 | | | | | | |
| 3 | Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendi | 13142 | 2,333.32 | | | | | | | |
| 4 | Shpenzimet tjera për udhtimët zyrtare jashtë vendi | 13143 | 3,888.90 | | | | | | | |
| 5 | Shpenzimet të internetit | 13310 | | | | | | | | |
| 6 | Telefonia mobile | 13320 | | | 65.00 | | | | 7,087.44 | |
| 7 | Shpenzime postare | 13330 | | 780.80 | | | | 4,034.51 | | |
| 8 | Shërbimet e arsimit/trajnimit | 13410 | | | | | | | | |
| 9 | Sherbime të ndryshme intelektuale dhe keshilldhense | 13440 | 1,003.12 | 1,591.32 | 1,042.59 | | 680.92 | 427.50 | 1,080.63 | |
| 10 | Shërbimet e veqanta -Konsulentë dhe Kontraktorë individual | 13445 | | | 1,171.12 | | 429.17 | 46.43 | 1,050.00 | |
| 11 | Sherbimet shtypjes /Printim | 13450 | 2,260.98 | | 7,489.00 | | 1,338.64 | | | |
| 12 | Sherbime kontraktuese tjera | 13460 | | 600.00 | | | | | 28,278.40 | |
| 13 | Sherbime teknike | 13470 | | | | | | | 171.10 | |
| 14 | Softuerët- Licencat dhe mirëmbajtja e tyre | 13471 | | 4,800.00 | | | | | | |
| 15 | Sigurimi fizik i objekteve publike | 13475 | | | | | | | 64,850.24 | |
| 16 | Shpenzimet për anëtarsim | 13480 | | 7,628.70 | | | | 2,900.00 | | |
| 17 | Mobilje | 13501 | 2,178.00 | 1,731.00 | | | | | 3,033.00 | |
| 18 | Kompjutera me pak se 1000 | 13503 | 990.00 | | | | | | | |
| 19 | Hardwer për teknologji informative <1000 | 13504 | | | | | | | | |
| 20 | Makinat fotokopiuese -multifunksionale | 13505 | | | | 980.00 | | | | |
| 21 | Paisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro ) | 13506 | | | | | | | | |
| 22 | Paisje tjera | 13509 | | | | | | 53.10 | | |
| 23 | Furnizime per zyre | 13610 | 2,722.30 | 548.90 | | 1,652.70 | 94.10 | 564.80 | 1,499.00 | |
| 24 | Dokumenta Blanko | 13611 | | | | | | | | |
| 25 | Furnizim me ushqim dhe pije ( jo dreka zyrtare) | 13620 | 4,200.90 | 744.50 | 698.40 | 880.50 | 2,777.80 | 660.00 | | 250.00 |
| 26 | Furnizime mjekësore | 13630 | | | | | | | | |
| 27 | Furnizim pastrimi | 13640 | | | | | | 300.00 | 325.68 | |
| 28 | Furnizim me veshmbathje | 13650 | | | | | | | | |
| 29 | Vajëra | 13710 | | | | | | | | |
| 30 | Naft per ngrohje qendrore | 13720 | | | | | | | | |
| 31 | Drutë dhe prodhimet endrurit për ngrohje | 13760 | | | | | | | | |
| 32 | Derivate per xhenerator | 13770 | | | | | | | | |
| 33 | Derivate per automjete, Gjeneratorë dhe makineri | 13780 | 3,734.23 | 569.76 | 1,290.57 | 244.44 | 770.24 | 513.98 | 3,962.70 | 629.49 |
| 34 | Avanc për para te imëta ( PETTY CASH) | 13810 | | | | | | | | |
| 35 | Rexhistrimi i automjeteve | 13950 | 50.00 | 100.00 | 75.00 | | | 75.00 | 1,075.00 | |
| 36 | Sigurim i automjeteve | 13951 | | 1,078.84 | | | | | 2,393.04 | |
| 37 | Kontrollim teknik I automjeteve | 13954 | | 120.00 | | | | | 230.00 | |
| 38 | Mirmbajtja dhe riparim i automjeteve | 14010 | 2,104.00 | 3,372.00 | | | | | 195.00 | |
| 39 | Mirmbajtja dhe riparim i ndërtesave | 14020 | | | | | | | | |
| 40 | Mirmbajtja e ndertesave administrative afariste | 14022 | | 3,019.44 | 1,477.40 | | | | 36,465.42 | |
| 41 | Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore | 14023 | | | 10,000.00 | | | | | |
| 42 | Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore | 14024 | | | | | | | | |
| 43 | Mirëmbajtja e rrugëve lokale | 14032 | | | | | | | 138,351.57 | |
| 44 | Mirëmbajtja e teknologjisë informative | 14040 | | | | | | | | |
| 45 | Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve | 14050 | | 9,525.00 | | | | | 7,503.50 | |
| 46 | Mirëmbajtja rutinore | 14060 | | | | | | | 60,705.25 | |
| 47 | Qiraja për makineri | 14140 | | | | | | | | |
| 48 | Kompensimi I përfaqsimit brenda vendit | 14310 | 4,899.30 | 3,269.60 | 102.80 | | 2,014.00 | 24.30 | | |
| 49 | Dreka zyrtare jashtë vendi | 14320 | | | | | | | | |
| 50 | Shpenzimet e vendimeve gjykatave | 14410 | | | | | | | 12,619.22 | |
| | MALLËRA DHE SHËRBIME | | **31,220.05** | **39,557.86** | **23,411.88** | **3,757.64** | **8,104.87** | **9,599.62** | **370,876.19** | **879.49** |
| 1 | Energjija elektrike | 13210 | | | | | | | 49,103.12 | |
| 2 | Shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit | 13220 | | | | | | | 6,056.36 | |
| 3 | Mbeturinat | 13230 | | | | | | | 2,681.90 | |
| 4 | Telefonia fikse | 13250 | | | | | | | 412.31 | |
| | SHERBIMET E KOMUNALIVE | | - | - | - | - | - | - | **58,253.69** | - |
| 1 | Subvencionet për Etnitete Publike | 21110 | | | | | | | | |
| 2 | Subvencione për Etnitete Jo Publike | 21200 | 700.00 | 4,800.00 | | | | | 4,801.38 | |
| 3 | Transferet për përfitues individual tjerë | 22202 | 7,400.00 | | | | | | 18,280.00 | |
| 4 | Pagesa për sherbimet e varrimit | 22298 | | | | | | | 43,410.00 | |
| 5 | Qiraja për raste sociale | 22299 | | | | | | | | |
| | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | | **8,100.00** | **4,800.00** | - | - | - | - | **66,491.38** | - |

| Nr. | LLOJI I SHPENZIMEVE | KODI EKONOMIK | Bujqesia | Pl.dhe.zhv.ek. | GJK dhe P | Urban | Shendetesi | K,R dhe S | Arsimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendi | 13140 | | | | | | | |
| 2 | Para xhepi /Meditje për udhëtim jashtë vendit | 13141 | | | | | 104.00 | | |
| 3 | Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendi | 13142 | | | | | | | |
| 4 | Shpenzimet tjera për udhtimët zyrtare jashtë vendi | 13143 | | | | | | | |
| 5 | Shpenzimet të internetit | 13310 | | | | | | | 4,440.00 |
| 6 | Telefonia mobile | 13320 | 20.00 | | | | 665.00 | | 2,028.00 |
| 7 | Shpenzime postare | 13330 | | | | | | | |
| 8 | Shërbimet e arsimit/trajnimit | 13410 | | | | | | | 8,500.00 |
| 9 | Sherbime të ndryshme intelektuale dhe keshilldhense | 13440 | 1,282.50 | 465.54 | | 1,145.53 | 1,211.36 | 465.54 | 465.54 |
| 10 | Shërbimet e veçanta -Konsulentë dhe Kontraktorë individual | 13445 | | | | 1,232.74 | | | |
| 11 | Sherbimet shtypjes /Printim | 13450 | 332.63 | | 1,000.00 | | 4,332.05 | 4,748.97 | 4,364.48 |
| 12 | Sherbime kontraktuese tjera | 13460 | 600.00 | | | 54,914.50 | 98,509.60 | | 32,923.60 |
| 13 | Sherbime teknike | 13470 | 4,095.00 | | | | 708.96 | | 990.00 |
| 14 | Softuerët- Licencat dhe mirëmbajtja e tyre | 13471 | | | | | | | |
| 15 | Sigurimi fizik i objekteve publike | 13475 | | | | | | | |
| 16 | Shpenzimet për anëtarsim | 13480 | | | | | | | |
| 17 | Mobilje | 13501 | 2,828.00 | | | | 1,028.00 | 546.00 | 9,179.38 |
| 18 | Kompjutera me pak se 1000 | 13503 | | | | | | | |
| 19 | Hardwer për teknologji informative <1000 | 13504 | | | | | | | |
| 20 | Makinat fotokopiuese -multifunksionale | 13505 | | | | | | | |
| 21 | Paisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro ) | 13506 | | | | | | | |
| 22 | Paisje tjera | 13509 | | | | | | | 4,273.00 |
| 23 | Furnizime per zyre | 13610 | 476.70 | | | | 1,956.80 | 624.20 | 11,226.60 |
| 24 | Dokumenta Blanko | 13611 | | | | | 3,042.40 | | |
| 25 | Furnizim me ushqim dhe pije ( jo dreka zyrtare) | 13620 | 49.50 | 54.00 | | 609.40 | 20,606.04 | 675.00 | 19,283.27 |
| 26 | Furnizime mjekësore | 13630 | | | | | 9,640.43 | | |
| 27 | Furnizim pastrimi | 13640 | | | | | 4,725.05 | | 10,816.84 |
| 28 | Furnizim me veshmbathje | 13650 | | | | | | | |
| 29 | Vajëra | 13710 | | | | | | | |
| 30 | Naft per ngrohje qendrore | 13720 | | | | | 23,959.10 | | 1,389.54 |
| 31 | Drutë dhe prodhimet endrurit për ngrohje | 13760 | | | | | | | 126,630.00 |
| 32 | Derivate per xhenerator | 13770 | | | | | | | |
| 33 | Derivate per automjete, Gjeneratorë dhe makineri | 13780 | 612.83 | 306.72 | 428.91 | 1,323.81 | 20,469.06 | 2,334.37 | 4,147.48 |
| 34 | Avanc për para te imëta ( PETTY CASH) | 13810 | | | | | | | |
| 35 | Rexhistrimi i automjeteve | 13950 | 85.00 | | | | 867.00 | | 75.00 |
| 36 | Sigurim i automjeteve | 13951 | | | | | 1,934.73 | | |
| 37 | Kontrollim teknik I automjeteve | 13954 | | | | | | | |
| 38 | Mirmbajtja dhe riparim i automjeteve | 14010 | | | 195.00 | | 10,534.20 | 225.00 | |
| 39 | Mirmbajtja dhe riparim i ndërtesave | 14020 | | | | | | | |
| 40 | Mirmbajtja e ndertesave administrative afariste | 14022 | 906.30 | | | 1,622.20 | | | |
| 41 | Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore | 14023 | | | | | | | 177,932.97 |
| 42 | Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore | 14024 | | | | | 37,172.03 | | |
| 43 | Mirëmbajtja e rrugëve lokale | 14032 | | | | | | | |
| 44 | Mirëmbajtja e teknologjisë informative | 14040 | | | | | | | |
| 45 | Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve | 14050 | | | | | 37,948.50 | | 12,160.00 |
| 46 | Mirëmbajtja rutinore | 14060 | | | | | | | 990.00 |
| 47 | Qiraja për makineri | 14140 | | | | | | | |
| 48 | Kompensimi I përfaqsimit brenda vendit | 14310 | 300.70 | 305.30 | 435.90 | | 5,168.00 | 150.00 | 2,480.10 |
| 49 | Dreka zyrtare jashtë vendi | 14320 | | | | | | | |
| 50 | Shpenzimet e vendimeve gjykatave | 14410 | | | | | | | |
| | MALLËRA DHE SHËRBIME | | **11,589.16** | **1,131.56** | **2,059.81** | **60,848.18** | **284,582.31** | **9,769.08** | **434,295.80** |
| 1 | Energjija elektrike | 13210 | | | | | 21,981.69 | | 28,573.28 |
| 2 | Shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit | 13220 | | | | | 3,759.13 | | 9,413.67 |
| 3 | Mbeturinat | 13230 | | | | | 3,199.44 | | 22,008.16 |
| 4 | Telefonia fikse | 13250 | | | | | 251.40 | | 137.98 |
| | SHERBIMET E KOMUNALIVE | | - | - | - | - | **29,191.66** | - | **60,133.09** |
| 1 | Subvencionet për Etnitete Publike | 21110 | | | | | | | |
| 2 | Subvencione për Etnitete Jo Publike | 21200 | 100,630.00 | 17,955.22 | | | 3,500.00 | 141,000.00 | |
| 3 | Transferet për përfitues individual tjerë | 22202 | 59,370.00 | 4,500.00 | | | 114,770.00 | 16,794.00 | 89,950.00 |
| 4 | Pagesa për sherbimet e varrimit | 22298 | | | | | | | |
| 5 | Qiraja për raste sociale | 22299 | | | | | 4,760.00 | | |
| | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | | **160,000.00** | **22,455.22** | | - | **123,030.00** | **157,794.00** | **89,950.00** |

Drejtori i DBF-së
Z. Ismet Aliu

Kryetari i Komunës
Z. Fadil Nura

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT • KRYETARI I KOMUNËS

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

20-06-2024
04 47 899 1

| | |
|---|---|
| **Per:** | Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës<br>Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skënderajt<br>Kryetarin e Kuvendit Komunal të Komunës së Skënderajt |
| **Kopje elektronike:** | Hykmete Bajrami, Kryetare e KMFP<br>Armend Muja, Kryetar i KBPT |
| **Nga:** | Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës |
| **SUBJEKTI:** | Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt për vitin 2023. |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr. Zyrës:** | **Ext:** | **Data: 19.06.2024** |

| Data | Zyra e Pranimit | Komentet/Veprimet | Inicialet | Afati |
|---|---|---|---|---|
| | | Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt për vitin 2023.<br><br>Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Pëgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport. | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SKËNDERAJT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

**Prishtinë, qershor 2024**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT


1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Skënderajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

### Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skënderajt (SK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Skënderajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### Baza për konkluzion

B1 Fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 39 ditë deri në 300 ditë.

B2 Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Skënderajt.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Skënderajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Skënderajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

### Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Skënderajt me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Skënderajt.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në veçanti, kemi identifikuar dobësi në fushën e llogarive te arkëtushme, obligimeve të papaguara, keqklasifikimi i shpenzimeve, menaxhimin e pasurive si dhe në menaxhimin e kontratave. Këto çështje janë paraqitur si gjetje dhe rekomandime të mëposhtme për t'u shqyrtuar.
Rekomandimet e paraqitura më poshtë, synojnë të përmirësojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar, duke respektuar autoritetin që lidhet me menaxhimin e fondeve në sektorin publik. Plani ynë është të rishikojmë dhe të ndjekim këto rekomandime gjatë procesit të auditimit për vitin e ardhshëm. Raporti ynë ka rezultuar me 7 rekomandime prej tyre 3 janë rekomandime të reja dhe 4 të përsëritura për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për kontratën kolektive ishte 48,210€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 31,1559€, ndërsa 17,054€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimi.
Kategoria e Pagave dhe Shtesa borxhi kryesor ishte 30,169€ ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimit ishin 16,658€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuara

**Gjetja**

Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se pesë (5) fatura, në vlerë prej 65,408€ nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 39 ditë deri në 300 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

**Ndikimi**

Vonesat në kryerjen e obligimeve kanë shkaktuar kosto shtesë, ku përveç vlerës së faturës komuna kishte paguar kosto shtesë përfshirë kamatën, interesin.

**Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të fondeve buxhetore, si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur fondet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### Çështja B2 - Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave

**Gjetja**

Neni 22 i Rregullës Financiare NR.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 20 mostrat të testuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kemi vërejtur se në 13 raste, urdhër blerja është proceduar pas datës se faturës dhe pranimit të mallit. Shuma totale e këtyre rasteve është 223,499€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive me rastin e procedimit të zotimit dhe urdhër blerjes.

**Ndikimi**

Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi B2**

Kryetari duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë se ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra shërbime dhe komunali në vitin 2023 ishte 2,881,513€, prej tyre ishin shpenzuar 2,792,285€ apo 97%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, derivatet dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, servisimi i veturave, furnizime mjekësore etj.

**Çështja A1 - Mungesa e komisionit të pranimit**

**Gjetja**

Neni 8 pika 4, të Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo kapitale në organizatat buxhetore, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhje me kontratën apo urdhër blerjen.

Në një (1) rast kemi vërejtur se nuk ishte formuar komisioni i pranimit të mallit. Ky rast, ka të bëjë me furnizim me kompjuterë për shkollë në vlerë 21,466€. Edhe për kundër mos respektimit të procedures, furnizimet ishin pranuar sipas kushteve të kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve si rezultat i anashkalimit të procedurave me rastin e efektive gjatë furnizimit dhe pranimit të mallrave.

**Ndikimi**

Pranimi i mallrave/furnizimeve në mungesë të komisionit përkatës për pranimin e tyre, e rrit rrezikun e pranimit të mallrave/furnizimeve jo sipas llojit, sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të sigurojë që pranimi i mallit të blerë, të bëhet vetëm nga komisioni i autorizuar, për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,969,097€, prej tyre ishin shpenzuar 4,751,813€ apo 96% Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

**Çështja A2 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit**

**Gjetja**

Pika 61 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh që të Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës se kontraktuesve të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Komuna menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës se kontraktuesve nuk e ka mbajt dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhe si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e menagjimit të kontratave përmes e-prokurimit.

**Ndikimi**

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

**Çështja A3 - Keq klasifikim i shpenzimeve**

**Gjetja**

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Nga testimi i mostrave tona, kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 63,676€. Siç janë:

- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve vlera prej 54,600€ është paguar për investime kapitale. Kjo pagesë është realizuar për furnizimin dhe mbjelljen e drunjëve dekorativë
- Nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 2,452€ është paguar për paga dhe mëditje. Kjo pagesë është realizuar për të paguar pagat jubilare sipas kontratës kolektive; dhe
- Nga kategoria e investimeve vlera prej 6,624€ është paguar për mallra dhe shërbime. Kjo pagesë është realizuar për furnizim me pelet.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

**Ndikimi**

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe të plota.

**Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e paraqitur në PFV është 150,120,041 e pasurive jokapitale është 67,546 dhe e stoqeve 72,422€.

**Çështja B3 - Shpalosje jo e plotë dhe e saktë e pasurisë në PVF**

**Gjetja**

Rregullore MF - nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo-financiare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive jo financiare kapitale. Po ashtu sipas neni 24 paragrafi 2. Paraqitja në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga e-pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit.

Çështjet të cilat kemi identifikuar gjatë auditimit lidhur me menaxhimin në fushën e pasurive jo financiare mbi 1,000€ janë:

- Pajisja e regjistruar në regjistrin e pasurisë në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) në vitin 2015 me vlerë 29,800€ me emërtimin "Agregat gnt 275" ishte regjistruar me jetëgjatësi të përdorimit 20 vite dhe do të duhej të ishte për 10 vite. Kjo e bënë që zhvlerësimi për pasurinë të jetë mbivlerësuar për vlerën 10,430€;
- Toka e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK në vitin 2009 me në vlerë 7,004€ me emërtimin "Toka shf-k.drenices-abri p-sip. 0.35.02ha", me jetëgjatësi të përdorimit 40 vite, është zhvlerësuar për 13 vite, derisa toka nuk zhvlerësohet. Po ashtu, pasuria e regjistruar në vitin 2009 - "Toka shf-sh.g-radishevë sip. 12.29m2", në vlerë 3,858€ me jetëgjatësi të përdorimit 40 vite, është zhvlerësuar për 13 vite;
- Zhvlerësimi i akumuluar për tokën është 2,408€ dhe 1,310€ të cilat njëkohësisht kanë ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë;
- Shkolla e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK në vitin 2015 me vlerë 204,997€, me emërtimin "Ndërtimi sh.m.gj. Hamzë Jashari Skënderaj", ishte regjistruar si investim në vijim. Edhe pse objekti shkollor është në përdorim nga shtatori 2021, në regjistrat e pasurisë, kjo vazhdon të mbetet si investim në vijim duke mos i kalkuluar zhvlerësimin për këtë periudhë. Kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë për vlerën 6,833€;
- Pajisja e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK me emërtimin "Pompe uji në shkollën fillore në Likovcë", e blerë në vlerë 2,600€ në vitin 2015, ishte regjistruar me jetëgjatësi të përdorimit 25 vite, ndërsa do të duhej të ishte me gjashtë (6) vite. Si rrjedhojë, kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë për vlerën 1,785€ .

Vlera e pasurive jo financiare nën 1,000€ të prezantuara në PVF ishte 67,546€, ndërsa në sistemin "e-pasuria", ishte 40,584€, kjo ka ndikuar në një mbivlerësim të vlerës së pasurive nën 1,000€ në shumë prej 26,962€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare.

| | |
|---|---|
| **Ndikimi** | Kjo ndikon në prezantimin e pasaktë në vlerat e tyre neto në librat e pasurive dhe rrjedhimisht edhe në pasqyrat financiare vjetore. |
| **Rekomandimi B3** | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.5 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2023 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 1,269,505€.

**Çështja B4 - Mangesi në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme**

**Gjetja**

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005,Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshmeve (LIA). Për mostrat tona nuk kemi vërejt që komuna ka marr ndonjë veprim konkret për vitin 2023 për inkasimin e LIA. Rrritja e llogarive te arketueshme eshte tek shrytezimi I pronave publike, kurse edhe tek tatami ne prone nuk jane ndermarre hapa per inkasim. Zvogelimi I llogarive te arketueshme nga tatimi ne prone nuk ka ndodhe per shkak te veptimeve te ndermarra per inkasim , por per shkak te faljes se borxheve ngatatimi ne prone.

Ky zvogëlim ka ndodh për arsye të zvogëlimit të borxhit nga tatimi në prone, konkretisht për shkak të faljes të tatimit në prone që ka ndodh në vitin 2023.

**Ndikimi**

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Në të njëjtën kohë, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e nevojshëm të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

**Rekomandimi B4**

Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

# 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final[6] | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e fondeve** | **16,291,891** | **19,058,446** | **18,709,687** | **14,195,206** | **14,057,504** |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 14,973,771 | 16,423,155 | 16,257,693 | 12,543,990 | 12,485,548 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 0 | 0 | 129,597 | 63,496 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 435,197 | 417,798 | 309,371 | 313,788 |
| Të hyrat vetanake | 1,318,120 | 1,769,461 | 1,607,215 | 1,197,791 | 1,063,816 |
| Donacionet vendore | 0 | 422,456 | 420,575 | 0 | 1,242 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 8,177 | 6,406 | 14,456 | 129,615 |

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,766,555€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprake dhe vendimeve të qeverisë. Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 98% të buxhetit final, me një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2022.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike** | **16,291,891** | **19,058,446** | **18,709,687** | **14,195,206** | **14,057,504** |
| Pagat dhe mëditjet | 8,305,130 | 9,769,851 | 9,758,084 | 8,127,199 | 8,301,053 |
| Mallrat dhe shërbimet | 2,484,856 | 2,542,290 | 2,474,417 | 1,773,318 | 1,499,467 |
| Komunalitë | 267,250 | 339,223 | 317,868 | 198,310 | 201,916 |
| Subvencionet dhe transferet | 935,000 | 1,437,986 | 1,407,504 | 803,249 | 735,777 |
| Investimet Kapitale | 4,274,655 | 4,969,097 | 4,751,813 | 3,293,129 | 3,319,291 |
| Rezervat | 25,000 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,464,721€. Rritja ishte nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave në shumë 1,458.272€ dhe nga donacionet 6,449€.
Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 57,434€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara.
Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 71,973€ nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2022.
Buxheti final për subvencione ishte rritur për 502,986€ nga kjo vlerë: 88,221€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022 dhe 414,765 rritje nga donacionet.
Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 694,442.€. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetjake të pa shpenzuara 33,691€ dhe rritja prej 660,751€ me vendime të kuvendit komunal.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023




Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2023 ishin 1,318,120€, përderisa ishin realizuar 1,786,438€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 148,971€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 90€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të hyrave** | **1,318,120** | **1,318,120** | **1,786,438** | **1,444,554** | **1,261,294** |
| Të hyrat tatimore | 409,657 | 409,657 | 374,702 | 336,698 | 282,731 |
| Të hyrat jo tatimore | 908,463 | 908,463 | 1,411,736 | 1,107,856 | 978,563 |

# 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar me 7 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 3 rekomandime janë zbatuar, dhe 4 rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë se ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike. | Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 2. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari, duhet të sigurojë që nevojat e komunës për pozitat të rregullta të adresohen në Ministrin e Financave Punës dhe Transfereve dhe aty ku është e nevojshme angazhimi i stafit me marrëveshje të veçanta, të respektohen kërkesat ligjore në fuqi. | Janë ndërmarrë veprime. | I zbatuar |
| 3. | Pasuritë | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim te të gjithë listës së pasurive të komunës. | Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 4. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme duke hartuar dhe aplikuar plane dhe procedura të qarta, apo ndërmarrjen e veprimeve ligjore për arkëtimin e Ll/A. | Nuk janë ndërmarrë veprime | Nuk ka filluar zbatimi |
| 5. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik. | Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 6. | Auditimi i Brendshëm | Kryetari, duhet të sigurojë që pozitat e zbrazëta në NjAB të plotësohen sa me herët të jetë e mundshme, që do të ndikonin në funksionimin dhe forcimin e kontrolleve të brendshme. | Janë ndërmarrë veprime. | I zbatuar |
| 7. | Auditimi i Brendshëm | Kryetari duhet të sigurojë që komiteti i auditimit të jetë funksional, që t'i ndihmon në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës, duke ofruar këshilla dhe rekomandime që kanë të bëjnë me qeverisjen, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit të brendshëm. | Janë ndërmarrë veprime. | I zbatuar |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit

Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit

Hysen Restelica, Anëtar i ekipit

Fetah Osmani, Anëtar i ekipit

# Shtojca I: Letër konfirmimi

## Letër konfirmimi

Nr: 04-[illegible]
Datë: 27.05.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Kuvendi i Komunës Skenderaj**
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem/ nuk pajtohem/ pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Fadil Nura

(Kryetar i Komunës se Skenderajt),

Data: 27.maj.2024, Skenderaj,

# Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[7] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[8], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**
*Forma e opinionit*

**Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

### Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] 1. Fatura e pranuar me 15.03.2023 në vlerë 17,892.72€, ishte paguar me 20.02.2024; 2. Fatura e pranuar me 26.12.2023 në vlerë 1.944,00€, ende nuk është e papaguar; 3. Fatura e pranuar me 30.05.2023 në vlerë 10.750,00€, ende nuk është e papaguar; 4. Fatura e pranuar me 21.00.2023 në vlerë 16.390,00€, ende nuk është e papaguar; dhe 5. Fatura e pranuar me 13.12.2023 në vlerë 18.431,38€, ende nuk është e papaguar.

[6] Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[7] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[8] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 04-052/01-00303 77/24
Data
Data 03.07.2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor**

**Për:** Zyrën Kombëtare të Auditimit

**Nga:** Kryetar i Komunës së Skenderajt z. **Fadil Nura** ____________

Datë : 01.07.2024

# PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË JASHTËM 2023

| Nr. | Të gjeturat/çështjet | Rekomandimet | Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit | Datat e përcaktuara | Bartësit/ Drejtoritë përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Çështja B1<br><br>Vonesa në pagesën e faturave të pranuara. | Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të fondeve buxhetore, si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur fondet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik. | Zotohemi së ZKF-ja dhe Drejtuesit e programeve do të bëjn një planifikim të arsyshëm dhe pagesat do të kryhen brenda afatit ligjor.<br><br>Për të gjitha faturat paraprakisht do të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj procedurat në vijim për procesim të pagesave. | 01.07.2024 dhe në vazhdimësi | ZKF<br><br>Drejtorët e Drejtorive/ Zyrave |
| 2 | Çështja B2<br><br>Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave. | Kryetari duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë se ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike. | ZKA dhe ZKF në koordinimi me Drejtuesit e programeve do të përkujdesen për zbatimin e rregullores nr. 01/2023/MF shpenzimi i parave publike duke respektuar proceduarat e pagesave që asnjë shpenzim mos të procedohet pa i plotësuar rregullat. | Nga 01.07.2024 dhe në vazhdimësi | Drejtorët e Drejtorive/ Zyrave<br>ZKF<br>Zyrtari për urdherblerje |
| 3 | Çështja A1<br><br>Mungesa e komisionit të pranimit | Kryetari duhet të sigurojë që pranimi i mallit të blerë, të bëhet vetëm nga komisioni i autorizuar, për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë. | ZKA do të formoje çdo herë Komisionet e pranimit të mallit dhe shërbimeve në afatin kohorë, ku komisionet do të jenë përgjegjëse për të garantuar sasinë dhe cilësinë sipas kontratës, gjithnjë sipas rregullores 02/2013. | Nga 01.07.2024 dhe në vazhdimësi | Drejtoria e Arsimit<br><br>Drejtoret e Drejtorive |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Çështja A2<br><br>Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit | Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik. | ZKA do të zbatoj Rregullën dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin Publik që Menaxhimi i kontratave dhe Vlerësimi i përformancës të arkivohet në sistem të prokurimit elektronik, kjo procedurë do të implementohet nga Menaxherët e Kontratave dhe do të monitorohet nga ZKA. | Nga 01.07.2024 dhe në vazhdimësi | Menaxheret e kontratave<br><br>Drejtoria e Prokurimit |
| 5 | Çështja A3<br><br>Keq klasifikim i shpenzimeve | Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate. | ZKA, ZKF dhe Drejtorët e drejtorive/Zyrave në koordinim dhe bashkëpunim me zyrtarët e sektorit për buxhet dhe thesar do të forcojnë kontrollin e brendshëm në mënyre që të procedohet çdo shpenzim nga kodi adekuat sipas plani kontabël. | Nga 01.07.2024 dhe në vazhdimësi | Zyrtaret për Buxhet dhe Thesar |
| 6 | Çështja B3<br><br>Shpalosje jo e plotë dhe e saktë e pasurisë në PVF | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës. | E-pasuria ska qenë funksionale, tani është e rregulluar dhe kemi filluar ta funksionalizojmë dhe deri në fund të vitit do jetë e përfunduar si proces (TM4) 2024. Ndërsa të zhvlerësimi i gabuar në vitet e mëhershme sipas zyrtarëve përkatës në MF që menaxhojnë programet mundësia e ndërhyrjes është e pamundur, por me kalimin e kohës zhvlerësimi i këtyre pasurive bjen në vlerën zero dhe më nuk do të reflektoj në PVF. | Nga 01.07.2024 dhe në vazhdimësi | Zyrtaret e Depos<br><br>DSHMS D.Arsimi<br><br>Zyrtari i Pasurisë |
| 7 | Çështja B4<br><br>Mangesi në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme | Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme | Menaxheri i Tatimit në Pronë ka filluar ndërmarrjen e masave për llogari të arkëtueshme-dorëzimi i leterkujtesave dhe njoftimeve përfundimtare të Tatimpaguesit dhe përgatitja e lëndeve për bllokim të llogarive (taksa paguesit, obliguesit e tatimit në pronë dhe shfrytëzuesit e pronave publike). | Nga 15.06.2024 dhe në vazhdimësi | DBF<br><br>DGJKP<br><br>DZHENIT |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr./No. 04-400/01-0032372/24
Data/Data 10.07.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Kuvendi i Komunës Skenderaj**
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

**Zyra e Kryetarit** /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **10.07.2024** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Kryesuesen e Kuvendit Komunal, z. Adelina Spahiu** |
| **Cc:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Kryetarit të Komunës z. Fadil Nura** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Drejtori për Buxhet dhe F, z. Ismet Aliu** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023 për shpenzim në vitin 2024 .** |

Të nderuar/a,

Duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/l-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, përmes këtij propozim vendimi kërkohet aprovimi i juaj për bartjen e të hyrave vetanake komunale të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024 ne shumën prej **164,783.15 €** dhe këto te hyra te jenë ne dispozicion për financim te shpenzimeve kapitale:

**Të bartën në kategorinë e shpenzimeve kapitale në nën-programin:**

**Buxhetimi 17523, kodi funksional 0112 në projektin:**
**Fondi i bashkëfinancimit (DBF-ja) kodi i projektit 43870, shuma 164,783.15 €**

**Arsyetimi:**

Mjetet e te hyrave vetanake janë depozituar ne fondin e Kosovës gjate vitit 2023 dhe janë rexhistruar ne SIMFK dhe si te tilla kalojnë ndarjet buxhetore për vitin 2033, dhe arsyeja e bartjes ne shpenzimin përkatës qëndron ne faktin se tani me Komuna jonë ka disa projekte me bashkëfinancim me Ministritë tjera apo me konkretisht me Ministrin e Administrimit te Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Helvetas Swis Intercooperation (DEMOS) në projektet si:

1.“Asalltimi i rrugëve ne fshatrat Klinë, Polac, Makermal, Ticë, Kopiliq i Epërm, Rakinicë”

2. “Ndriçimi publik ne qytet dhe fshatra” dhe

3.” Pajisje te ‘Eko Natyrës’ ”

Ndarjet aktuale e këtij fondi janë të pamjaftueshme për bashkëfinancimin e këtyre projekteve.

DKA.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASAMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr.
No. 07-030/03-0032405/24
Data.
Data. 10.07.2024

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim** / Department of Education

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **10.07.2024** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Sekretarinë e Kuvendit Komunal**<br>**Komitetinë për Politikë dhe Financa** |
| **CC:** | **Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit Komunal** |
| **NGA/OD/FROM:** | **z. Kastriot Duraku – Drejtor i Arsimit** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit për periudhën Janar – Qershor 2024** |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna Skenderaj**
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim** / Department of Education

**Informatë**

**Për punët dhe detyrat e kryera gjatë periudhës janar - qershor 2024**

**Sektori i arsimit, financave dhe administratës**

Gjysmëvjetori i parë për vitin shkollor 2023-2024 ka mbaruar më 12 janar 2023. Drejtoria komunale e arsimit ka bërë analizën e suksesit të nxënësve për gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor.

Gjatë periudhës së pushimit dimëror janë bërë të gjitha përgatitjet higjieno-teknike për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë për vitin shkollor 2023-2024.

Gjysmëvjetori i dytë për vitin shkollor 2023-2024 ka filluar më 24 janar 2024. Me rastin e fillimit të gjysmëvjetorit të dytë, shkollat janë vizituar nga zyrtarët e DKA-së, për të parë së afërmi përgatitjet që janë bërë edhe nga shkollat për fillimin e këtij gjysmëvjetori.

Gjithashtu, shkollat e komunës sonë, janë vizituar vazhdimisht edhe nga Inspektorët e Arsimit në Mitrovicë, të cilët janë kujdesur për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor.

Ka vazhduar Vlerësimi i Performancës së shkollave nga Ekipi Vlerësues në nivel komunal, në kuadër të projektit KosEd, në shfmu"Shaban Jashari" Skënderaj, shfmu "Ahmet Delia" Skënderaj dhe "Abedin Rexha" në Turiçec.

Gjatë gjysmëvjetorit të dytë, zyrtarët e arsimit realizuan vizita nëpër të gjitha shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Qëllimi i vizitave ishte: mbarëvajtja e procesit mësimor, kontrollimi i ditarëve, i përgatitjeve me shkrim, i librave amë, i planeve të drejtorëve, pastërtisë etj.

"Dëshmorët e Qyqavicës"Qirez dhe "Ismet Uka"Ticë janë pajisur me mjete mësimore në vlerë prej 136,900.00 € për lëndët: fizikë, kimi, biologji, gjeografi, informatikë dhe matematikë.

Në muajin shkurt u realizua me sukses procesi i vlerësimit të dosjeve të rreth 60 – mësimdhënësve, të ndarë tri grupe të ndryshme, lidhur me implementimin dhe zbatimin në praktikë të Kurrikulës së re.

Me aktivitete të ndryshme dhe programe kulturo-artistike, në të gjitha shkollat e komunës sonë është kremtuar 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës.

Në muajin shkurt është bërë përurimi i bibliotekës në Gjimnazin"Hamëz Jashari" në Skënderaj dhe është pasuruar me tituj të shumtë librash.
Me ministrin e Zhvillimit Ekonomik kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit për ndërtimin e çerdhes publike afër IAAP"Anton Çetta". Me këtë marrëveshje u vendos që ky objekt i çerdhes të riformatohet në tërësi, duke respektuar standardet e pranueshme të ndërtimit dhe çdo aspekt arkitektonik për të bërë një punë të mirë nga e cila përfitues kryesor janë fëmijët e komunës sonë.

Në të gjitha shkollat e komunës së Skënderajt, janë mbajtur aktivitete në shumta për nder të Epopesë së Lavdishme të UÇK-së dhe 7 Marsit – Ditës së Mësuesit.

Gjithashtu, për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, Drejtoria e Arsimit ka organizuar një ceremoni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dhuratave për Veteranët e Arsimit, të cilët janë pensionuar gjatë vitit 2023-2024 dhe një takim të përbashkët me mësimdhënësit e të gjitha shkollave tona.

Në garën e XXV të fizikës 2024 në nivel shteti, të organizuar nga Shoqata Kosovare e Fizikës, morën pjesë nxënësit fitues të garës së fizikës në nivel komunal nga klasat e nënta, dhjeta, njëmbëdhjeta dhe dymbëdhjeta. Nxënësi i klasës së dhjetë, në Gjimnazin" Hamëz Jashari", Ariton Dragaj, zuri vendin e dytë në nivel shteti, ndërsa vendin e tretë në nivel shteti e zuri nxënësja e klasës së njëmbëdhjetë e po këtij gjimnazi, Jehona Nimanaj.

Në bashkëpunim me MAShTI dhe Federatën e Sportit shkollor të Republikës së Kosovës, për herë të dytë është realizuar programi njëjavor i skijimit "Drejt malit 2024". Pjesëmarrës ishin nxënësit e klasave të shtata të shfmu "Ahmet Delia" Skënderaj (30 nxënës) dhe të shfmu "Fehmi Rama" në Likoc (30 nxënës).

Vazhdimisht janë mbajtur ligjërata, takime dhe punëtori të ndryshme nga Qendra e Karrierës.

MAShTI në bashkëpunim me DKA – Skenderaj dhe gjimnazin "Hamëz Jashari" në Skënderaj, kanë organizuar "Java e informimit në gjimnaze për orientim në karrierë".

Është bërë planifikimi për regjistrimin e nxënësve në IP, klasë të para dhe të dhjeta.

Me 16 maj 2024, e përfunduan mësimin e rregullt nxënësit e klasave të dymbëdhjeta.

Gjatë muajit maj, janë mbajtur gara të ndryshme në nivel shkolle, komune dhe shteti. Në këto gara, nxënësit e komunës sonë treguan rezutate shumë të mira, duke zënë kështu vendet e para edhe në nivel shteti në lëndët: matematikë, gjuhë shqipe, gjuhë angleze, biologji dhe edukatë figurative. Këto gara janë mbajtur me nxënësit e klasave të katërta, të pesta, të teta dhe të njëmbëdhjeta të shkollave tona.

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Florida | Spahija | "Ahmet Delia" | Skënderaj | IV | I |
| 2 | Eduarta | Hasani | "Vëllezërit Frashëri" | Çubrel | IV | II |
| 3 | Gjin | Gjinovci | "Shaban Jashari" | Skënderaj | IV | III |

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Pikët |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rron | Rushiti | "Shaban Jashari" | Skënderaj | V | I |
| 2 | Lira | Thaçi | "Abedin Rexha" | Turiçec | V | II |
| 3 | Tuana | Bajra | "Ahmet Delia" | Skënderaj | V | II |
| 4 | Era | Lushtaku | "Shaban Jashari" | Skënderaj | V | III |

Sqarim: Vendin e dytë e ndajnë dy nxënëse, për shkak të rezultatit të barabartë në pikë.

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Suela | Dervishaj | "Shotë Galica" | Runik | VIII | I |
| 2 | Adnan | Ferizi | "Azem Bejta" | Prekaz i Epërm | VIII | II |
| 3 | Elsa | Qerimi | "Shaban Jashari" | Skënderaj | VIII | III |

Më të dalluarit nga klasat e njëmbëdhjeta në lëndën e gjuhës shqipe janë:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Ledion | Ahmeti | "Ismet Uka" | Ticë | IV | III |

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e matematikës janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Amra | Dajaku | "Halit Geci" | Llaushë | V | I |
| 2 | Mirvjen | Mehmeti | "Shaban Jashari" | Skënderaj | V | II |
| 3 | Dëborë | Maliqi | "Ahmet Delia" | Skënderaj | V | III |

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e matematikës janë:

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultatet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Altin | Geci | "Ahmet Delia" | Skënderaj | VIII | I |
| 2 | Suhela | Thaçi | "Ahmet Delia" | Skënderaj | VIII | II |
| 3 | Vlera | Zabeli | "Shaban Jashari" | Skënderaj | VIII | III |
| 4 | Suela | Spahiu | "Ahmet Delia" | Skënderaj | VIII | III |

Sqarim:Vendin e tretë e ndajnë dy nxënëse, për shkak të rezultatit të barabartë në pikë.

Më të dalluarit nga klasat e katërta në lëndën e edukatës figurative janë:

Pikturë

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Diar | Bajraj | "Shotë Galica" | Runik | IV | I |
| 2 | Denis | Gjinovci | "Elena Gjika" | Makërmal | IV | II |
| 3 | Enuara | Gashi | "Ahmet Delia" | Skënderaj | IV | III |

Vizatim

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tijara | Nuradini | "Ahmet Delia" | Skënderaj | IV | I |
| 2 | Erblin | Mecini | "Idriz Barani" | Klinë e Epërme | IV | II |
| 3 | Ensar | Maksuti | "Enver Haliti" | Lubavec | IV | III |

Më të dalluarit nga klasat e pesta në lëndën e edukatës figurative janë:

Pikturë

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dion | Koca | "Drenica" | Polac | V | I |
| 2 | Mentor | Tahiraj | "Ahmet Delia" | Skënderaj | V | II |
| 3 | Era | Lushtaku | "Shaban Jashari" | Skënderaj | V | III |

Vizatim

| Nr. | Emri | Mbiemri | Shkolla | Vendi | Klasa | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Isuf | Koca | "Drenica" | Polac | V | I |
| 2 | Ari | Fazliu | "Ahmet Delia" | Skënderaj | V | II |
| 3 | Suela | Beka | "Idriz Barani" | Klinë e Epërme | V | III |

Më të dalluarit nga klasat e teta në lëndën e edukatës figurative janë:

Me 06 qershor 2024, e përfunduan mësimin e rregullt nxënësit e klasave të nënta, të dhjeta dhe të njëmbëdhjeta.

Si zakonisht, edhe sivjet kemi organizuar aktivitetin-shëtitjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, me një shëtitje të këtyre fëmijëve dhe aktivitete të shumta.

Në muajin qershor është mbajtur Testi i Maturës Shtetërore për nxënësit e klasave të XII-ta të shkollave të mesme të larta të komunës sonë. Testimit i janë nënshtruar rreth 402 – nxënës dhe kalueshmëria e këtij testi është 69.02 %.

Gjithashtu, gjatë muajit qershor është mbajtur Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta. Ky test është realizuar në dy ditë (25 dhe 28.06.2024) dhe i janë nënshtruar rreth 619 – nxënës.

Me aktivitete të ndryshme kulturo-artistike e sportive, në shkolla u shënua Dita e Çlirimit të Skënderajt.

Me 24 qershor 2024, e përfunduan mësimin e rregullt nxënësit e klasave 1 – 8, e të gjitha shkollave të komunës sonë.

Në kuadër të programit "Vlerësimi nga Kolegët" mekanizëm i krijuar nga Projekti e Bashkimit Evropian-KosED, u certifikuan mësimdhënësit dhe zyrtarët arsimorë, të cilët kanë qenë pjesë e vlerësimit në shkolla.

Bazuar në kërkesat e mësimdhënësve drejtuar Drejtorisë së Arsimit, zyra ligjore ka kryer këto punë administrative:
12 vendime për pushime të lehonisë,
3 vendime për pushim pa pagesë,
17 vendime për shkëputje të kontratës së punës ( pensionistë), si dhe
43 vendime të ndryshme të lëshuara nga Drejtoria e Arsimit, si ( vendime për shpallje të konkurseve, vendime për transfere të mësimdhënësve, vendime për ndarjen e subvencioneve, vendime për formime të komisioneve etj).
Po ashtu, zyra ligjore gjatë periudhës së parë të vitit 2024, ka bërë 23 kërkesa të ndryshme, si ( kërkesa për MASHT, kërkesa për zyrën e kryetarit, kërkesa zyrës së prokurimit për zhvillimin e procedurave të tenderimit, etj).

Drejtoria e Arsimit në Skenderaj, në fund të çdo viti mësimor bën vlerësim të përgjithshëm të ecurisë dhe performancës së procesit edukativo-arsimor për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet e përgjithshme dhe duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

## Suksesi i nxënësve për vitin shkollor 2023/24 në arsimin fillor (1-5) në Komunën e Skenderajt

Në arsimin fillor **(klasa 1-5)** nga raportet e shkollave fillore për suksesin e nxënësve për vitin shkollor **2023/24** shihet se në **23** shkolla fillore të Komunës së Skenderajt, në përfundim të gjysmëvjetorit të dytë me sukses janë **2965** nxënës.

## Numri i nxënësve në arsimin fillor sipas klasave

- Në klasën e parë **(I)** janë të regjistruar **563** nxënës
- Në klasën e dytë **(II)** janë të regjistruar **570** nxënës
- Në klasën e tretë **(III)** janë të regjistruar **611** nxënës
- Në klasën e katërt **(IV)** janë të regjistruar **600** nxënës
- Në klasën e pestë **(V)** janë të regjistruar **621** nxënës

**Pra, në arsimin fillor prej klasës I-V janë të regjistruar 2965 nxënës**

## Suksesi i nxënësve në arsimin fillor për vitin shkollor 2023/24

### Prej nxënësve të vlerësuar:

| |
|---|
| **2,329** nxënës ose **74.50 %** janë me sukses të **shkëlqyeshëm** |
| **437** nxënës ose **15.80 %** janë me sukses të **shumë mirë** |
| **218** nxënës ose **7.00 %** janë me sukses të **mirë** |
| **65** nxënës ose **2,10 %** janë me sukses të **mjaftueshëm** |
| **Gjithsej me sukses kalues janë 2925 nxënës ose 99.45%.** |
| **40** nxënës ose **0.55 % janë të panotuar** |

**Nota mesatare e klasëve**

| | |
|---|---|
| **Klasa e I** | **(4.75)** |
| **Klasa e II** | **(4.64)** |
| **Klasa e III** | **(4.62)** |
| **Klasa e IV** | **(4.58)** |
| **Klasa e V** | **(4.54)** |
| **Nota mesatare e nivelit I-V** | **(4.63)** |

## Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2023/24 në arsimin e mesëm të ulët në Komunën e Skenderajt

Në arsimin e mesëm të ulët ( **klasa 6-9** ) nga raportet e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta për suksesin dhe mungesat e nxënësve për vitin shkollor **2023/24**, shihet se në **23** shkolla fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Skenderajt, në përfundim të gjysmëvjetorit të dytë me sukses janë **2,606** nxënës.

## Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët sipas klasëve

- Në klasën e gjashtë **(VI)** janë të regjistruar **672** nxënës
- Në klasën e shtatë **(VII)** janë të regjistruar **670** nxënës
- Në klasën e tetë **(VIII)** janë të regjistruar **643** nxënës
- Në klasën e nëntë **(IX)** janë të regjistruar **621** nxënës

**Pra, në arsimin e mesëm të ulët prej klasës VI-IX janë të regjistruar 2606 nxënës.**

## Suksesi i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2023/24

Suksesi i nxënësve pozitiv, negativ dhe të panotuar në nivelin e mesëm të ulët për gjysmëvjetorin e dytë të vitit 2023-2024.

### Prej nxënësve të vlerësuar:

| |
|---|
| **465** nxënës ose **18.2 %** janë me sukses të **shkëlqyeshëm** |
| **761** nxënës ose **28.10%** janë me sukses të **shumë mirë** |
| **879** nxënës ose **34.80 %** janë me sukses të **mirë** |
| **215** nxënës ose **8.00 %** janë me sukses të **mjaftueshëm** |
| **Gjithsej me sukses pozitiv janë 2,320 nxënës ose 89.10%.** |
| **268** nxënës ose **10.23 %** janë më nga **një, dy, tri (notë të dobët)** |
| **18** nxënës ose **0.67 %** **janë të panotuar** |

### Nota mesatare e klasëve

| | |
|---|---|
| **Klasa e VI** | (4.08) |
| **Klasa e VII** | (3.58) |
| **Klasa e VIII** | (3.60) |
| **Klasa e IX** | (3.45) |
| **Nota mesatare e nivelit VI-IX** | (3.68) |

## Suksesi i nxënësve në gjysmëvjetorin e dytë, 2023/2024 në arsimin e mesëm të lartë

Në arsimin e mesëm të lartë ( **klasa X-XII)** nga raportet e shkollave të mesme të larta për suksesin e nxënësve për vitin shkollor **2023/24** shihet se në tri **(3)** shkollat e mesme të Komunës së Skenderajt, numri i nxënësve është **1849**.

**Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas klasave është si vijon:**

- Në klasën e dhjetë (**X**) kanë vijuar mësimin 615 nxënës
- Në klasën e njëmbëdhjetë **(XI)** kanë vijuar mësimin 600 nxënës
- Në klasën e dymbëdhjetë (**XII**) kanë vijuar mësimin 634 nxënës

**Në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2023/2024, suksesi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë është si vijon:**

**Prej nxënësve të vlerësuar në gjysmëvjetorin e dytë:**

| |
|---|
| **584** nxënës ose **22.60 %** janë me sukses të **shkëlqyeshëm** |
| **398** nxënës ose **18.54 %** janë me sukses të **shumë mirë** |
| **352** nxënës ose **14.77 %** janë me sukses të **mirë** |
| **98** nxënës ose **3.08 %** janë me sukses të **mjaftueshëm** |
| Gjithsej me sukses pozitiv janë 1432 nxënës ose 77.44 % |
| 97 nxënës ose 8.27 % janë me nga **një notë të dobët** |
| **119** nxënës ose **10.48 %** janë me nga **dy nota dobëta** |
| **125** nxënës ose **18.35 %** janë me nga **tri e më shumë nota dobëta** |
| Gjithsej me sukses negativ janë 341 nxënës ose 18.44 % |
| **76** nxënës ose **4.12 %** **janë të panotuar** |

Në arsimin e mesëm të lartë (**X-XII**) në mbarim të gjysmëvjetorit të dytë prej **1910** nxënësve:

| | | |
|---|---|---|
| | Femër | 320 |
| | **Gjithsej** | **643** |
| Klasa 9 | Mashkull | 305 |
| | Femër | 316 |
| | **Gjithsej** | **621** |
| Klasa 10 | Mashkull | 343 |
| | Femër | 272 |
| | **Gjithsej** | **615** |
| Klasa 11 | Mashkull | 314 |
| | Femër | 286 |
| | **Gjithsej** | **600** |
| Klasa 12 | Mashkull | 327 |
| | Femër | 307 |
| | **Gjithsej** | **634** |
| **Gjithsej** | | **8087** |

| **Gjinia** | **Skenderaj** |
|---|---|
| Mashkull | 4131 |
| Femër | 3956 |
| **Gjithsej** | **8087** |

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL SKENDERAJ OPŠTINA SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.
No. 13-052/01-0034181/24
Data.
Data. 22.07.2024

**Republika e Kosovës**/ Republika Kosova/ Republic of Kosova

**Komuna Skenderaj**/ Opština Skenderaj/ Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Inspekcion**/ Direkcija za inspekciju/ Directorate for Inspection

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 22/07/2024 |
| PËR/ZA/TO: | Sekretaria e Kuvendit Komunal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | Arkivit |
| NGA/OD/FROM | Drejtor i Inspekcionit: Valon Haliti |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT- | Informatë Pune për Periudhën Janar – Qershor 2024 |

# INFORMATË PUNE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2024

Drejtoria për Inspekcion për zbatimin e planit vjetor të punës për vitin 2024, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që ka për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve relevante, gjatë periudhës janar - qershor në të gjitha fushat që mbulon ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme më qëllim të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave që ka kjo drejtori.

Prioritetet kryesore të drejtorisë gjatë këtij gjashtë mujori ishin: mbrojtja e shëndetit të qytetarëve nga produktet jo të sigurta për konsum, mbrojtja nga praktikat mashtruese tregtare, qasja e papenguar në hapësira publike dhe ruajtja e tyre, transporti i sigurt, rritja e sigurisë në trafik, mjedisi i pastër, mbrojtja nga degradimi urban, etj. Aktivitetet për secilën fushë që janë realizuar në kuadër të kësaj drejtorie janë përshkruar si në vijim.

**Gjithsej në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 janë shqyrtuar 182 lëndë. 156 lëndë janë miratuar, 13 lëndë janë refuzuar dhe 13 lëndë janë në proces.**

## FUSHA E TREGUT

Duke u bazuar në:

- LIGJIN NR. 03/L-181 PËR INSPEKTORATIN DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT
- LIGJI NR. 04/L-078 PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE
- LIGJI Nr. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT
- LIGJI NR. 2004/18 PËR TREGTINË E BRENDSHME
- RREGULLORET KOMUNALE

Inspektorët e tregut kanë realizuar këto aktivitete:

☑ Janë inspektuar operatorët që merren me shitjen e produkteve ushqimore, furrat dhe shitësit e derivateve.

☑ Janë inspektuar 156 biznese, ndër të cilat janë dhënë 62 vërejtje me procesverbal për parregullsitë e hasura, para shqiptimit të masave ndëshkimore. Gjatë vitit 2024 janë regjistruar 48 biznese të reja. Për plotësimin e kushteve minimale teknike janë shqyrtuar 10 kërkesa, gjashtë prej tyre janë pajisur me pëlqim, katër kërkesa janë refuzuar dhe pesë kërkesa janë në procedurë.

☑ Për produkte jo të sigurta, të dëmtuara, me afat të skadimit si dhe pa deklaracion, si dhe mashtrimi në peshë dhe mospërputhja çmim-arkë janë pranuar nëntë ankesa nga konsumatorët të cilat janë shqyrtuar me korrektësi. Në nëntë raste të ankesave kemi marrë masa ndëshkimore ku janë shqiptuar gjoba në vlerë: 8 x 400€, 1 x 500€.

☑ Janë konfiskuar 820 produkte ushqimore jo të sigurta për konsum, të dëmtuara pa deklaracion dhe me afat të skaduar në peshën prej 112.0 kg si dhe në vlerë 913, 53 €. Këto produkte janë të klasifikuara si:

- Produkte të mishit: qofte 3 kg, suxhuk 6.789 kg, mish i tharë 8.800 kg. Gjithsej 18.800 kg në vlerë totale 118.79 €.
- Pije alkoolike dhe joalkoolike .
- Produkte ushqimore si keksë, ëmbëlsirë, hurma.
- Janë larguar nga tregu (shitja ) edhe 186 produkte jo ushqimore të dëmtuara dhe me afat të skaduar (kozmetikë, detergjent, shampon ).

- Janë konfiskuar 83 pako cigare në vlerë prej 205,80 €uro pas ankesave të prindërve për shitje të cigareve të miturve afër shkollës, këto subjekte po ashtu nuk kanë prezantuar faturë. Këto produkte janë asgjësuar nga K.R.M. "Uniteti" Skenderaj.

☑ Në bashkëpunim me zyrtarët policor janë mbyllur pesë bastore sportive të cilat operonin në mënyrë ilegale.

☑ Pas afateve të dhëna me procesverbale dhe vërejtjeve, ata të cilët nuk i kanë evituar ato, pas ankesave të pranuara nga konsumatorët dhe me inspektimeve të shitësve ambulativ, në bashkëpunim me zyrtarët policorë janë lëshuar 24 gjoba mandatore, në shumën prej 8800.00 €.

☑ Kemi zbatuar vendimin nr. 1120/01 nga MTI për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës.

☑ Prioritet tjetër ka qenë dhe do të jetë luftimi i informalitetit (tregtia në të zezë), si dhe angazhimi në shërbim të qytetarëve edhe jashtë orarit zyrtar si vikendeve ashtu edhe gjatë festave. Kemi bërë thirrje për qytetarët që në rast të parregullsive të lajmërohen në zyrën e drejtorisë apo të kontaktojnë në nr. e telefonit 0800-1100 në kuadër të MTI-së në Prishtinë.

Janë shqiptuar këto gjoba për subjektet e më poshtme:

- Për shitje të produkteve të duhanit personave nën moshën 18 vjeç janë shqiptuar tri gjoba.

- Për mos respektim të orarit të punës – mos zbatim të Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës është shqiptuar një gjobë.

- Për produkte ushqimore janë shqiptuar pesë gjoba, pas ankesave të qytetarëve për produkte me afat të skaduar dhe pa deklaracion.
- Për mashtrime me çmime janë shqiptuar tetë gjoba, pas ankesave të qytetarëve për mospërputhje të çmimit raftë – arkë.

- Për lokale që punojnë pa u regjistruar në ARBK, janë shqiptuar katëe gjoba, pas ankesave të bizneseve që i kryejnë të gjitha obligimet.
- Për shitës ambulativ janë shqiptuar katër gjoba si shkak i shitjes së produkteve jo të sigurta dhe pa fatura nga operatorët.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e tregut gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktiviteti i inspektorit* | *Nr. i aktiviteteve* | |
|---|---|---|
| ***Vizita në biznese*** | *156* | |
| ***Vërejtje për biznese*** | *62* | |
| ***Biznese të reja (pas vërejtjeve)*** | *48* | |
| ***Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave*** | *10 K. 11 A.* | |
| ***Fletëparaqitje në gjykatë - Kërkesa të përmbaruesi*** | *Nuk ka* | |
| ***Gjoba të shqiptuara*** | *24* | *8800,00 €* |

## FUSHA E KOMUNIKACIONIT

Duke u bazuar në:

- LIGJIN NR. 04/L-170 PËR TRANSPORTIN RRUGOR
- RREGULLOREN PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SKENDERAJT NR.1-110-32837
- RREGULLORE PËR AUTO-TAKSI, TRANSPORT TË UDHËTARËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SKENDERAJT NR. 1-110/32825
- RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA, MGARKESA DHE GJOBA, KOMUNA SKENDERAJ NR.01-110/01-0025382/22
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MI) NR 09/2017 PËR SINJALIZIM DHE RREGULLAT E TRAFIKUT RRUGOR

☑ Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 14 procesverbale, nga të cilat dhjetë kanë qenë kërkesa të shqyrtuara, nëntë janë aprovuar si dhe një është refuzuar.

☑ Kemi punuar në transportin publik ku kemi bërë kontrolle operatorëve ekonomik të transportit publik ndaj të cilëve janë shqiptuar 10 gjoba:

- Është shqiptuar një gjobë në vlerë 100€ për mosrespektim të rendit të udhëtimit.
- Janë shqiptuar katër gjoba në vlerë 100 euro ndaj kombi-taksive ilegale të cilët janë hasur duke bartur udhëtar pa leje pune.
- Katër gjoba në vlerë 100 euro janë shqiptuar ndaj auto-taksive pa leje pune.
- Një gjobë në vlerë 100 euro është shqiptuar për mos prezantim të certifikatës së verifikimit të taxi metrit. Të gjitha aktivitetet në transportin publik janë realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

☑ Transporti publik mbulohet nga 11 operator transportues të licencuar nga MI dhe të pajisur me rende të udhëtimit nga Drejtoria për Shërbime Publike si dhe 11 auto-taksi dhe dy radio-taksi me pesë automjete. Më poshtë në formë tabelare janë paraqitur rendet e udhëtimit në linjat urbano-periferike, operatorët, datat e marrjes dhe datat e skadimit për secilin operatorë.

| Nr. | Rendet e Udhëtimit në Transport Lokal | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Memi Bus SH.P.K | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Sami Hoxha |
| 2 | Memi Travel SH.P.K | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Kujtim Hoxha |
| 3 | N.T.SH. Vëllëzrit Rrustemi | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Valon Rrustemi |
| 4 | N.T.P. Vëllëzrit Ferizi | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Arsim Ferizi |
| 5 | N.T.SH Balli Trans | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Beqir Shala |
| 6 | Arta Tours SH.P.K | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Mexhit Smajli |
| 7 | N.P.T Fationi Bus | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Hamit Fetahu |
| 8 | Joni Travel SH.P.K | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Avni Ademi |
| 9 | N.T. Zekaj Turs | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Faton Veliqi |
| 10 | Ismajl Ahmeti B.I. | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Ismajl Ahmeti |
| 11 | Zeqa Tours Sh.P.K | 18.03.2024 | 18.03.2027 | Zeqir Syla |

***Operatorët Auto-Taksi dhe Radio-Taksi të cilët kanë pëlqim për ushtrimin e kësaj veprimtarie janë:***

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Data e lëshimit | Data e skadimit |
|---|---|---|---|
| 1 | Gëzim Zena | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 2 | Ramiz Osmani | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 3 | Bekim Malaj | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 4 | Visar Behramaj | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 5 | Ismet Maloku | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 6 | Afrim Gjinofci | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 7 | Tafil Ahmeti | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 8 | Smajli Meha | 05.03.2024 | 05.03.2029 |
| 9 | Blerim Sadiku | 05.03.2024 | 05.03.2029 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| *10* | *Xhevdet Spahiu* | *05.03.2024* | *05.03.2029* |
| *11* | *Sefedin Hasanaj* | *14.05.2024* | *15.05.2029* |
| *12* | *Isa Rushiti – Radio Taxi* | *05.03.2024* | *05.03.2029* |
| *13* | *Endrit Lushtaku – Radio Taxi* | *05.03.2024* | *05.03.2029* |

***Gjithashtu kemi punuar në sinjalizimin vertikal dhe horizontal ku kemi bërë vendosjen e këtyre shënjave:***

| *Nr.* | *Përshkrimi* | *Njesia* | *Sasia* |
|---|---|---|---|
| *1* | *Furnizimi me shënja të komunikacionit nga alumini me foli reflektuse 3M me trashësi 2 mm me ram 600X600X600* | *copë* | *26* |
| *2* | *Furnizimi me shtylla të zinguara Ø60 3m të gjata, betonimi dhe thellësia 40X40X50* | *copë* | *34* |
| *3* | *Tërheqja e zebrave njëkomponentëshe* | *$m^2$* | *850.92* |
| *4* | *Vija horizontale 15 cm gjerësi me ngjyrë njëkomponëntëshe* | *$m^1$* | *1965* |
| *5* | *Pasqyre në rrugë* | *copë* | *8* |

- ☑ Sinjalizimin horizontal e kemi punuar në rrugët e qytetit, konkretisht vijën gjatësore dhe vendkalimet e këmbësoreve. Këto punime janë realizuar pas orarit të rregullt të punës-gjatë natës në mënyrë që të mos ketë pengesa nga automjetet.

- ☑ Janë sinjalizuar me sinjalizim vertikal rrugët e qytetit dhe të fshatrave si Prekaz i Poshtëm, Vajnikë, Kopiliq i Epërm dhe Rezallë.

- ☑ Kemi adresuar një shkresë në Ministri të Infrastrukturës për rregullimin e sinjalistikës ndriçuese - semaforëve në rr. Azem Bejta si dhe vendosjen e disa shiritave vibrues në këtë rrugë në mënyrë qe nxënësit të cilët lëvizin në këtë pjesë të rrugës mos te rrezikohen nga ngasësit e automjeteve. Ministria është përgjigjur pozitivisht për realizimin e këtyre kërkesave.

☑ Kemi punuar në komisione për performancë komunale në hartimin e raporteve në fushat e transportit publik dhe hapësirave publike, hartimin e draft planit për transportin publik si dhe në komision për hartimin e rregullores komunale për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve me automerimangë.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e komunikacionit gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktiviteti i inspektorit* | *Nr.* |
|---|---|
| ***Procesverbale*** | *14* |
| ***Lënd të shqyrtuara*** | *10* |
| ***Gjoba*** | *10* |

## FUSHA E MBROJTJES SË MJEDISIT

Gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar aktivitete inspektuese, mbikëqyrëse dhe vlerësuese duke u bazuara në ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale për mbrojtjen e mjedisit siç janë:

- LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
- LIGJI NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH NR. 01/2017 PËR DHËNIEN E LEJES MJEDISORE KOMUNALE
- RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E SKENDERAJT
- RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA - KOMUNA SKENDERAJ
- RREGULLORE KOMUNALE PËR SHËRBIME PUBLIKE

Rëndësi të veçantë ka pasur monitorimi dhe inspektimi në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planit të punës si:

☑ Është bërë shqyrtimi i 35 kërkesave të qytetarëve dhe evidentimi i 15 rasteve gjatë inspektimeve në terren për problemet në rrjet të kanalizimit, bllokimit, rrjedhjes së ujërave të zeza, mungesës së rrjetit, dëmtimit të pusetave dhe shkaktimit të ndotjes nga këta faktorë. Rastet e evidentuara me procesverbale janë drejtuar në Drejtori për Shërbime Publike dhe në Drejtori të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, ku deri tani është intervenuar në 10 raste nga totali i raportuar nga Drejtoria e Inspekcionit.

☑ Evidentimi i pesë deponive ilegale të mbeturinave të cilat janë hasur gjatë inspektimeve në terren në zona urbane, në breze rrugore, parqe, rrjedha ujore të lumenjve dhe përroskave dhe në komplekse pyjore. Këto raste janë raportuar në Drejtorinë për Shërbime Publike, ku janë eliminuar tri deponi ilegale të mbeturinave prej numrit total të raportuara nga Drejtoria e Inspekcionit dhe janë vendosur tabela sinjalizuese. Në tri raste për hedhje të mbeturinave jashtë vendeve të caktuara personat përgjegjës janë gjobitur.

☑ Mbikëqyrja e pesë lejeve mjedisore komunale për veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës të pranuara nga DUMA në vitin 2024, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i lejeve mjedisore të lëshuara në vitin paraprak.

- ☑ Mbikëqyrja e deponisë për materiale ndërtimore inerte në "Dell" të Qirezit dhe mbikëqyrja e menaxhimit të mbeturinave nga KRM 'UNITETI' dhe e aktiviteteve të pastrimit të NPL 'Eko Natyra' Sh. A.

- ☑ Aktivitete inspektuese për ruajtjen e mjediseve urbane dhe e peizazhit natyror brenda, në periferi e ndërmjet qendrave banuese, si rrugët trotuaret, mjediset e përbashkëta në lagjet e banimit, mjediset e gjelbëruara, parqet periferike.

- ☑ Janë lëshuar 23 urdhëresa për bizneset e evidentuara që nuk kanë qenë në shërbim që të lidhin kontratë tek operatori për menaxhim të mbeturinave.

- ☑ Bazuar në Ligjin nr. 08/l-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për Mbeturina dhe në Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba në Skenderaj janë shqiptuar 28 gjoba:

  - Për hedhje të mbeturinave komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale është shqiptuar një gjobë në vlerë 200 euro.

  - Për hedhje të broshurave jashtë vendeve të përcaktuara nga komuna janë shqiptuar dy gjoba në vlerë 200 euro.

  - Në vlerë 500 euro është shqiptuar një gjobë për hedhje të mbeturinave nga materialit inerte në brigje të lumit. Për hedhje të mbeturinave nga materialet ndërtimore jashtë vendeve të caktuara janë shqiptuara katër gjoba, tri gjoba në vlerë 200 euro dhe një gjobë në vlerë 90 euro. Në vlerë 70 euro është shqiptuar një gjobë për hedhje të mbeturinave inerte nga ballkoni i objektit.

  - Për dëmtim të hapësirës publike, mos kthim në gjendje të mëparshme të dëmeve të shkaktuar është shqiptuar një gjobë në vlerë 500 euro si dhe një gjobë në vlerë 150 euro është shqiptuar për rrjedhje të ujërave fekale nga ferma e bagëtive në pronë private.

- Për dëmtim të drunjtëve dekorativ në hapësirë publike janë shqiptuar katër gjoba në vlerë 200 euro.

- Në vlerë 100 euro për kalim dhe parkim në hapësira të gjelbra publike janë shqiptuar 12 gjoba si dhe për djegie të mbeturinave të përziera është shqiptuar një gjobë në vlerë 100 euro.

☑ Angazhimi në mbikëqyrjen e kontratës “Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit në Komunën e Skenderajt”.

☑ Inspektimi i fabrikave në periferi të qytetit për të monitoruar ndikimin e tyre në mjedis si Weng Fat Poultry në Polac, Ferma e Pulave Drini në Marinë.

☑ Janë evidentuar dy raste për dëmtim të drunjëve dekorativ në rr. 17 Shkurti. Në njërin rast është bërë zëvendësimi i drurit të dëmtuar kurse në rastin tjetër për mospërfillje të urdhëresës për sanim të dëmit të shkaktuar, personi juridik që ka dëmtuar drunjtë dekorativ është gjobitur.

☑ Në mungesë të inspektorit të shërbimeve publike janë ndërmarre veprime për mbrojtje të hapësirave publike si: aksioni për largimin e mallrave në bulevardin "Ilaz Kodra" dhe aksioni për pengimin e shitjes ambulative në trotuare, largimi i bllokuesve nga hapësirat publike të shndërruara në parkingje nga biznese të caktuara si dhe largimi i reklamave të vendosura pa leje.

☑ Janë shpërndarë urdhëresa për operatorët ekonomik për tu pajisur me leje për reklamat e vendosura para hapësirave të lokaleve ku zhvillojnë veprimtarinë dhe urdhëresa për ti marrë në shfrytëzim hapësirat publike të cilat i shfrytëzojnë.

☑ Mbikëqyrja e rrjetit të ndriçimit publik, e kyçjeve në rrjetin e kanalizimit, ujësjellësit dhe shërbimeve tjera komunale. Janë evidentuar dy raste gjatë inspektimeve në terren për dëmtim të pusetave ku njëra prej tyre është rregulluar, një rast për probleme me rrjetin e ujësjellësit, tri raste për uzurpim të hapësirave publike ndër të cilat edhe mbyllja e një lokali si dhe nëntë raste për dëmtim të pronës publike dhe private. Këto raste janë

shqyrtuar në bashkëpunim me organet kompetente që trajtojnë natyrat e këtyre parregullsive.

*Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e mbrojtjes së mjedisit gjatë kësaj periudhe kohore:*

| *Aktivitetet* | *Nr. i aktiviteteve* |
|---|---|
| *Procesverbale* | *43* |
| *Kërkesa të qytetarëve/Lëndë* | *35* |
| *Njoftime zyrtare* | *3* |
| *Urdhëresa* | *70* |
| *Gjoba mandatore* | *28* |
| *Fillimi i procedurës për kundërvajtje – Masë përmbarimore* | *0* |

## FUSHA E NDËRTIMIT

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë evidentuar:

- ☑ Rrënimi i objekteve të banimit – shtëpi në rr. Gjergj Fishta dhe rrënimi i dy objekteve në rr. 28 Nëntori, Skenderaj.
- ☑ Largimi i dy objekteve montuese dhe i një shtëpie në rr. Ilaz Kodra.
- ☑ Shqiptimi i një gjobe në vlerë 5000 euro ndaj operatorit "Andrra" SH.P.K Prishtinë.

***Paraqitja tabelare e punëve të kryera në fushën e ndërtimit gjatë kësaj periudhe kohore:***

| *Aktiviteti i inspektorit* | *Objekte banimi + Afariste* | *Objekte banimi pa leje ndërtimi* | *Objekte me leje ndërtimi* | *Objekte garazh* | *Anekse* |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Nr. i inspektimeve*** | ***98*** | ***6*** | ***14*** | - | - |
| ***Procescerbale, aktvendime, vendime për rrënim*** | ***98*** | ***6*** | - | | - |
| ***Vërejtje/Urdhëresa*** | ***21*** | - | - | - | - |
| ***Kërkesa*** | ***81*** | - | - | | - |
| ***Rrënimet*** | ***5*** | - | - | | - |

## ANGAZHIMI I INSPEKTORËVE JASHTË ORARIT TË RREGULLT TË PUNËS

Inspektorët e profileve të ndryshme varësisht nga natyrat e aktiviteteve janë angazhuar edhe jashtë orarit zyrtar, gjatë vikendeve dhe festave zyrtare për:

- Shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve dhe ftesave të zyrtarëve policor për mbyllje të lokaleve që ushtrojnë veprimtari pa leje pune.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullore Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës.
- Mbikëqyrjen e sinjalizimit horizontal në rrugët e qytetit, konkretisht vijës gjatësore dhe vendkalimeve e këmbësoreve gjatë natës në mënyrë që të mos këtë pengesa nga automjetet.
- Kontrolle inspektuese në transportin publik.
- Intervenimi në rasteve të zjarrvënieve dhe hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara.
- Mbikëqyrjen e zhvillimit të aktiviteteve ndërtimore në zona ndërtuese.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPSTINA OPSTINA
SKENDERAJ

| Pranuar / Primljeno | 19.07.2024 | | |
|---|---|---|---|
| Njësi.org. / Org. jed. | Numri / Broj | Shtojca / Prilog | Vlera / Vrednost |
| 01-052 | 01- | 003412 | 6/24 |

| | |
|---|---|
| Për: | Kuvendin Komunal të Skenderajt |
| Nga: | Anëtarët e Komisionit te Aksionerve |
| Lënda: | Raport i rregullt vjetorë për vitin 2023 |
| Datë: | 18/07/2024 |

Të nderuar anëtare të Kuvendit Komunal të Skenderajt , ne antaret e komisionit të aksionevere të kumunes se Skenderaj kemi perpiluar një raport të shkoqitur në disa faqe duke marr parasysh edhe miratimin e planit të punes nga ana e Bordit të Nderrmarrjes “ UNITETI “
Ashtu edhe qysh e do rendi ne kemi marr perasysh gjithe angazhimin e akterve te kesaj ndermarrje regjionale e cila operon edhe në komunen e Skenderajt .

Të nderuar :

Na lejoni të ju drejtohemi përmes këtij raporti, fillimisht përmes një historiku të shkurtër rreth kompanisë.

KRM “UNITETI” SH.A Mitrovicë operon që pas luftës së dytë botërore, fillimisht nën emrin “Standard” deri në luftën e fundit të vitit 1998/99 dhe që nga paslufta me emrin Uniteti. Ashtu si cdo aktivitet shoqëror e ekonomik që është afektuar dhe dëmtuar shumë ngalufta, këtijë fati nuk i ka shpëtuar as Standardi tash Uniteti.

Pas përfundimit të luftes, me saktësishtë me 27 Qershor 1999, ish puntorët janë ftuar nga kryetari i asaj kohe, i ndjeri Dr. Bajram Rexhepi dhe ju është kërkuar që të mobilizohen si staf dhe me makinerinë që ka shpëtuar ta fillojnë punën në menaxhimin e mbeturinave fillimisht në bazë vullnetare. Në fillim me 47 ish puntorë të Standardit, nën administrimin e UNMIKUT është krijuar entiteti me emrin KRM UNITETI SH.A me aksionarin më të madhë Kuvendin Komunal të Komunës së Mitrovicës me 61.4% e pasuar nga ajo e Vushtrisë me 28.6% dhe ajo e Skenderajt me 10% të aksioneve.

Ndërmarrja KRM UNITETI është themeluar sipas ligjit mbi shoqërit tregtare përkatësisht Ligjit Nr.06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik, duke qene ndërmarrje publike pra me kapital publik i nënshtrohet edhe kërkesave ligjore që derivojnë nga Ligji Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike. Ndërmarrja ka Menaxhmetin e lartë që përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv, Zyretari Kryesor Financiarë dhe Sekretari/ja e Koorporatës, këta të fundit emërohen dhe shkarkohen nga Bordi i Drejtorëve, e ky

i fundit nga Komisionet komunale të aksionerëve respektivisht ata të Mitrovicës Vushtrisë dhe Skënderajt, në bazë të përqindjes së aksioneve Komuna e Mitrovicës ka dy anëtar të bordit të drejtorëve si dhe dy komunat tjera respektive nga një antarë, zyret qëndrore të kompanisë jane në Rr. Vëllezërit Dragaj pn Mitrovicë, gjithëashtu kompania ka edhe dy njësi punuese një në Vushtri dhe një në Skenderaj, poashtu kompania menaxhon edhe me Deponin që është në fshatin Gërmovë e cila është pronë e Kuvendit Komunal të Mitrovicës por që shfrytëzohet për deponimin e mbeturinave edhe të dy komunave tjera respektive aksionare.

Numri Unik Identifikues i kompanisë është 810547911 Nr i Biznesit 70465104.

Komisioni i Aksionerve

Miradije Buliqi

Besart Rrecaj

Ruzhdi Koca

| | |
|---|---|
| Për: | Bordin e Drejtorëve të KRM "Uniteti" Sh.A |
| Nga: | Gazmend Morina, Kryeshef Ekzekutiv,<br>KRM "Uniteti" Sh.A Mitrovicë |
| Lënda: | Raporti vjetor i punës për vitin 2023 |
| Datë: | 09.01.2024 |

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE KRM »UNITETI-SH.A« NJËSIA OPERATIVE SKENDERAJ

Të nderuar,

Duke u nisur nga veprimtaria biznesore e Kompanisë, njëri prej faktorëve i cili ndikon në mënyrë thelbësore në përmbushjen e detyrave dhe zhvillimin efikas të KRM "Uniteti" Sh.A, është potenciali njerëzor i cili është burimi kryesor dhe më meritor për menaxhim të suksesshëm. Me qëllim të organizimit efikas, funksional dhe efektiv për zhvillim të veprimtarisë, me plot përgjegjësi në përmbushjen e qëllimeve për realizimin e strategjisë zhvillimore, si Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Uniteti" Sh.A, kam vepruar me strukturë organizative në përputhshmëri me këto synime dhe qëllime strategjike.

**Struktura organizative e KRM "Uniteti" Sh.A në vitin 2023**

1. Njësia Punuese në Mitrovicë
2. Njësia Punuese në Vushtrri
3. Njësia Punuese në Skenderaj
4. Shërbimi Financiar
5. Shërbimi i Prokurimit
6. Shërbimi Juridik
7. Shërbimi i Administratës
8. Shërbimi i Personelit
9. Shërbimi i Faturimit, dhe
10. Shërbimi me Konsumatorë

Viti 2023, karakterizohet me një sërë veprimesh të ndërmarra duke arritur që me sukses të përmbushen aktivitetet primare në grumbullimin e mbeturinave, përfshirë edhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve sekondare në mirëmbajtjen e rrugëve në fshirje dhe larje, eliminimin e deponive ilegale, sikurse ajo në lagjen "Adem Voca", deponi ilegale tjera të krijuara në pjesë të ndryshme të qytetit, pastaj pastrimin e lumit Trepça nga mbeturinat, etj.

Në fillim të vitit 2023, nga të reshurat e shumta që kanë ndodhur më 19.01.2023, lumi Ibër dhe Lushta kanë dal nga shtrati dhe për pasojë janë shkaktuar vërshime në qytetin e Mitrovicës. Po ashtu, pasoja nga vërshimet janë shkaktuar edhe në qytetin e Skenderajt, me daljen nga shtrati të lumit Klina. Rrjedhimisht është pamundësuar zhvillimi i aktiviteteve të planifikuara.

Pas qetësimit të kësaj gjendjeje, Kompania është angazhuar maksimalisht dhe ka dalë në terren me punëtorët dhe makinerinë e saj për të gërryer, fshirë dhe larë çdo rrugë në mënyrë që qytetarëve të këtyre dy qyteteve t'u mundësohet qasja dhe lëvizja e lirë në hapësirat publike. Rrjedhimisht, dinamika e punëve të kompanisë është shtuar.

Po ashtu, dinamika e punës së kompanisë është ndikuar edhe nga trazirat të cilat kanë ndodhur në veri të vendit. Në Zveçan, Zubin Potok e Leposaviq, janë kryer punë shtesë nga Njësia Punuese në Mitrovicë e cila krahas aktiviteteve ditore të saj është mobilizuar me stafin e saj për të ofruar shërbime në zbrazjen e kontejnerëve, pastrimin e gurëve, barrikadave dhe mbeturinave tjera, fshirjen dhe larjen e rrugëve të cilat protestuesit i kanë hedh në hapësirat publike duke pamundësuar qasje të lirë.

Në këtë periudhë raportuese, ka vazhduar zbatimi i marrëveshjeve për shërbime primare në Menaxhimin e Mbeturinave të lidhura ndërmjet Kompanisë dhe dy komunave (Mitrovicë dhe Vushtrri), si dhe marrëveshja e lidhur me Policinë e Kosovës për ofrim të shërbimeve në pikat kufitare si në Bërnjak, Jarinje, si dhe në pikat tek Ura e Bistricës dhe tek pika në Koshtovë të Vllahisë. Vazhdon zbatimi i Marrëveshjeve për shërbime të veçanta të cilat kanë të bëjnë me eliminimin e deponive ilegale në hapësirat publike, qofshin ato në zonat urbane apo rurale e që përfshihen në territorin administrativ të Komunës së Mitrovicës dhe Skenderajt, si dhe marrëveshje tjera me vlera më të vogla.

Vlen të theksohet se nga muaji janar 2023, Kompania ka aplikuar tarifat e reja për shërbimet e ofruara në grumbullim të mbeturinave, tarifa këto të miratuara nga Asambletë Komunale të Vushtrrisë dhe Skenderajt, ndërsa në Mitrovicë, Kompania ka aplikuar tarifat e reja nga muaji maj.

Nga muaji shkurt 2023, punëtorëve fizikë, vozitësve të angazhuar në grumbullim të mbeturinave, punëtorëve të sigurimit, punëtorëve të garazhës në të gjitha profilet, inkasantëve si dhe kryepunëtorëve duke u bazuar në performancën të cilën e japin, u ngrit paga për 100.00 €

Si rezultat i performancës komunale, Kompania përkatësisht Njësia Punuese në Mitrovicë ka pranuar donacion nga Komuna e Mitrovicës dy kamion me kilometrazhe 0, dhe atë një kamion vetëngarkues të tipit Ford dhe një kamion kompaktor 8 m³ të tipit Iveco.

Formimi i komisioneve të ndryshme qofshin ato disiplinore, të ankesave dhe parashtresave, kontrolle e brendshme, etj. kanë përmbushë me sukses detyrat e veta. Njëherazi, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së Komisioneve, është vendosë që kohë pas kohe të ndryshohet përbërja e anëtarëve të këtyre Komisioneve.

Vlen të theksohet se efekti i kontrollës së brendshme është i rëndësisë së veçantë, duke ndikuar pozitivisht tek të gjitha ekipet punuese në terren dhe duke ndikuar në parandalim dhe evitim të çdo parregullsie të mundshme. Kjo për faktin se kontrollet janë bërë gjatë gjithë kohës pa paralajmërim në të gjitha ndërrimet dhe Njësitë Punuese të Kompanisë.

**Viti 2023, karakterizohet me një sërë kontratash me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale si:**

1. Sigurimi i automjeteve të KRM "Uniteti" Sh.A
2. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative
3. Kontrolle mjekësore dhe pajisje me certifikate mjekësore për punëtorët e KRM "Uniteti" Sh.A, dhe

4. Furnizim me pjesë rezervë për automjete
5. Mbulimi i deponisë
6. Furnizim me dy kamion kompaktorë
7. Furnizim me vajra motorike dhe lubrifikant për makineri të rëndë
8. Furnizim me mjete të punës
9. Rivlerësimi i riskut në vendin e punës, dhe
10. Furnizim me naftë

Për blerjet e parapara në kompani zbatohen procedurat e prokurimit të parapara me ligj, sa i përket zyrës së prokurimit viti 2023, është përmbyllë me **30 procedura** të prokurimit.

Komisionet e formuara për regjistrimin e bizneseve të reja dhe evidentimin e bizneseve të cilat nuk funksionojnë më, vazhdojnë t'i përmbushin detyrat e veta me sukses duke përcjellë gjendjen faktike në terren për të tri njësitë punuese, si rezultat i kësaj rrjedh se: në Mitrovicë janë vendosur në pasivë **46** biznese, në Vushtrri **34** biznese, ndërsa në Skenderaj **37** biznese, **në total në pasivë janë vendosur 117 biznese**.

Sa i përket regjistrimeve të reja, në Mitrovicë janë regjistruar **433** ekonomi familjare dhe **43** biznese, në Vushtrri janë regjistruar **25** biznese, ndërsa në Skenderaj janë regjistruar **575** ekonomi familjare dhe **38** biznese, që në total i bie **1008 ekonomi familjare dhe 106 biznese të reja**.

Në këtë periudhë raportuese, në procedurë tek përmbaruesi privat janë **1634** lëndë, prej tyre **273** lëndë janë të përfunduara, **29** lëndë janë në procedurë pranë gjykatave – në prapësim, derisa **1,361** lëndë janë në procedurë tek përmbaruesi privat. Ndërsa një (1) lëndë në procedurë penale është e përfunduar në favor të Kompanisë përmes procesit të ndërmjetësimit.

Sektori operativ është një prej sektorëve më të ndjeshëm në kompani dhe ballafaqohet me shumë sfida, sikur ka ndodhur në fillim të këtij viti me vërshimet në muajin janar, kur ky sektor përveç punëve ditore në grumbullimin e mbeturinave është mobilizuar dhe me shumë sukses ka përfunduar punët në gërryerje, fshirje dhe larje të të gjitha hapësirave të cilat u përmbytën në këtë periudhë. Përveç tjerash, përmbushja e punëve dhe detyrave operative është bërë me kapacitet të plotë duke mos lënë anash as eliminimet e deponive ilegale me theks të veçantë në lagjen e populluar nga komuniteti rom dhe deponi tjera ilegale të krijuara në pjesë të ndryshme të qytetit me rrethinë.

Vlen të theksohet se fal angazhimit të Njësisë Punuese në Mitrovicë e cila ka ndërmarrë veprime qoftë në informimin e qytetarëve për mos hedhje të mbeturinave në këto pika apo edhe vendosjen e banerëve (pllakata) informues është arritur që dy deponitë ilegale të cilat kanë qenë më problematike si ajo në lagjen Bair tek ish fabrika e duhanit, në rrugën "Driton Veliu" përballë Shkollës Fillore "Migjeni", janë eliminuar në tërësi.

Sfidë për këtë periudhë kanë qenë defektet e shpeshta të kamionëve kjo për shkak të vjetërsisë së tyre. Megjithatë, fal angazhimit maksimal të punëtorisë mekanike e cila ka punuar me raste edhe në fundjava, sanimi i menjëhershëm i defekteve si dhe pajisja me kamion të rinj ka ndikuar që përmbushja e detyrave në grumbullim të mbeturinave të arrijë nivelin e kënaqshëm dhe pa ankesa nga qytetarët.

Ofrimi i shërbimit në grumbullim të mbeturinave në komunën e Mitrovicës bëhet për rreth **98%** të ekonomive familjare, në komunën e Vushtrrisë shërbimi bëhet rreth **98%** të ekonomive familjare, derisa për komunën e Skenderajt shërbimi bëhet për rreth **84.01%** të ekonomive familjare.

Njësia Punuese në Skenderaj ka arritur që ta zgjeroj shërbimin në grumbullim të mbeturinave për rreth **6.33 % (deri me 31.12.2022 shtrirja e shërbimit në Skenderaj ka qenë rreth 77.68%).**

**Në vijim në formë tabelare paraqesim sasinë e grumbulluar të mbeturinave për periudhën krahasuese 2022/2023, të ndara sipas njësive:**

| **Sasia e Grumbullimit të Mbeturinave Sipas Njësive 2022/2023** | | | |
|---|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** | **%** |
| **Mitrovicë** | 25,995.71 Ton | 24,741.58 Ton | -4.82 |
| **Vushtrri** | 18,954.10 Ton | 20,592.53 Ton | 8.64 |
| **Skenderaj** | 7,908.27 Ton | 8,683.37 | 9.80 |

**Tabela 1.**

| **Sasia e Grumbullimit të Mbeturinave në Regjion për 2022/2023** | | |
|---|---|---|
| **2022** | **2023** | **%** |
| 52,858.08 Ton | 54,017.48 Ton | 2.19 |

**Tabela2.**

| **Numri i Zbrazjeve të Kamionëve në Deponi për 2022/2023** | | | |
|---|---|---|---|
| **Viti** | **2022** | **2023** | **%** |
| **Mitrovicë** | 7,167 | 6,246 | -12.8 |
| **Vushtrri** | 3,767 | 3,833 | 1.75 |
| **Skenderaj** | 1,743 | 1,805 | 3.55 |
| **Totali:** | **12,677** | **11,884** | **-6.25** |

**Tabela 3.**

(**Sqarim:** Njësia në Mitrovicë, ka tre (3) kamion të tipit Mitcubishi me kapacitet prej 4 tonësh, një (1) kamion të tipit Isuzi me kapacitet prej 2.5 tonësh dhe një (1) traktor me rimorkio, automjete këto të cilat shfrytëzohen për grumbullim të mbeturinave në rrugë të ngushta dhe rrugica ku qasja e kamionëve me kapacitet më të madh është e pamundur, andaj këto automjete rrisin numrin e zbrazjeve në deponi).

Në tabelën 4, paraqesim shpenzimet e derivateve për Njësi 2022/2023

| Derivatet e Shpenzuara për Njësi 2022/2023 | | | |
|---|---|---|---|
| Viti | 2022 | 2023 | % |
| Mitrovicë | 125,838.21 litra | 116,696.83 litra | -7.26 |
| Vushtrri | 119,723.69 litra | 117,146.27 litra | -2.15 |
| Skenderaj | 73,131.25 litra | 68,872.86 litra | -5.82 |
| **TOTALI:** | **318,693.15** | **302,715.96** | **-5.01** |

**Tabela 4.**

Në këtë sasi të derivateve përfshihet edhe mirëmbajtja verore e fshirje dhe larjeve të rrugëve.

Njëherazi të gjitha shpenzimet e derivateve të naftës për nevoja të administratës si dhe për mirëmbajtjen e deponisë i ka bartë Njësia e Mitrovicës. Në vijim, në tabelën 5, paraqesim shpenzimet e derivateve për mirëmbajtjen e deponisë:

Në vitin 2023, në deponi janë trajtuar **54,017.48 ton** mbeturina ndërsa janë shpenzuar **18,180 litra naftë**.

| Sasia e derivateve të shpenzuara në deponi | | |
|---|---|---|
| 2022 | 2023 | % |
| 18,922 litra | 18,180 litra | -3.92 |

**Tabela 5.**

Realizimi i aktiviteteve të Kompanisë, qofshin ato primare apo sekondare është bërë me automjete të rënda të llojit dhe kapacitetit të ndryshëm duke përfshirë edhe automjetet/veturat zyrtare të cilat shfrytëzohen nga shërbimi i furnizimit si dhe nga administrata. Njësia në Mitrovicë ka shfrytëzuar 24 automjete, Njësia në Vushtrri ka shfrytëzuar 20 automjete, dhe Njësia në Skenderaj ka shfrytëzuar 16 automjete.

Krahas aktiviteteve në menaxhimin e mbeturinave, mirëmbajtjes verore të rrugëve, Kompania ka mirëmbajtur dhe menaxhuar edhe me deponinë "Gërmova". Duke pas parasysh kushtet atmosferike, mbulimi i deponisë për periudhën raportuese është bërë si në vijim:

Nga 08.02.2023 deri më 13.02.2023

Nga 22.03.2023 deri më 24.03.2023

Nga 02.05.2023 deri më 04.05.2023

Nga 11.06.2023 deri më 20.06.2023

Nga 27.07.2023 deri më 31.07.2023

Nga 26.08.2023 deri më 29.08.2023

Nga 04.10.2023 deri më 05.10.2023

Nga 14.11.2023 deri më 18.11.2023, dhe

Nga 19.12.2023 deri më 25.12.2023

Kompania Regjionale e Mbeturinave"UNITETI"-Njesia Skenderaj

## PËRFORMANCA KOMUNALE NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE, 31.12.2023

| | | |
|---|---|---|
| **I.** | **Nr. I pergjithshëm i EKONOMIVE FAMILJARE në Komunë dhe Ek. Familjare( Amvisuri ) në Sherbim** | |
| 1. | Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare në komunë | 7682 |
| 2. | Numri i Ek. familjare të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, në vitin 2023 | **6454** |
| | Perqindja: | *84.01%* |
| **II.** | **Numri I pergjithshëm e EK. KOMERCIALE në Komunë dhe Ek.Komerciale ( Biznese ) në Sherbim** | |
| 1. | Numri i ekonomive komerciale dhe industriale në komunë | 564 |
| 2. | Numri i ekonomive komerciale të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave | **458** |
| | Perqindja: | *81.20 %* |
| **III.** | **Numri I pergjithshëm i INSTITUCIONEVE në Komunë dhe Institucioneve në Sherbim** | |
| 1. | Numri i përgjithshëm i institucioneve publike në komunë | 77 |
| 2. | Numri i i institucioneve publike të përfshira në sistemin e grumb.të mbetur. | **76** |
| | Perqindja: | *98.70 %* |
| **IV.** | **Faturimi dhe Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave** | |
| 1. | Shuma e mjeteve të faturuara në euro për mbledhjen e mbeturinave në vitin 2023 | **471,056.95** |
| 2. | Shuma e mjeteve të paguara (inkasuara) në euro për mbledhjen e mbeturinave / 2023 | **447,222.38** |
| | Perqindja: | *94.94 %* |
| **V.** | **Sasia e deponuar e mbeturinave në deponinë regjionale në Germovë - Mitrovicë** | |
| 1. | Numri i banorëve në komunë | **50858** |
| 2. | Sasia e deponimit të mbeturinave në kg. për vitin 2023 ( **8,683.37** ton mbeturina ) | **8,683,370 Kg.** |
| 3. | Numri i zbrazjeve ne deponinë regjionale Germovë - Mitrovicë | 1805 |
| 4. | Sasia e mbeturinave për kokë banori ne Komunën e Skenderajt / vit | *203 kg* |
| **VI.** | **Numri i Ekonomive Familjare dhe Bizneseve PASIVE** | |
| 1. | Eknomi Familjare PASIVE ( Te shperngulura ose tjeter ) | **539** |
| | Perqindja: | *7.01 %* |
| 2. | Ekonomi Komerciale ( Biznese ) PASIVE | **189** |

**VII. Numri i kontejnerve te shperndarë ne teren, dhe forma e sherbimit**

| Kont. 120 l | Kont.240 l. | Kont. 1.1 m3 | Kont.7 m3 | Sherbimi Derë me Derë | | Sherbimi me Kont. Kolektiv | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **4895** | **100** | **241** | **11** | **5247** | *81.30 %* | **1207** | *18.70 %* |

**Paraqitjet e disa indikacioneve te performancës në formë tabelare**

Tab.Raporti i faturimit dhe inkasimit nga ek.Familjare, Bizneset dhe Institucionet per v.2023

| Nr. | Klientet. | Faturimi | Inkasimi | % |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Ekonomi Familjare-Amvisëri | 297,795.8 | 281,596.36 | **94.56** |
| 2. | Biznese | 86,847.48 | 91,166.98 | **104.97** |
| 3. | Institucione | 86,413.67 | 74,459.04 | **86.16** |

| | Total : | 471,056.95 | 447,222.38 | 94.94 |
|---|---|---|---|---|

Viti raportues 1 janar – 31 dhjetor 2023 Faturimi, Inkasimi dhe nr. i Faturave te leshuara.

| Emri I Operatorit | Kategoria e klientëve te sherbyer | Faturimi ( te hyrat ) | | Arkëtimi | | Perqindja e inkasimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vlera / € | Nr. I faturave të lëshuara | Vlera / € | Nr. i faturave të arketuara | |
| a | b | c | ç | d | dh | g |
| KRM "Uniteti"-Njesia në Skenderaj | Amvisëritë | 297,795.8 | 61,363 | 281,596.36 | 58,024 | **94.56** |
| | Bizneset | 86,847.48 | 5,465 | 91,166.98 | 5,465 | **104.97** |
| | Institucionet | 86,413.67 | 426 | 74,459.04 | 367 | **86.16** |
| | Shërb. e kontraktuara | | | | | |
| | Gjithsejt: | **471,056.95** | **67,254** | **447,222.38** | **63,856** | **94.94** |

**SASIA E MBETURINAVE TË DËPONUARA NË DEPONINË REGJIONALE NË GERMOVË NGA KRM"UNITETI" NJËSIA NË SKENDERAJ –PËR VITIN 2023**

| Nr. | Muaji | Numri i zbrazjeve | Sasia e deponuar e mbeturinave / ton |
|---|---|---|---|
| 1. | Janar | 153 | 803.61 |
| 2. | Shkurt | 130 | 609.09 |
| 3. | Mars | 140 | 608.82 |
| 4. | Prill | 118 | 593.67 |
| 5. | Maj | 161 | 692.75 |
| 6. | Qershor | 142 | 657.19 |
| 7. | Korrik | 162 | 818.31 |
| 8. | Gusht | 191 | 974.29 |
| 9. | Shtator | 165 | 777.46 |
| 10. | Tetor | 147 | 683.07 |
| 11. | Nentor | 149 | 713.55 |
| 12. | Dhjetor | 147 | 751.56 |
| | Total : | **1805** | **8,683.37 ton** |

Skenderaj: 31.12.2023

KRM "UNITETI" SH.A-Njësia Skenderaj
Mr.sc. Arif Behrami Z.v. Menaxher

Kompania Regjionale e Mbeturinave"UNITETI"-Njesia Skenderaj

**Tab.1.**-Sistematizimi i vëndeve të punës në KRM"UNITETI"-Nj.Skenderaj 31.12.2023

| Nr. | Sektori | | Nr. i të punësuarve |
|---|---|---|---|
| 1. | Administrata | | 8 |
| 2. | Furnizimi | | 1 |
| 3. | Inkasimi | | 4 |
| 4. | Punëtoria mekanike | | 3 |
| 5. | Sigurimi | | 3 |
| Gjithsejt jasht Operatives | | | 19 |
| Operativa | | Supervajzer | 1 |
| | | Vozitës zyrtar | 1 |
| | | Bagerist | 1 |
| | | Vozitës Kamioni | 8 |
| | | Punetorë Fizik | 21 |
| Gjithsejt Operativa | | | 32 |
| Gjithsejt KRM"Uniteti"-SHA-Njesia Skenderaj( 19+32 ) | | | 51 |

Struktura gjinore e te punësuarve

| | |
|---|---|
| Meshkuj | 47 |
| Femra | 4 |
| Gjithsejt | 51 |

Skenderaj 31.12.2023

Pyetje nga Hysni Mehani

Drejtorit të Bujqësisë

1. Gjatë këtij viti drejtoria që ju drejtoni ka dhënë makina mbjellëse të misrit. Ndër kriteret që ishin përcaktuar me rastin e shpalljes së thirrjes ishte që aplikuesit të kishin të mbjellur kulturën e misrit gjatë vitit 2023 dhe të planifikojnë mbjelljen e kësaj kulture në vazhdim. Mirëpo ky kriter nuk ishte respektuar nga drejtoria që ju drejtoni, ku në njërën nga seancat ju keni thënë se e keni marrë parasysh certifikatën familjare që dëshmon së njëri nga familjarët e kishte të mbjellë këtë kulturë, madje edhe në një prononcim publik e kishit pohuar këtë duke thënë se: "problemi është se ka aplikuar burri, por gruaja është për subvencione. Veç qisi raste janë së nuk ka asnjë familje (përfitues) që nuk ka pasur të mbjella."
   Ndërkohë, që në një dokument që i keni dërguar AIP i cili mban nënshkrimin tuaj, ju kishit thënë se në marrëveshje me "Islamik Relief" ju kishit vendosur të mos kërkoni fare dëshmi mbi hektarët e mbjelluara me misër, por kishit vendosur që vlerësimin ta bënte komisioni në terren.
   Cila është e vërteta, ajo që i thoni në medie apo ajo shkruani për AIP?
   Tutje, ishit marrë vesh me Islamic Relief që komisioni vlerësimin ta bëntë në terren sipas gjendjes reale, ndërsa AIP-it i deklaroni që komisioni kishte vlerësuar në mënyrë diskrecionale!
   I nderuari drejtor, a mund të na tregoni çka do duhej të ndodhte tjetër sipas jush që ky proces të quhet keqpërdorim, korrupsion apo hajni, emërojeni sido që është më e pranueshme për ju, dhe a ka raste tjera që keni vepruar njëjtë?
   Shih dokumentet më poshtë!

*Islamic Relief Kosova*

*Komuna e Skenderajt*

Me datën 25.01.2024, Islamic Relief Kosova ne bashkëpunim me Komunën e Skenderajt kemi hapur thirrjen ne mbështetje te ekonomive familjare. Ne kuadër te kësaj thirrje, janë paraparë që të shpërndahen edhe mbjellëse te misrit dhe mbjellëse te grurit. Në këtë thirrje kanë aplikuar një numër i madh i ekonomive familjare me këtë rast komisioni ka filluar punën ne shqyrtimin e aplikacioneve.

Nga ana e komisionit është konstatuar se asnjë nga aplikuesit për mbjellëse të misrit dhe mbjellëse të grurit, nuk i kanë dorëzuar dëshminë e aplikimit për subvencione për vitin 2023 edhe kanë kërkuar mendim nga menaxhmenti se si të veprohet më tutje.

Duke marrë për bazë se as një aplikues nuk ka sjellë aplikim për subvencione për vitin 2023, ne mendojmë se vazhdimi i vizitave ne teren dhe vlerësimi i fermerëve është trajtim i barabartë për të gjithë aplikuesit në këtë thirrje.

Ne si udhëheqje e të dy institucioneve, Islamic Relief Kosova dhe Komuna e Skenderajt pajtohemi që të vazhdohet me vizita në teren dhe të vlerësohen aplikuesit sipas gjendjes reale në teren.

Kërkojmë nga ana e komisionit që të bëhet një punë sa me mirë në teren dhe për një kohë optimale.

Islamic Relief Kosova

Albulena Gashi

Komuna Skenderaj

Behxhet Maliqi

Prishtinë

22.02.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

No. 02-034/01-0029798/24
Data 28.06.2024

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predsednika/Office of the Mayor

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 28.06.2024 |
| PËR/ZA/TO: | Agjencinë për Informim dhe Privatësi |
| NGA/OD/FROM: | Kryetari i Komunës, z.Fadil Nura |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje ndaj shkresës njoftuese |

Të nderuar,

Pas pranimit të shkresës njoftuese të datës 24.06.2024, lidhur me Ankesën e z.Hysni Mehani nr.366, të parashtruar pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, përkitazi me kërkesën për qasje në dokumente publike të parashtruar me datë 29.04.2024, ju njoftojmë se të njejtit më datë 30.04.2024 i është lejuar qasje e plotë në dokumentet publike të cilat Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka pasur në dispozicion.
Për të sjellur një kronologji të rastit, ju rikutojmë se z.Hysni Mehani, në kërkesën e tij ka kërkuar qasje në:

1. Dëshmitë mbi të cilat komisioni ka vërtetuar se përfituesit i kanë pasur 2 hektarë me misër gjatë vitit 2024 dhe sa kanë planifikuar për vitin 2024.
2. Procesverbalin me sqarimet mbi poentimin e aplikuesve.

Mëqenëse gjatë afatit të aplikimit asnjë nga fermerët nuk e ka sjellë Aplikimin për Subvencione për vitin 2023, Komuna e Skenderajt në marrëveshje me donatorin "Islamic Relief Kosova" kanë konstatuar se vazhdimi i vizitave në terren dhe vlerësimi i gjendjes reale do të ishte një trajtim i barabartë për të gjithë aplikuesit, andaj dhe ka vazhduar me vizitat në terren dhe poentimin sipas gjendjes reale të secilit aplikues.

Prandaj, Komuna e Skenderajt nuk posedon dëshmi tjetër përveç procesverbalit me përshkrimin dhe tabelën e poentimit të aplikuesve, dokument ky i cili i është dërguar në formë elektronike nga Zyrtari për Qasje në Dokumente Publike. Për shkak se aplikuesit nuk kanë ofruar dokumentet e aplikimit për subvencione për vitin 2023, i vetmi dokument që shërben si dëshmi e vlerësimit dhe poentimit është procesverbali me përshkrimin dhe tabelën e poentimit të aplikuesve, në të cilin kemi ofruar qasje të plotë. Sipas këtij dokumenti, komisioni ka vlerësuar në mënyrë diskrecionale se cili nga aplikuesit i plotëson kushtet e aplikimit dhe të njejtin vlerësim e ka përshkruar në formë tabelare.

Tutje, duke u bazuar në nenin 2 paragrafi 1 dhe 2, ndërlidhur me nenin 14, paragrafi 5, pika 3 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Komuna e Skenderajt nuk është e detyruar të ofrojë qasje në dokumentet publike domosdoshmërisht në formën e kërkuar nga kërkuesi, në rastet kur një gjë e tillë do të përbënte obligim për institucionin publik që të krijojë apo përshtatë dokumente publike apo të jep përmbledhje të informatave e kur kjo do të përfshinte përpjekje jo-proporcionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë.
Bazuar në të lartcekurat, konsiderojmë se Komuna e Skenderajt ka ofruar tërë dokumentet që ka në dispozicion lidhur me kërkesën në fjalë, dhe se një dokument i tillë nuk është në dispozicion të Komunës, pasi që nuk janë ofruar nga aplikuesit me rastin e aplikimit në Drejtorinë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Me respekt!

Drejtorit të bujqësisë

2. A ka raste që edhe pas publikimit të emrit të fermerëve si përfitues të makinës mbjellëse të misrit, fermerët nuk i kanë marrë makinat mbjellëse të misrit? Sa raste janë dhe për cilat arsye iu është anuluar subvencionimi, si dhe, cila është baza ligjore dhe me cilën kategori sipas rregullores komunale për subvencione i keni shpërndarë këto makina mbjellëse të misrit?

Drejtorit të financave

3. Sa është vlera e kontratave që keni nënshkruar prej se keni marrë mandatin si qeverisje?

*Pyetjet nga* ***Floriana Halili***

*Drejtorit të bujqësisë;*

*Pse s'po vazhdon dhënia e mbështjerrave si vitet paraprake, keni hapur thirrjen fermerët i kanë dorëzuar dokumentat pak para se t'i shpalleni rezultatet e keni ndërpre, pse?*

*Drejtorisë Shëndetësisë;*

*A është e vërtetë që barnatorja e privilegjuar e Fadil Nures, vazhdon ta vjedh rrymën prej QKMF-së?*

*E kam fjalën për barnatoren ku ishte pediatria, e që z. Nura ia dha një bashkëpartiaku.*

*Drejtorisë së Gjeodezisë:*

*Objekti ''U'' që është pjesë e Kompleksit të UÇK-së, e që ne si kuvend e kemi miratuar për ta dhënë në shfrytëzim, a ka qenë në listën e pronave për t'u dhënë në shfrytëzim siç e parasheh ligji?*

Pyetje për drejtorin e urbanizmit:
Drejtor, a e keni ne plan me ndërmarrë diçka ne përmirësimin e kanalizimit ne degëzimin qe lidhet me Drenas?
Është shume e nevojshme me intervenua ne këtë pjese, me i largu aromat e këqija qe janë afër kompleksit memorial te dëshmoreve ne Marine?

**Abdulla Gashi-IDEAL**

---

Pyetje për drejtorin e arsimit.
I nderuar drejtor ka qe 7 muaj që e kam bëre pyetjen e njëjtë: për çerdhen e Runikut. A mund të na japësh informacione më të detajuara kur pritet të fillojë renovimin i objektit të destinuar për çerdhe?

Pyetje për drejtorin e urbanizmit I nderuar drejtor ,në dëgjimin buxhetor ne Runik pyetjes se banorëve të Leqinës ju keni premtuar qe së shpejti do të fillon zgjerimi dhe shtrimi i rrugës në lagjen Dragaj që e lidh me shkollën e vjetër dhe rrugën e vetme ne lagjen Dragaj që dërgon për të shtëpia e familjes së se 2 dëshmorëve dhe 1 martiri ?

Pyetje për drejtorin e urbanizmit
Deri ku kanë shkuar procedurat e subqendres së Runikut?

**Kushtrim Draga-PDK**

---

Për Ekzekutivin e Komunës Skenderajt!

1. Për Kryetarin Fadil Nura; Kryetar cilat janë arsyet e mos pagesës te mëditjeve për mbajtjen e mbledhjeve për anëtarët e Komitetit për komunitete kur dihet se komitet i komuniteteve është komitet i përhershëm?.

2. Për Drejtorin për Shërbime publike; Drejtor, kam pranuar shqetësime nga ana e qytetareve te cilët e kane breng problemin e kundërmimit nga ujerat e zeza te cilat dyshohet qe janë si pasoje e bllokimit te kanalizimit te ujerave te cilat rrjedhin nga fabrika e përpunimit te mishit në Polac, po ashtu shqetësim i njëjtë vjen edhe nga banoret e fshatit Rrezall e Re, që dalin nga Impianti i ujerave të zëna në Llaushë, që kundërmon erë e keqe?

3. Për Drejtorin për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale; Drejtoresh a planifikoni qe ne planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm ne rritjen e subvencioneve për nenat qe lindin fëmije, se disa komuna për çdo lindje e kanë shume 500€.

**Afrim Kabashi-NSD**